

Revistë edukative-kulturore

ETIKA

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den
Europa: 2 Euro

Gusht 2011 • Numri: 41 • E përmuajshme



DREJT NJË JETË TË RE
ME AGJËRIM

www.revistaetika.com

EDITORIAL

Agjërimi i Ramazanit është një lloj ibadeti që ka kohën e vet. Ai përjetohet brenda një afati kohor prej një muaji. Kjo periudhë kohe është koha e rigjallërimit të njeriut fizikisht, mendërisht dhe shpirtërisht.

Agjërimi është adhurimi në të cilin ridisiplinohen nevojat më themelore të njeriut si uria dhe seksi. Agjërimi në këtë mënyrë e shtyn njeriun drejt përpikmërisë së të jetuarit sipas kritereve të Plotfuqishmit që ka përcaktuar natyrën njerëzore të njeriut.

Agjërimi e drejton njeriun drejt të kuptuarit të situatës së nevojtarëve nga njëra anë dhe nga ana tjetër e detyron atë të mjaftohet me sasinë më të pakët të pasurisë që zotëron duke e mbajtur në këtë mënyrë larg shpenzimeve. Në një kuptim agjëruesi është i varfër. Njeriu që agjëron me këtë ndërgjegje nuk rrezikon kurrë të bëhet një ditë si Karuni.


Agjërimi dhe namazi shkojnë bashkë përherë, sepse myslimani e ka për detyrë të falë namaz çdo ditë. Atëherë namazi e ushqen agjërimin ashtu si agjërimi e ushqen namazin. Të dy këto adhurime endin “ndërgjegjen e robërisë së Allahut”, që është edhe shtylla kurrizore e personalitetit të myslimanit.

Përveç kësaj, tradita islame e ka pleksur agjërimin me zekatin, duke vënë në zbatim dhurimin e sadakatul fitrit, përpara Bajramit të Ramazanit. Kështu myslimani, të cilit i zbutet zemra me anë të urisë individuale dhe që përjeton një llogari të re në marrëdhënien e tij me pasurinë, në sajë të iftarit dhe syfyrit të sofrës së tij që nuk ndryshon shumë nga ajo e nevojtarit me zekatin që jep e rindërton si vetveten ashtu edhe shoqërinë ku jeton. Aty ka edhe paqe, edhe prehje.

Të gjitha këto e bëjnë agjërimin cohën më jetike të jetës së myslimanit. Ka një harmoni të dallueshme mes agjërimit dhe jetës. Agjërimi nuk është i huaj për jetën. Askush nuk pyet “Ç’është ky agjërim, ç’është kjo jetë?” nuk mund të agjërosh ditën dhe të shkelësh “kufijtë e Allahut” natën.

Muajin e Ramazanit duhet ta konsiderojmë si njohjen e kufijve hyjnorë dhe si klimën, ku rritet përpikmëria ndaj këtyre kufijve.

Do të lexoni:



- Ahmet Tashgetiren / 4** Fillimi i një jete të re sëbashku me agjërimin
- Xhafer Bekiroglu / 7** Ashku hyjnor, qëllimi sublim
- Imam Muhamed Sytari / 8** Kuptimet e Kuranit në gjuhën shqipe përballë sfidave të reja të kohës
- Zija Vukaj / 12** Feniks identitar
- Nexhat Ibrahimimi / 16** Si të organizohet jeta gjatë Ramazanit dhe disa këshilla praktike
- Ali Byjyqçapar / 19** Kurani dhe Ramazani
- / 20** Një shikim modern i mendimeve dhe konstatimeve të Ibën Haldunit në lidhje me politikat e administrimit publik dhe ekonomik
- Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz / 24** Ramazani dhe agjërimi
- Ma. Gilman Kazazi / 27** Originaliteti i Kuranit

Ahmet Tashgetiren /

Fillimi i një jete të re sëbashku me agjërimin

4



Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz /

Ramazani dhe agjërimi

24



Ma. Gilman Kazazi /

Originaliteti i Kuranit

27



Viti: VI | Numri: 41 | Gusht 2011

Administrator i Progresi botime:

Shuaqip Bashhan

bashan43@hotmail.com

+355 69 20 76768

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com

+355 69 24 23989

Përkthyesit:

Alban Kali / Albert Halili / Artur Tagani

Elvira Puka / Elona Sytari Evans Drishti /

Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:

Ma. Irida Hoti

Kopertina:

Edison Çeraj

Dizajn-Grafik:

Bledar Xama

Për artikuj

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

e-mail: kosova@progresibotime.com

e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Gusht 2011

40

Osman Nuri Topbash /
Vëllazëria



Fotoja e muajit

30 /

Financa Islame, një alternativë etike
ndaj traditacionales

32 / **Idlir Bekteshi**

Republika e Kosovës

34 / **Prof. dr. Selman Sheme**

Të ndjesh Ramazanin

37 / **Nexhla Gynaj**

Një Ajet - Një Hadith

38 - 39 /

Vëllazëria

40 / **Osman Nuri Topbash**

Dispozitat e sheriatit islam për
institucionin e zekatit

48 / **Ma. sci. Flamur Sofiu**

Psikoanaliza dhe feja,
një qasje psikologjike

52 / **Nuredin Nazarko**

Ramazani dhe koha kur uria të shkon

57 / **Umut Bullut**

Frig e Zotit asht kry e filozofisë

58 / **Zani i t'kaluemes**

Ndiko, që kjo shoqëri
të bëhet edhe më e mirë

60 / **Imam Naim Drijaj**

Shkenca e mjeksisë
në historinë e shkencës islame

62 / **Ma. Artur Tagani**

Ebu Hamid Gazaliu
dhe kritika e tij e filozofisë

64 / **Enciklopedi Islame**

Xhamitë e Elbasanit

67 / **Ma. Ermal Nurja**

Zejneb binti Ali (ra.)

70 / **Familja**

48

Ma. sci. Flamur Sofiu /
Dispozitat e sheriatit islam për institucionin e zekatit



52

Nuredin Nazarko /
Psikoanaliza dhe feja, një qasje psikologjike



PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
Shkodër / Albania
Tel: +355 22 254 634
Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 441 63 651

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë
Abonim (një vjetor): 1500 Lekë
Kosovë: 1 Euro
Abonim (një vjetor): 10 Euro
Maqedoni: 60 DEN
Abonim (një vjetor): 720 DEN
Europë: 2 Euro
Abonim (një vjetor): 24 Euro



Fillimi i një jete të re së bashku me agjërimin

Ahmet Tashgetiren

Të gjithë adhurimet e Islamit janë jetë ose janë të ndërthurura me vetë jetën. Në jetën e myslimanit nuk ekziston ndarja mes jetës dhe adhurimit.

Adhurimi në jetën e myslimanit nuk është një copë e huaj.

Adhurimi gjendet në thelb të cohës së jetës së myslimanit.

Në fenë islame si jeta e individit, si jeta e shoqërisë janë të ndërlidhura me adhurimet.

Vetëm në rastin kur adhurimi dhe jeta shoqërore bëhen një e tërë me ndjenjat e afinitetit ndaj Allahut atëherë mund të bëhet fjalë për "njeriun e Islamit" apo "shoqërinë islame".

Në qoftë se adhurim do të thotë "**robëri ndaj Zotit**" atëherë myslimani nuk mund të shkëputet nga "**robëria**" në asnjë fushë të "**jetës**".

Marrëdhënia mes adhurimit dhe jetës ka nisur të dobësohet gjatë proceseve sekulariste-laikebotërore të kohëve moderne.

Duket sikur myslimani i ditëve tona i kryen adhurimet, por tërhiqet drejt botëkuptimit apo veprimeve që nënkuptojnë se kjo jetë mund të

jetohet edhe jashtë kriterëve islame.

Në të vërtetë që adhurimi të quhet vërtet adhurim është e nevojshme që jeta të ndërtohet brenda tërësisë islame.

Edhe për "namazin" që do të pranohej si adhurimi më personal i individit është e nevojshme një disiplinë jete apo një jetë e unifikuar në tërësinë e saj. Në jetën që njeriu nuk arrin të qëndrojë përherë përpara Zotit, pra kur zemra, mendja dhe çdo gjymtyrë e njeriut ndjek pas nga një gjë më vete, si është e mundur që të gjithë organet e njeriut të fokusohen në një pikë, të përqendrohen në një qëllim dhe të mund të dalin përpara "audiencës" duke thënë "Allahu ekber"?

Agjërimi është njëri nga adhurimet që kryhet më shumë nëpër shoqëritë myslimane. Agjërojnë njerëz nga mosha shtatë deri në shtatëdhjetë vjeç.

Pyetja që mund të bëhet është:

A mund të bëhet fjalë për një "jetë sipas islamit" në shoqëritë myslimane në atë masë që është i përhapur zbatimi i adhurimit të agjërimin?

Kujdes se mos agjërimi shndërrohet në një for-

më sjellje të montuar në jetën e individit prej një tradite të trashëguar dhe nuk është se përjetohet me një ndjesi frike ndaj Zotit!

Kjo shprehje ka lidhje me pyetjen nëse agjërimi ka hyrë apo jo në jetën tonë si “adhurim” i vërtetë.

Kjo shprehje ka lidhje të ngushtë me pyetjen se në cilin nivel është ndërgjegjësimi i njeriut tonë në lidhje me “adhurimin”.

Çfarë është adhurimi?

Në qoftë se **“adhurim”** do të thotë robëri ndaj Zotit, çfarë vlere përcaktuese mbart “robëria ndaj Zotit” në jetën tonë?

Këtu ne nuk kemi të drejtën të bëjmë inspektim agjërimi apo të akuzojmë për “nivel të ulët adhurimi”, por kemi të drejtë të përcaktojmë adhurimin si një mjet që e shpie njeriun drejt ndërgjegjësimit për një “bashkim me Zotin”. Të shprehemi se adhurimet kryhen vetëm për hir të Zotit, se kemi të nevojshme një impuls mendor dhe shpirtëror që “mos ta harrojmë Atë”. Të gjitha këto mund të realizohen vetëm me një jetë gjithëpërfshirëse.

Herë pas here flasim për rëndësinë që ka “të kushtuarit rëndësi Islamit”.

Këtë paralajmërim ia drejtojmë një bashkësie që shprehet me zë të lartë se “është myslimane”. Nën këtë qëndron merakuri që edhe e cilësojmë veten si mysliman, edhe nuk arrijmë ta mbështesim këtë fjalë me të vërtetë me veprat që dëshiron feja islame. Në qoftë se është e rëndësishme të thuash “unë jam mysliman”, e rëndësishme është edhe ta mbështetësh këtë veprim me vepra, sepse nuk duhet ta harrojmë se një myslimanllëk pa vepra konkrete nuk e meriton të pranohet në audiencën e të Plotfuqishmit që në të vërtetë këtë kërkon prej nesh.

Këtë shqetësim duhet ta ndjejmë edhe për agjërimin.

Pse kam agjëruar?

Me çfarë na pajis agjërimi?

Cili është dallimi mes jetës me agjërim dhe asaj pa agjërim. Çfarë shpreh ky dallim nga aspekti i jetës sonë të përgjithshme?



Profeti (a.s.) ka thënë: *“U shoftë ai person që e mbërrin muajin e Ramazanit dhe në përfundim të tij Zoti nuk ia ka falur mëkatet.”* (Tirmidhi, Daavat, 101) Në një rast tjetër ka thënë: *“Personit që agjëron sepse beson në vlerat e muajit Ramazan dhe duke shpresuar shpërblimin nga Allahu, kanë për t’iu falur të gjitha gjynahet e kaluara.”* (Buhari, Iman 28, Savm, 6) Në të vërtetë këto dy kritere të profetit ekspozojnë para nesh dy anët e ndryshme të erashkës brenda së cilës gjendet agjërimi.

Në agjërim ka edhe një eliksir përfshirës që mundëson një pastrim të përgjithshëm, edhe një pikëllim të tipit “mos të të falë Zoti mëkatet” edhe pse ka kaluar një muaj agjërim.

Paralajmërimet e kësaj natyre të bëra nga profeti Muhamed nuk kufizohen me kaq. Kur i lexojmë këto hadithe profetike nga aspekti i disiplinës jetësore të një myslimani përpara nesh shfaqet një kornizë e ndryshme e jetës:

“Askush prej jush të mos thotë fjalë të këqija dhe të mos grindet me kënd kur të jetë agjërueshëm. Në qoftë se dikush e fyen atë le t’i thotë “Unë kam agjëruar sot.” (Buhari, Savm, 9)

“Kush nuk braktis gënjeshtat dhe punët me mashtrim, ta dijë se Allahu nuk ka nevojë që ai njeri të mos hajë dhe të mos pijë.” (Buhari, Savm, 8)

Nga këto dy hadithe mësojmë se në jetën e myslimanit që ka agjëruar nuk ka vend për gënjeshtat dhe mashtrimet. Këto hadithe na mësojnë edhe se adhurimi ndaj Allahut nuk mbështetet në mendimin se Zoti ka nevojë për agjërimin tonë dhe se robëria ndaj Zotit në të njëjtën kohë do të thotë të ndërtohet një jetë të pastër.

“Sa vetë ka që agjërojnë dhe nuk përfitojnë gjë nga agjërimi vetëm se rrinë të uritur me barkun thatë. Sa vetë ka që falin namaze nate dhe nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se rrinë zgjuar natës.”



Profeti i Zotit shkon edhe më tej kur shprehet se agjërimi apo namazi që nuk është pjesë e një jete të tillë të pastër apo nuk të jep mundësinë të ndërtohet një jetë të tillë me vlerë, shndërrohet në barrë të rëndë për njeriun. Në këtë kontekst ai ka thënë:

“Sa vetë ka që agjërojnë dhe nuk përfitojnë gjë nga agjërimi vetëm se rrinë të uritur me barkun thatë. Sa vetë ka që falin namaze nate dhe nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se rrinë zgjuar natës.” (Ibn Maxhe, Sijam 21, Darimi, Rikak 12, Hanbel, Musned II, 373)

Duke na bërë të ditur se gënjeshtat dhe agjërimi nuk mund të bëhen bashkë asnjëherë, i Dërguari i Allahut e paralajmëron besimtarin që të mos shtojë mashtrim në robërinë e tij ndaj Zotit.

E vërteta që të gjitha këto gjëra nxjerrin në pah është se, njeriu që e shkon ditën brenda një kornize që bie në kundërshtim me Islamin, edhe nëse është agjërueshëm as nuk do të përfitojë nga mëshira e Zotit, as nuk do të arrijë që të pastrohet shpirtërisht.

Agjërimi është një lloj ibadeti që ka kohën e vet. Ai përjetohet brenda një afati kohor prej një muaji. Kjo periudhë kohe është koha e rigjallërimit të njeriut fizikisht, mendërisht dhe shpirtërisht.

Agjërimi është adhurimi në të cilin ri-disiplinohen nevojat më themelore të njeriut si uria dhe seksi. Agjërimi në këtë mënyrë e shtyn njeriun drejt përpikmërisë së të jetuarit sipas kri-tereve të Plotfuqishmit që ka përcaktuar natyrën njerëzore të njeriut.

Agjërimi e drejton njeriun drejt të kuptuarit të situatës së nevojtarëve nga njëra anë dhe nga ana

tjetër e detyron atë të mjaftohet me sasinë më të pakët të pasurisë që zotëron duke e mbajtur në këtë mënyrë larg shpenzimeve. Në një kuptim agjëruesi është i varfër. Njeriu që agjëron me këtë ndërgjegje nuk rrezikon kurrë të bëhet një ditë si Karuni.

Agjërimi dhe namazi shkojnë bashkë përherë, sepse myslimani e ka për detyrë të falë namaz çdo ditë. Atëherë namazi e ushqen agjërimin ashtu si agjërimi e ushqen namazin. Të dy këto adhurime endin “ndërgjegjen e robërisë së Allahut”, që është edhe shtylla kurrizore e personalitetit të myslimanit.

Përveç kësaj, tradita islame e ka pleksur agjërimin me zekatin, duke vënë në zbatim dhurimin e sadakatul fitrit përpara Bajramit të Ramazanit. Kështu myslimani, të cilit i zbutet zemra me anë të urisë individuale dhe që përjeton një llogari të re në marrëdhënien e tij me pasurinë në sajë të iftarit dhe syfyrit të sofrës së tij që nuk ndryshon shumë nga ajo e nevojtarit me zekatin që jep e rindërton si vetveten ashtu edhe shoqërinë ku jeton. Aty ka edhe paqe, edhe prehje.

Të gjitha këto e bëjnë agjërimin cohën më jetike të jetës së myslimanit. Ka një harmoni të dallueshme mes agjërimit dhe jetës. Agjërimi nuk është i huaj për jetën. Askush nuk pyet “Ç’është ky agjërim, ç’është kjo jetë?” nuk mund të agjërosh ditën dhe të shkelësh “kufijtë e Allahut” natën.

Mund të mendohet se ndoshta injoranca në çështjen e “**kufijve të Allahut**” mund të hapë rrugën e këputjes së marrëdhënieve me jetën.

Prandaj muajin e Ramazanit duhet ta konsiderojmë si njohja e kufijve hyjnorë dhe si klimën, ku rritet përpikmëria ndaj këtyre kufijve.

Agjërimi është një paketë adhurimi e mrekullueshme që i ofrohet Zotit. Nëse arrijmë ta ofrojmë atë pas një jete të dli- rë edhe kjo do të numërohet si gjurmë e respektit tonë ndaj Zotit. Kuptohet qartë se shembujt e një robërie të dli- rë nuk do të mund të dalin nga një jetë e plagosur dhe e fëlliqur.

Lutemi që agjërimi ynë të jetë i tillë që agjëruesi të meritojë faljen e Zotit.

Ashku hyjnor, qëllimi sublim

Xhafer Bekiroglu

Shtrenjtë! Duhet ta dish se miqtë e Allahut kanë thënë: "Ashku është pika e fundit e dashurisë. Udhëzimi dhe për-kujdesja e Zotit për miqtë e Tij. Ashku dritë përmbi dritë, në zemër dhe në shpirt. Ashku hyjnor nuk di kurrë të zërë karar dhe të qetësohet. Prandaj edhe zjarri i ashkut e djeg përherë nga brenda ashikut. Ashiku e ka braktisur të menduarit gjerë e gjatë rreth arsyeve materiale dhe lojës me fjalë".

Enigmat shkojnë drejt zemrës së ashikut, sepse tek ai janë pleksur me njëra-tjetrën fjala dhe vrojtimi. Burimi i ashikut nuk ka të ngjashëm, sepse ai është burimi i njësimin dhe udhës së Zotit. Ashiku e konsideron veten të nënçmuar dhe të pavlerë, sepse vetëm kështu arrin ta madhërojë dhe ta respektojë "Atë" për të cilin ka rënë në ashk. Hallet dhe qederet i duken ëmbëlsira ashikut. Për njeriun që arsyeton sipas kësaj bote, ato janë fatkeqësi.

Nëse në një shpirt shkëlqejnë si vetëtima rrezatimet e të Dashurit, dije mirë se aty ka lindur dielli i dashurisë. Dashuria nuk është forma e jashtme, por kuptimi i shpirtit, sepse në çastin e vdekjes duket qartë se si shpirti nuk e dashuron trupin e pajetë. Në këtë mënyrë, ashiku i formës është i mashtruar dhe fatkeq. Ashiku i shpirtërores është i lumtur, sepse ashku i tij është i vërtetë.

Në qoftë se në zemrën tënde dashuria për Zotin

është dyfishuar, dije se edhe Ai të do ty. A mund të lëshojë tinguj një dorë e vetme, pa u përplasur me një tjetër?!

I eturi qan se ku mund ta gjejë ujin që do t'i shuajë etjen, ndërsa uji gurgullon duke thirrur për të eturin. Etja e shpirtit është një tërheqje e pashembullt. Ne ekzistojmë për hir të Tij...

Fundi i ashkut është qëndrimi i përherëshëm me të dashurin. Por fillimi i përherësisë, për ashikun është shumë i rëndë, sepse ai kalon nga vetja tërësisht. Ashku është aq i virtytshëm, saqë njeriut i zhvlerëson ekzistencën e tij.

Mosnjohja e dëshirave të errëta të nefsit dhe e madhështisë së ashkut, e ka bërë njeriun shumë injorant dhe zullumqar. Lepuri i doli para luanit, kur shkoi pas nefsit të tij. U hodh në krahët e tij me dëshirën e vet, për shkak të injorancës. Megjithëse është kaq injorant dhe zullumqar, në këtë botë njeriu ka nënshkruar vepra shumë të drejta dhe ka grumbulluar njohuri të shumta. Ai e ngarkoi veten shumë rëndë kur pranoi të merrte përsipër amanetin që edhe toka edhe malet ngurruan ta marrin...

Kuptimet e Kuranit në gjuhën shqipe përballë sfidave të reja të kohës

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

“Kurani Kerim është e vetmja shpallje hyjnore e mbetur në këtë botë...

Qëndrimi i këtij Kuran është ngushëllimi i vetëm

për humbjen e trashëgimisë së profetësive të mëparshme...

Por, qëndrimi i myslimanëve ndaj Kuranit, me të cilin u nderuan, nxit habi!

Ka disa shekuj që thirrja e Kuranit është ngurtësuar

dhe mesazhi i Islamit është bërë si një lumë që i është tharë burimi..!”

*Shejkh Muhammed el-Gazali, “Kejfe neteamelu meal-Kuran”,
botimi i parë, Mensura, 1992, fq. 25.*

Përkthimi në gjuhën shqipe i kuptimeve të ajetëve të Kuranit Famëlartë, është pa dyshim një eveniment me rëndësi të madhe për jetën praktike fetare të myslimanëve shqipfolës, por edhe një visar i çmueshëm për Bibliotekën e madhe të Thirrjes Islame në trevat tona.

Të gjithë jemi dëshmitarë të faktit se me ndryshimin e viteve dhe shekujve kanë ndryshuar edhe mënyrat e prezantimit të Fjalës së pandryshuar të Allahut, në formë e në dimension. Kujtojmë momentet e para të zbritjes së Fjalës së Allahut, shkrimin e saj në forma e mjete të ndryshme, nxitimin e Profetit (a.s.), për ta mësuar atë dhe për ta ruajtur nga harresa deri sa zbritën ajete të qarta, që e qetësonin Profetin (a.s.), se Kurani nuk do të tretej, as do të harrohej, as do të tjetërsohej. “Pastaj nga Profeti (a.s.), e morën sahabët, shkronjë për

shkronjë, pa i lënë asnjë të mangët, kështu që mbledhja e Kuranit në kohën e Profetit (a.s.), u bë përmendësh dhe me shkrim. Është transmetuar se Xhibrili (a.s.), i zbriste Profetin (a.s.), me ajetet njëra pas tjetrës dhe i thoshte: “O Muhamed, Allahu të urdhëron ta vendosësh në krye të këtij ajeti, të kësaj sureje” dhe Profeti (a.s.), i thoshte sahabëve: “Vendoseni në këtë vend”. Për këtë dijetarët janë në konsensus se mbledhja e Kuranit në këtë formë siç e shohim sot në Mus’haf, është me urdhër të prerë (teukifi), me urdhër dhe shpallje nga Allahu...”¹. Kujtojmë komisionin e ngritur nga kalifi i parë Ebu Bekri (r.a.), me në krye sahabiun Zejd ibni Thabit për mbledhjen e Kuranit të shpallur në një Mus’haf (libër). Shumëfishimin e kopjeve të Mus’hafit në kohën e Hz. Osmanit

1. Shejkh Ebu Xhihad Muhamed Ebul-Ferexh Sadik, “Kejfe tekraul-Kurane”, Damask, botimi i parë 1999, fq. 38.

(r.a.)², e deri në ditët e shtypjes së tij me miliona kopje për të gjithë myslimanët e globit.

Nisur nga këtu do të përpiqem të shpjegoj arsyet që më bëjnë të mendoj se botimi i "Kuranit" në shqip sot, ka nevojë të rikonceptohet si shfaqje dhe të pajiset me shtesa të domosdoshme për lexuesin e kësaj kohe.

Kohë më parë në librin tim "**Përpyekje të dështuara**" (2003), i jam drejtuar edhe "**Abuzuesve me prejar-dhjen e Kuranit**", duke shqyrtuar origjinën e Fjalës së Allahut dhe duke hedhur poshtë pretendimet e qënies së tij libër i arabëve, i xhindëve, apo i Muhamedit (a.s.), në temën: "**Ja përse nuk mund të jetë Kurani vepër e dikujt tjetër, pos Allahut**".

Aktualisht, në mjediset shqiptare, të gjithë ne jemi dëshmitarë të abuzimeve të ndryshme mediatike me Islamin dhe Librin e fundit të shpallur njeriut, Kuranin. Shpeshherë, ky lloj abuzimi bëhet më depërtues në mendjet dhe mendimin e përgjithshëm të shqiptarëve të kësaj kohe, sesa ajo çfarë ne së bashku mundohemi t'u mësojmë, shpjegojmë a sqarojmë atyre nëpërmjet mjeteve tona të Thirrjes Islame, si: minberi, gazeta, revista, ndonjë emision televiziv, seminaret, sesionet shkencore etj. Nganjëherë një opinion i çthurrur i ndonjë opinionisti a analisti të ditëve të sotme, ka më ndikim negativ, në abuzimin me Islamin dhe mesazhet e tij, sesa të gjitha këto mjete të lartpërmendura së bashku.

Nga këtu, pikë së pari, them se **është e domosdoshme që lexuesve të rinj të Kuranit, t'u ofrojmë mundësinë e leximit të disa hyrjeve dhe paraleximeve,**

2. Shënim: Nëse dikush pyet se çfarë dallimi ka në mes mbledhjes së Kuranit të bërë nga Ebu Bekri dhe të shumëfishimit të ndodhur në kohën e Osmanit (r.a.), themi: "Mbledhja e Kuranit në kohën e Ebu Bekrit u bë për shkak të frikës së humbjes së diçkaje nga Kurani me vdekjen e Hafizëve të tij, sepse ai nuk ishte i mbledhur në një vend të vetëm. Ebu Bekri e mblodhi në një libër duke sistemuar ajetet e tij, sipas udhëzimeve të Profetit (a.s.). Ndërsa shumëfishimi nga Osmani ndodhi për shkak të ndryshimit të dialekteve të arabëve në leximin e Kuranit. Ai u frikësua se mos kjo gjendje rëndojë dhe zgjerohet. I mblodhi edhe një herë ajetet të sistemuara sipas rregullit, në gjuhën e kurejshive, me argument se Kurani kishte zbritur në gjuhën e tyre." (Shejkh Ebu Xhihad Muhamed Ebul-Ferexh Sadik, "Kejfe tekraul-Kurane", fq. 41.)

por edhe mbylljeve e pasleximeve të Librit të fundit të shpallur, që do t'u mundësonin atyre kuptimin e shumë paqartësive që u krijohen nga zhurmuesit e shumë mediatikë dhe abuzuesit e ndryshëm me Librin e Allahut.

Nga eksperiencat interesante dhe me vlerë, me të cilat jam ndeshur në Damask dhe në disa biblioteke të tjera të botës islame, kam vënë re një lëvizje të dobishme të dijetarëve dhe studiuesve atje për të ndryshuar për herë e më shumë mënyrat e prezantimit të Kuranit, si botim, para lexuesve dhe studiuesve. Fjala bie: Njihen shumë mirë për studiuesit arabishtfolës, publikimet e fundit nga "Darul-Fikr" në Damask e Bejrut të botimeve të Kuranit. Përmbledhjet e tefsirit dhe shkencave e njohurive të Kuranit, si: "*Et-Tesirul-vexhizu ve mu'xhemu meanil-Kuranil-Aziz*"³, ose "*El-Meusuatul-Kuranijjetul-mujessere*"⁴ etj., kanë fituar vëmendjen e lexuesit dhe janë kthyer sot në enciklopeditë më tërheqëse dhe më të dobishme për masat e gjera islame.

Këto enciklopedi dallojnë nga botimet e mirëfillta të Mus'hafit, sepse e shoqërojnë tekstin e shenjtë, me komente të shkurta, por kuptimplota, me rregullat kryesore të texhvidit, me treguesin e termave të ndryshëm, me historikun e zbritjes së Kuranit, me historikun e shtatë këndimeve, me tregues tematik, etj. Pra, vlerat e këtij botimi janë të shumëanëshme dhe bashkëkohore.

Ne, nuk duhet të harrojmë se ndër sfidat kryesore të Kuranit, në këto ditë është edhe hapja e pakufishme e realitetit shqiptar ndaj botës së jashtme. Gjendja shokuese e myslimanëve shqiptarë pas diktaturës faraonite komuniste që kaluan, ka qenë dhe mbetet akoma një pengesë e madhe e një ringjalljeje të mirëfilltë islame gjithëpërfshirëse të shoqërisë sonë.

3. Përgatitur nga prof. dr. Vehbe Zuhajlit. Botim i "Darul-Fikr", Bejrut-Damask, botimi i parë 1995, botimi i dytë 1997.

4. Përgatitur nga autorët prof. Dr. Vehbe Zuhajli, M. Adnan Salim, M. Bessam R. Zejn, dr. Muhamed Vehbi Sulejman. Botim i "Darul-Fikril-Muasir"- Bejrut dhe "Darul-Fikr"- Damask, botimi i parë, gusht 2002, botimi i dytë, tetor 2002.

Nisur nga këtu, do të paraqes më poshtë disa nga sfidat e reja të kohës sonë, që mundohen të dobësojnë dhe të eliminojnë (në disa raste) prezencën e Kuranit në jetën e myslimanëve shqiptarë:

1. Abuzimi me ajetet e ndryshme të Kuranit, sjetërsimi i kuptimit, heqja e fjalëve nga ajetet të caktuara, komentimet e çthurta, etj.

Në krye të këtij abuzimi qëndron Organizata "Dëshmitarët e Jehovahit", me botimet e saj në të cilat përzihet helmi në mjaltë dhe ku abuzimi me ajetet Kuranore është flagrant.

Në një prej fletushkave që shpërndahen kryesisht në lagjet myslimane të qytetit tonë, por në mbarë Shqipërinë, të titulluar: "**Si mund ta gjejmë rrugën për në parajsë**", lexojmë edhe këtë titull: "KU DO TË JETË PARAJSA E PREMTUAR?". Në përgjigje të kësaj pyetje thuhet: "Në suren 21, *El Enbija* (Profetët) në ajetin 105 lexojmë: "Ne kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në *Levhi mahfudh*), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robtë e mi të mirë."

Po, njëqind vjet më parë, Psalmi (Zeburi) 37:29 zbuloi se Parajsa e premtuar do të jetë në tokë. Ai thotë: "Të gjithë të drejtët do ta zotërojnë tokën dhe ata do të banojnë në të përgjithmonë".

Nga ky këndvështrim e shohim qartas se ky grup pretendon se "Parajsa" është në tokë. Me një fjalë tjetër, ata mohojnë Ditën e Gjykimit, që është një ndër gjashtë pikat, mbi të cilat ngrihet besimi Islam. A nuk është paradoksale të argumentosh me Kuran një çështje që vetë Kurani e refuzon absolutisht, siç është mohimi i Ditës së Gjykimit në mënyrë indirekte, me një ajet Kuranor që vërtetoka se "**Parajsa e premtuar**" na qenka në këtë tokë!⁵

Këto abuzime me ajetet Kuranore dhe komentimin e tyre në këto libra, arrijnë kulmin kur përmendet hz. Isai (a.s.) dhe historia e tij!? Zot na ruaj nga devijimi!

2. Përkufizimi i mangët, jo i saktë dhe tendencioz i vetë Kuranit, me a pa qëllim

5. Muhamed Sytari, "Përpjekje të dështuara", Shkodër, 2003, fq. 50-51.

Para disa vitesh bibliotekave shqiptare iu shtua një botim i ri i titulluar "**100 librat që tronditën botën**", me autor Martin Seimur-Smith. Libri është konsideruar si një historik i mendimit nga lashtësia deri në ditët tona. "Kurani", si libër renditet i 26- i në listën e autorit. Ajo që vihet re fare mirë, është *mjeshtria* me të cilën autori (a përkthyesi në shqip) në më pak se 6 faqe ka arritur të shkatërrojë bazat dhe themelet e Islamit nëpërmjet shkrimit të tij aspak të vërtetë dhe jashtë çdo norme shkencore mbi Kuranin. Citoj nga faqet e librit të tij për Kuranin: "Një përmbledhje e mësimëve dhe e porosive të Muhametit"⁶, "përmban porosi të shqiptuara nga Muhameti në Mekë dhe në Medinë"⁷, Për Profetin Muhamed (a.s.): "Ishte njeri që përjetonte periudha ekstaze, kur "uni" i tij i zakonshëm, i jashtëm mungonte plotësisht"⁸, "Fjalët që nxirrte nga goja i shkruanin në copa lëkure, në copa vazosh të thyera, në kocka devesh dhe në fletë prej gjethesh palme, më pas të gjithë shkrimet u mblodhën bashkë dhe në vitin 651, kalifi Utmani botoi versionin zyrtar"⁹, "Deri më sot nuk ekziston ndonjë variant i normuar ashtu si duhet i Kuranit, dhe, me sa duket, ai kurrë nuk do të jetë; korigjimet më të fundit i përkasin vitit 1924, që iu bënë në Kajro"¹⁰, "Kurani është vepër e cilësisë së lartë dhe Muhameti del të ketë qenë një poet me dhunti krijuese në llojin e tij (Kurani duhet parë si poezi magjike e jo si prozë)"¹¹. Në të vërtetë ky libër nuk është i vetmi burim deformimi i konceptimit të Kuranit dhe historikut të tij, e bëjnë edhe shumë të tjerë te ne, por mora shkas nga ky botim dhe përkufizimet aspak shkencore dhe objektive të tij.

3. Mosnjohja e historikut të shkrimit të ajeteve kuranore dhe mbledhjes së tyre në një Mus'haf-Libër

Aktualisht, në mjediset tona islame, të pakët janë ata që kanë njohuri mbi historikun e zbritjes së Kuranit, ndarjes së ajeteve në medenite e mekkite, në

6. Martin Seimur-Smith, "100 librat që tronditën botën", botim i SHBLSH e Re, Tiranë, 2005, fq. 141.

7. Po aty, fq. 141.

8. Po aty, fq. 144.

9. Po aty, fq. 144.

10. Po aty, fq. 145.

11. Po aty, fq. 145.

mbledhjen e tyre në një libër, në shumëfishimin e tij etj. Botimi i një informacioni të përmbledhur rreth kësaj pike delikate në brendi të një botimi të ri të Kuranit në gjuhën tonë, do të kishte më shumë dobi, sepse edhe përhapja e tij është më e madhe dhe në mijëra e miliona kopje.

Vini re abuzimin e Seimur-Smithit me Librin e myslimanëve, kur thotë: *"Deri më sot nuk ekziston ndonjë variant i normuar ashtu si duhet i Kuranit, dhe, me sa duket, ai kurrë nuk do të jetë; korrigjimet më të fundit i përkasin vitit 1924, që iu bënë në Kajro"*¹² dhe rrezikshmërinë e këtij citimi. Të jeni të bindur se ndikimi i tij është shumë më i madh ndër lexuesit e sotëm se shumë prej ligjërimeve të hoxhallarëve tanë nëpër xhamia!?

Më tërhoqi vëmendjen gjatë leximeve të mia, një shprehje e Shejkh Muhamed Gazaliut rreth aktualitetit të marrëdhënieve të myslimanëve me Kuranin. Thoshte: ***"Marrëdhëniet e myslimanëve me Kuranin Kerim kanë nevojë për studim të thellë, sepse pas shekujve të parë, vëmendja e myslimanëve ndaj librit të tyre u përqendrua te leximi i tij (tilavet), rregullimi i nxjerrjes së shkronjave (texhvid) dhe përsosmëria e gunneve dhe meddeve..."***¹³.

Realiteti i Thirrjes sonë Islame dhe lidhjes me Kuranin është dëshmitar i gjallë i një gjendjeje të ngjashme me atë që përmend dietari egjiptian. Janë me dhjetra librat e texhvidit dhe abetaret e Kuranit, që janë botuar deri më sot në gjuhën shqipe. Sa del një shoqatë me një botim, ngrihet një tjetër dhe hedh poshtë punën e së parës me një botim të ri, pastaj del një individ a një grup anonim me një botim të tretë dhe kështu librat e texhvidit që mund të ketë secili prej nesh në shtëpi mund të zënë një raft librash!?

Jam i mendimit se duhet ngritur një komision i kualifikuar studiuesish islamë në trevat shqiptare për të

12. Martin Seimur-Smith, "100 librat që tronditën botën", botim i SHBLSH e Re, Tiranë, 2005, fq. 145.

13. Shejkh Muhamed el-Gazali, "Kejfe neteamelu meal-Kuran", botimi i parë, Mensura, 1992, fq. 27.

parë domosdoshmërinë e prezantimit sa më serioz dhe sa më bashkëkohor të Kuranit në gjuhën tonë, botim i cili duhet njohur dhe përqaftuar nga të gjitha Komunitetet dhe Bashkësitë Islame të trevave tona.

Në fund, mendoj se përballë sfidave të reja të kohës duhet të kihen parasysh disa pika në marrëdhënie me Kuranin dhe lidhjet e tij me masat e gjera:

1. Respektimi i shenjtërisë së Fjalës së All-llahut dhe nxitja e respektimit të tij në xhemate e tubime të ndryshme.

2. Nxitja e organizimit të seminareve dhe takimeve të ndryshme me intelektualë të ndryshëm të shoqërive tona, me objekt Kuranin, mrekullinë, historinë dhe shtrirjen e tij.

3. Studimi i mundësive për botimin e broshurave informuese me njohuri të ndryshme (pyetje-përgjigje) rreth Kuranit Famëlartë, për fëmijë e të rinj në mjediset tona shqiptare.

4. Kundërshtimi shkencor dhe i faktuar i të gjithë atyre që mundohen të hedhin helm në mjaltë, në tjetërsimin e ajeteve kuranore, në talljen me shenjtërinë e tij, në abuzimin me renditjen e sureve dhe ajeteve të tij etj., nëpërmjet botimeve të përbashkëta në gazeta dhe revista që zotërojmë, në sesione të veçanta shkencore me këtë tematikë, me publikime konsensuale në internet etj.

5. Përdorimi i internetit për nxitjen e forumeve të kontrolluara për diskutime rreth vërtetësive të Kuranit dhe historikut të tij.

6. Organizimi i konkurseve me tematikë njohuritë mbi detaje të përbërjes së Kuranit, përkufizimit të tij, formave të zbritjes, vendeve, tematikës së tij etj., në medresetë tona.

7. Mundësimi i organizimit të një konkursi ndërshqiptar me medresistët më të zgjedhur në lidhje me njohuritë rreth Kuranit (përtej hivzitetit a texhvidit të tij), me qëllim nxitjen e interesit të brezit të ri për një formim kulturor të mjaftueshëm rreth Kuranit.

FENIKS IDENTITAR

Shënime për veprën “Çarshia e madhe e Gjakovës”,
e autorit Masar Rizvanolli

Zija Vukaj

Zhbërja e së shkuarës është një kërcënim i rëndë që i bëhet identitetit etnik dhe kulturor të një populli. Kjo dukuri a përpjekje, për fat të keq, është shfaqur shpesh përgjatë rrugëtimit historik të kombit tonë, herë me petkun e indiferencës, herë me harresa të qëllimshme e herë me ndërhyrje të dhunshme, duke krijuar boshllëqe informative dhe mugëtira historike e dokumentare të dëmshme e madje të frikshme. Në këto kushte, çdo përpjekje për ta mposhtur “harresën” dhe për të fiksuar në memorjen e kulturës sonë kombëtare vlerat që trashëgohen nga e kaluara e largët apo e afërt, përbën një akt fisnik, human dhe kombëtar që duhet vlerësuar nga çdo këndvështrim. Mënyrat për të fiksuar, vlerësuar e promovuar vlerat tona historiko- kulturore që dëshmojnë, jo thjesht ekzistencën, por sidomos identitetin e një populli plot vitalitet, kulturë dhe nivel dinjitoz jetese, janë nga më të larmishmet. Një e tillë është edhe vepra “Çarshia e madhe e Gjakovës”, e autorit Masar Rizvanolli.

Autori e ka cilësuar këtë vepër si një album dhe vërtet, përshtypja e parë që të krijon kjo vepër është ajo e një albumi që mund të shërbejë fare mirë edhe si një guidë turistike. Mirëpo më pas, çdo lexues e kupton se ka të bëjë me diçka shumë më të thellë. Me një punim që është rezultat i kërkimeve të gjata e të thelluara dhe që parashtrihen në një strukturë të studiuar mjaft mirë. Vepra është konceptuar në dy pjesë: pjesa tekstuale në shqip dhe anglisht dhe pjesa vizuale, e realizuar me pamje fotografike.

Në pjesën e parë, autori ia ka dalë të paraqesë kronologjinë e objektit më emblematic të Gjakovës dhe një relike tepër të rëndësishme të kulturës sonë kombëtare, Çarshinë e Madhe të Gjakovës. Njeriu që vetëm ka dëgjuar për këtë objekt, e ka menduar atë thjesht dhe vetëm si një pazar apo treg. Por ky përfytyrim i mangët vjen duke ndryshuar dhe plotësohet paragraf pas paragrafi me informacione të reja e befasuese që shpjegojnë dimensionet reale të Çarshisë. Ato shtrihen në dy rrafsh të mëdha: në rrafshin material dhe në atë shpirtëror, duke kapur të gjitha aspektet e qytetit, të krahinës, të etnisë shqiptare dhe të kompleksitetit fizik e shpirtëror të ekzigjencave të njeriut si qenie sociale.

Pjesa e dytë e veprës është konceptuar në trajtën e një albumi të pasur fotografik dhe në perceptimin e realiteteve është po aq funksionale sa pjesa tekstuale. Kjo pjesë mundëson konkretizimin e fakteve, objekteve dhe argumenteve, duke materializuar përmes forcës së transmetimit pamor gjithë ç’është thënë në pjesën e parë, falë edhe një trajtimi dhe realizimi mjaft të studiuar e cilësor. Të dy kapitujt shkrihen mjaft mirë me njëri-tjetrin dhe imponojnë një lexim të sinkronizuar, pasi i pari përshkruan, rrëfen dhe argumenton pamje, situata, copëza jete, imazhe etj., ndërsa i dyti plotëson atë magji që nuk është në gjendje ta transmetojë fjala.

Në hyrje të veprës, në formën e parathënies, autori shpjegon motivet e një ndërmarrjeje të tillë kulturore,

gjenezën e kësaj nisme, burimet e informacionit, vësh-tirësitë e hasura, mbështetjet e dhëna dhe mirënjoh-jen e institucioneve dhe individëve që mundësuan re-alizimin e saj. Që në fillim të trajtimit, me një vështrim historik që mbështetet në dokumentacione arkivore, jepen të dhëna interesante dhe të domosdoshme për një punim serioz, mbi zanafillën e Çarshisë së Madhe të Gjakovës. Ndër referencat dhe citimet e ndryshme spikat shënimi i kronikanit turk Evlia Çelebi, i cili e vizitoi Gjakovën më 1662. I mahnitur nga bukuria dhe begatia e qytetit, ai shkroi: *"Jakova i ka dy mijë shtëpi të stolisura që ndodhen mbi një fushë të gjerë. Ka dy xhami të bukura, mesxhide, hane të mbuluara me plumb... Ka një hamam të bukur që të kënaq zemrën dhe nja treqind dyqane me njëmijë lloj mjeshtërish"*. Duke bërë fjalë për mbresat që lanë gjakovarët tek ai, vazhdon: *"Meqë e ka klimën e këndshme, banorët janë të bukur dhe të dashur"*.¹

Përgjatë faqeve të tekstit parakalojnë një galeri e tërë zejesh, zanatesh, artesh, personazhesh e objek-tesh, të lidhura ngushtë me të gjitha ndër-likimet e ekzistencës njerëzore, me kërkesat e pafund materiale dhe shpirtërore të jetës qytetare e më gjerë. Dhe vetë fjala *çarshi* duket sikur nuk e mbart dot morinë e madhe të kupti-meve dhe funksioneve që mund të marrë një objekt i tillë, duke u kthyer në një fjalë me një barrë të paza-kontë polisemantike: ajo është tregu apo pazari, vendi i artit dhe i artistit, tribuna e mendimit dhe gjykimit, burimi i informacionit, vendi i famshëm i ta-kimeve, tempulli i besimit e i arsimit, teatri i një hierarkie vlerash kulturore, materiale, shpirtërore e morale. Ligjet me të cilat funksionon jeta aty, janë të rrepta, të përpikëta, të mbështetura në "luftë" vlerash, në përvoja të gjata e në traditat e lashta të kombit tonë. Por gjithë vështrimi panoramik dhe përfytyrimi i përmbledhur i Çarshisë së Madhe të Gjakovës i serviret lexuesit nëpërmjet fakteve, përshkrimeve, detajeve dhe personazheve, mbështetur në njohuritë e gjera të autorit Rizvanolli, në finesën në parashtrim dhe në intuitën e tij në citimin e shënimeve nga dijetarë, shkrimtarë apo kronikanë të ndryshëm. Për ta dhënë sa më të plotë pamjen e Çarshisë së Madhe, autori është futur në përshkrimin e shumë zejeve, si metal-punuesve, lëkurpunuesve, të përpunuesve të tekstile-ve, të kazanxhinjve, samarxhinjve, të qeleshexhinjve,

të cergaxhinjve etj. Përpunimi i metaleve përfshinte në vetvete një mori zejesh shumë të rëndësishme për kohën, si armëtarinë, argjendarinë, prodhimin e enëve të bakrit të teneqesë etj. Në shek. XVIII në Gjakovë përmendet mjeshtri i famshëm i armëve Tush dyfekxhia, i cili merrej jo vetëm me prodhimin, por edhe me zbukurimin e tyre, duke krijuar "shkollën popullore" të kësaj mjeshtërie, të njohur deri më sot me emrin e tij.

Në kapitullin që trajton armëtarinë, autori sjell in-formacion të bollshëm e mjaft interesant, duke e pa-suruar atë me citime personalitetesh të ndryshme të kohës apo studiuesish të mëvonshëm, si Franc Nopça, Sami Frashëri, Zija Shkodra, konsulli francez Hekard, Skender Rizaj, Riza Drishti, Nada Kurtovič-Folič, Najt, J. Myller etj. Sipas autorit anglez Najt, Gjakova ishte ndër qytetet më interesante, me banorë mjaft të aftë në përpunimin e metaleve. Shqiptarët e Shkodrës, të Gjakovës dhe të Prizrenit, janë mjeshtër të fam-shëm në punimin e armëve dhe të gjërave të tjera prej metali. Këtu paraqitet një galeri em-rash të mjeshtëreve gjakovarë të shek.

XIX, si Emin Kazari, Murat Nuka, Koli Jataja, Zanon Kabashi me të vëllain, Muharrem Dervi-shi, Ramadan Nuka, Çaus-h Basha, Beqir Pula etj. Por zejtarët gjakovarë ishin të talentuar edhe si argjenda-rë. Autori ka cituar Th. Ipen, që shkruante më 1898: *"... argjendarët e Gjakovës, Pe-jës e Prizrenit punojnë shumë mirë në filigran dhe me skalitje (savat)"*.

Qysh në shek.XVIII, krahas përpuni-mit të metalit shkoi edhe përpunimi i leshtit dhe i mëndafshit. Në Çarshinë e Gjakovës prodho-heshin dhe shiteshin me shumicë shajaku, pëlhurat e leshta dhe të mëndafshëta që eksportoreshin në sasi gjithnjë e më të mëdha në tregjet dhe panairët e krahinave fqinje të vendeve të Ballkanit, në vendet mesdhetare dhe në ato të Evropës Qendrore. Sipas salnameve të viteve 1887 dhe 1895, në Çarshinë e Madhe të Gjakovës lulëzonin zejet e terzinjve, të ka-zazëve dhe të tabakëve. Terzinjtë punonin kostume me vlera të larta artistike. Rrobat qëndiseshin me fije mëndafshi, ari dhe argjendi. Përparësi kishte puni-mi i rrobave kombëtare, si për gra edhe për burra, të zbukuruara me elemente autoktone. Duke iu referuar studiuesit Z. Shkodra, autori Rizvanolli ka përzgjedhur për argumentim një citim shumë elegant që lidhet

Shqiptarët e Shkodrës, të Gjakovës dhe të Prizrenit, janë mjeshtër të famshëm në punimin e armëve dhe të gjërave të tjera prej metali.

me figurën e romantikut të shquar anglez Bajron, i cili mbante rroba nga Toskëria. Ai i shkruante së ëmës: *“Imagjinata e artistit nuk mund ta konceptojë kurrë një gjë më ideale. Ky është kostumi shqiptar me ato mëngoret prej ari, të prera (të lëshuara) në formë flatrash engjëllore dhe fluturonjëse, me fustanellën e bardhë si dëbora, të mbërthyer në brez, me qëllim që të nxjerrë në pah harkun e ijeve dhe që bien mbi gjunjët në mënyrë të ujdisur në formë ujëvare, me kalsat e punuara hollë- hollë me duart e vajzave të reja dhe një mori të pafund detajesh, që është vështirë të përshkruhen. Ai që i jep burrit nuk e di se çfarë pamjeje prej ëndrrë dhe bote përrallore”.*

Duke udhëtuar përmes faqeve të tekstit, në panoramën plot jetë e kolorit të Çarshisë, lexuesi befasohet nga larmia e madhe e zejeve, “takon” persona të shumtë që i kanë krijuar, i kanë mbajtur gjallë dhe u kanë dhënë famë produkteve dhe mjeshtërisë së tyre. Njihet me organizimin e jetës brenda kësaj hapësire, me ligjet që sundojnë aty, me shtresëzimet hierarkike të këtij ansambli spektakolar dhe heraherës ndalet më gjatë, duke kundruar mjeshtërinë e një liberalidhësi, të një qeleshepunuesi, të një prodhuesi instrumentesh popullore, të një saraçi, të një cergaxhiu, të një gdhendësi druri apo punuesi gëzofësh. Por, “i kapur për dore” nga autori Masar Rizvanolli, udhëtimi virtual i lexuesit në kohë dhe në hapësirë, duket i pafund dhe gati i pamundur. Sepse koha apo historia e Çarshisë së Madhe të Gjakovës shtrihet në rreth katër shekuj. Ndërsa hapësira, që ka lidhje me ekzistencën e 1250 dyqaneve të esnafeve të ndryshme, si dhe objekteve të tjera, kulturore, arsimore, fetare, administrative etj., duket e papërshkueshme. Në këtë pikë, autori ka “thirrur në ndihmë” topografinë dhe toponiminë e Çarshisë, duke përmendur pikësëpari pozitën e përshtatshme gjeografike të Gjakovës, si një vend ku kryqëzoheshin rrugë të shumta rajonale dhe ndërrajonale e duke depërtuar më pas me vëzhgimin e tij të imët në të katër pikat e horizontit brenda Çarshisë së Madhe. Toponimet janë ngjizur në emra objekteve që kanë mosha e histori të ndryshme dhe përbëjnë vlera monumentale të trashëgimisë sonë kulturore. Kemi konkretisht Urën e Terzive me 11 harqe mbi lumin e Erenikut që lidhte Gjakovën me Prizrenin dhe Urën e Tabakëve, po mbi Erenik, që lidhte Gjakovën me

Shkodrën. Tregtarët e Gjakovës ndërtuan edhe Urën e Rabaxhinjve mbi lumin Mirushë. Ura e Rabaxhinjve u ndërtua në të njëjtën kohë me ndërtimin e Xhamisë së Kusarëve, më 1770. Në pjesën lindore të Çarshisë së Madhe ishin grupuar mëndafshpunuesit, gajtanxhinjtë, abaxhinjtë dhe sumbullaxhinjtë. Në anën e kundërt, drejt jugut, ishin sahatçinjtë dhe argjendarët, ndërsa përtej sheshit, para Xhamisë së Hadumit, te Ura e Ali pashës, shtriheshin dyqanet e manifakturës.

Duke folur për ndryshimet që pësoi Çarshia në fundin e shek. XIX- XX, autori ka nënvizuar edhe ekzistencën e shërbimit të haneve dhe të hotelerisë dhe sidomos të lidhjeve tregtare të Gjakovës me Shkodrën e me pjesë të tjera të rajonit.

Aspektit kulturor e shpirtëror të Çarshisë së Madhe i janë kushtuar disa nga pjesët më të bukura të tekstit. Aty paraqitet pamja prej një ekspozite të gjallë etnografike, ku pasqyrohet fondi i pasur i veshjeve popullore të të gjitha shtresave të qytetit dhe të fshatit, të shumë trevave të rrethinës apo viseve të largëta, që udhëtonin për të arritur ditën e pazarit, duke sjellë në këtë ditë mahnitëse koloritin e tyre të pasur. Atributin e një qendre ku përhapeshin lajmet, autori Rizvanolli na e sjell nëpërmjet evokimit të zërit të kasnecit (tellallit), që lajmëronte mbi të gjitha urdhëresat, marrëveshjet dhe sullet e ndryshme të parisë së qytetit dhe të rrethinës, të esnafeve të terzinjve dhe të tabakëve, të cilët, përveç veprimtarisë së tyre parësore ekonomike, merreshin apo kishin ndikim vendimtar në të gjitha veprimtaritë e tjera të jetës arsimore, fetare, politike, administrative dhe, madje edhe ushtarake. Duke folur për funksionet fetare- arsimore të Çarshisë, Rizvanolli përmend kujdesin e tyre për hapjen e shkollave, për pajisjen me bazë materiale të tyre dhe të nxënësve etj. Si fakt shumë i rëndësishëm theksohet këtu, përkrahja nga ana e esnafeve e lëvizjes arsimore në mbrojtje të shkollës kombëtare.

Në morinë e pafund të funksioneve që përmbante ky realitet kompleks, që quhet Çarshia e Madhe e Gjakovës, është e lehtë të merret me mend edhe ngjizja e frymës patriotike dhe kontributi i segmenteve të saj në zgjidhjen e situatave të ndërlikuara, lidhur me historinë dhe fatet e kombit, duke u kthyer shpesh në një faktor të rëndësishëm. Përmendet ndër të tjera, mbyllja e pazarit, më 24 korrik të vitit 1881, si reagim

*Duke folur
për funksionet fetare-
arsimore të zejtarëve të
Çarshisë, Rizvanolli përmend
kujdesin e tyre për hapjen
e shkollave,
për pajisjen me bazë
materiale të tyre dhe të
nxënësve etj.*

ndaj ngjarjeve që pasojnë shtypjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Gati deri në vitin 1933, deri kur pushteti i huaj i krajlit filloi të pranonte në xhandarmëri vendësit, kaçakët kalonin lirisht nëpër Çarshi para hundëve të xhandarëve serbë.

Në formën e një refreni a lajtmotivi, autori i veprës thekson: "Në Çarshi vlonte jeta" ose "Në Çarshi gumëzhinte jeta", duke shpalosur me një parashtrim mjaft elegant aspektet shpirtërore të këtij ansambli. Aty vinin për të flakur brengat e përditshme të pasurit dhe të varfërit. Shiteshin e bliheshin shtëpitë, dyqanet, mullinjat, çifligjet e pasuritë e tjera të patundshme, në praninë e "esnafëve", siç quheshin me respekt njerëzit autoritarë, që ishin dëshmitarët kryesorë të këtyre "kontratave" gojore, të cilat nuk i luante as topi. Aty përhapeshin lajmet e reja që i sillnin tregtarët gjakovarë që udhëtonin jashtë apo tregtarët e huaj që vinin për të lidhur marrëveshje afariste me prodhuesit e mallrave të ndryshme. Në Çarshi fillonte procedura e fejesave dhe "dahej vadia e martesave", që përfundonte me urimet e zakonshme, të cilat vazhdonin pastaj nëpër shtëpi. Në Çarshi, si vendi më neutral, bëhej pajtimi i gjaqeve midis familjeve të ndryshme. Duhet theksuar se qyteti i Gjakovës, me sülle ishte shpallur zonë e ndaluar për gjakmarrje për një kohë shumë të gjatë.

Jehonat e gumëzhimave të jetës së Çarshisë së Madhe të Gjakovës e shoqërojnë lexuesin e kësaj vepre duke e magjepsur jo vetëm me vlerat kulturore e historike apo me gjenialitetin anonim të arkitekturës, por edhe me faktin se si një tërësi urbane ruhet plotësisht dhe jeton e paprekur nga jeta moderne. Një shembull i rrallë i bashkëjetesës së mirë e të harmonishme të së vjetrës me të renë në një qytet; pra e reja brenda suazave të së vjetrës.

Gjithë kjo magji, që duket se do të vazhdojë pafundësisht, befasi ndërpritet më 24 mars të vitit 1999. Menjëherë pas bombave të para që hodhi NATO-ja në Kosovë kundër forcave ushtarake policore dhe paramilitare serbe, në Gjakovë filloi djegia e pamëshirshme e Çarshisë së Madhe dhe e të gjitha përmendoreve historike, kulturore e fetare. Duke e cilësuar këtë sjellje vandale si pjesë e realizimit të planeve të errëta kundër qytetëruese, të përgatitura që herët për zhdukjen e të gjitha gjurmëve kulturore historike që dëshmojnë identitetin kombëtar të shqiptarëve, autori Masar Rizvanolli na ofron një pamje rrënoqethëse, duke evidentuar një mori djegjesh e dëmtimesh të tjera të pazëvendësueshme: "Me këtë rast dogjën edhe kompleksin Xhamia e Hadumit, simbolin dhe krenarinë e qytetit të Gjakovës, bërthamën rreth së cilës u themelua Çarshia e Madhe, qendrën fetare, arsimore dhe kulturore

gjatë gjithë historisë së qytetit. Dogjën bibliotekën e saj me gjithë atë fond librash dhe dorëshkrimesh orientale dhe shqipe të shkruara edhe nga autorë gjakovarë. Dëmtuan të gjitha ato ornamente me të cilat e zbukuroi këtë xhami gjeniu anonim dhe që e renditën atë në radhën e përmendoreve më të bukura islame." Sipas një raporti të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Gjakovë, në kompleksin "Çarshia e Madhe" u dogjën 423 dyqane, 246 shtëpi, 7 objekte zyrtare, 6 punëtori- ordinance, etj. Ky vandalizëm përsëritet edhe në datat 7, 12 e 13 maj në përmasa edhe më të mëdha për të tronditur gjithë botën e qytetëruar. Por gjithë këtë realitet tmerrues autori Rizvanolli e sfidon në fundin e diskursit të tij, duke cituar fjalët e autorit grek Agathon: "Një gjë e vetme i është mohuar edhe Perëndisë- pushteti për të zhbërë të shkuarën."

Ashtu siç qe bërë burim frymëzimi për piktorët dhe krijuesit letrarë me bukurinë e saj, Çarshia u bë burim frymëzimi edhe me dramën e saj. Por në këtë frymëzim "dramatik" ndihet jo vetëm dhimbja dhe urrejtja, por edhe fryma prej feniksi e shpirtit vital të shqiptarit, që mishërohet në vargje të tilla: *Çarshi e Madhe/ nuk pate kohë të psherëtish/ për krahët e amputuar/ për ëndrrat e gjata rreze dielli/ të ulur këmbëkryq në pritjen e gjatë/ kur retë vollën vrer mbi çatitë e tua/ e ti e veshe këmishën e gjatë të heshtjes...../ Çarshi e madhe/ të renovohen rrugët me të njëjtit gurë/ nga të cilët nuk është fshirë kujtesa/ për premierat e reprizat e shumta/ që patën vetëm një dialog:/ "Qëndro loke mos u pak/ kqyr Hamz Agën në sokak/ ia kam mbush dollamën gjak"* ("Renovimi i Çarshisë së Madhe", Kadri Rodogoshi.) . Dhe frymëzimi nuk mbeti vetëm në vargjet e poetëve. Feniksi u ringrit nga hiri i vet, frymëzuar nga forca e brendshme që buron nga etja dhe domosdoshmëria për identitet kombëtar dhe Çarshia e Madhe e Gjakovës rilindi sërish nga gërmadhat e shkatërrimit, si për të dëshmuar vitalitetin dhe shpirtin e pamposhtur të kombit tonë.

Së fundi, duhet thënë që një vepër e tillë, me një parashtrim kaq të studiuar e interesant, është jo vetëm kurorëzimi i një pune të vërtetë intelektuale dhe atdhetare, por edhe një shembull i shkëlqyer për të ngulitur në kujtesën tonë historike vlera të vërteta, në emër të identitetit kombëtar.

Referenca

- 1) S. Rizaj, *Disa të dhëna mbi Gjakovën*. 349. Z. Shkodra, *Qyteti shqiptar*. 139.
- 2) Z. Shkodra, *Qyteti shqiptar*. 97. Cf. K. Halimi, *Zejtaria e Kosov- Metohis*. 32.
- 3) Aleksandar F. Gilferding, *Putovanje po Hercegovini, Bosni i Staroj Srbiji. Službeni list SRJ, Beograd, 1996*. 149- 150.



Si të organizohet jeta gjatë Ramazanit dhe disa këshilla praktike

Nexhat Ibrahim

HYRJE

Shekulli XXI po ecën fuqishëm në të gjitha pikëpamjet. Ai po imponon edhe mënyrën e jetesës, që karakterizohet me dinamikë, vrap, izolim, indiferencë, tëhuajësim. Radio-televizionet, shtypi i shkruar dhe elektronik, interneti dhe rrjetet sociale në të, po diktojnë ritëm të shpejtë të jetës. As njeriu nuk lind më si dikur, nuk rritet si dikur, nuk martohet si dikur dhe nuk vdes si dikur. Çdo gjë bëhet ndryshe së kaluarës. Madje e kaluara cilësohet si arkaike, për muze, e padobishme etj.

Të ballafaquar me këto ndryshime të menjëhershme, për shumë kënd paradoksale, një pjesë e njerëzve përpiqen, megjithatë, ta bëjnë jetën e tyre, pa i neglizhuar arritjet shkencore dhe teknike të kohës e, njëkohësisht, duke mos u bërë të varur prej tyre.

Pikërisht për këtë qëllim, do të ofrojmë disa sugjerime të thjeshta, me gjuhën më popullore, për mënyrën e organizimit më të mirë të jetës sonë shpirtërore dhe fizike, të cilat me elemente shtesë, mund të shërbejnë si model për një kohë më të gjatë.

T'I LËMË MËNJANË PARAGJYKIMET RRETH RAMAZANIT

Është bindje e një pjese të konsiderueshme të besimtarëve se Ramazani është i vështirë dhe kërkon energji të madhe dhe vullnet të pashoq, madje edhe sakrifica fizike. Për këtë arsye, shumë njerëz agjëruen nxitojnë të punojnë para ramazanit apo t'i shtyjnë disa punë pas ramazanit. Në këtë planifikim nuk ka ndonjë të keqe, sikur kjo bindje të ishte produkt i planifikimit të mirëfilltë të jetës dhe punës, i udhëhequr nga mësimet fetare. Është e saktë se agjërimi ka

angazhime shpirtërore dhe fizike. Është e saktë se agjërimi s'është i lehtë! Por gjithashtu do të themi se agjërimi nuk e rrënon njeriun, shpirtin dhe fizikun e tij. Ne nuk do të arsyetojmë me ajete e hadithe se agjërimi ndalohet në raste vështirësish ose sëmundjesh, sepse këtë do ta bëjnë juristët islamë në shkrime të llojit të vet, por do të themi se shumë paragjykime janë ngatërruar në këto llafe çajtoresh, kafenesh apo ndenjesh të kota. Leximi i ajeteve kuranore dhe i haditheve të Muhamedit (a.s.), për agjërimin janë plot humanitet e altruizëm, solidaritet e vëllazëri.

ORGANIZIMI I KOHËS TË BËHET ME URTËSI

Koha duhet të programohet me urtësi, duke i harmonizuar nevojat njerëzore në mënyrë sa më racionale. Nëse janë më pak obligime, ato mund të programohen edhe në kokë, por nëse ka më shumë sosh, atëherë duhet hartuar lista e obligimeve. Respektivisht të bëhet programimi i ditës e javës në letër apo edhe në telefon celular. Jepi përparësi detyrave më të rëndësishme, sidomos bisedave telefonike afariste, apo adresave urgjente, që pjesën tjetër të ditës t'ua kushtosh punëve të tjera. Planifiko edhe fuqinë edhe kohën, që të jesh i freskët për tërë ditën. Nëse për ndonjë arsye, disa nga detyrat e sotme kanë mbetur pa u përfunduar, kaloji ato detyrime për ditët vijuese. Llogariteni kohën për obligimet fetare, për trafikun urban dhe për përgatitjet për iftar, pastaj për ligjëratat e parajacisë dhe vetë jacinë-teravinë. Ndoshta fundi i ditës, nëse ka mbetur diçka nga koha, mund të shfrytëzohet për ndonjë lexim, relaks ose për ndonjë lajm për të përmbyllur ditën plot obligime e punë.

FUQINË PLANIFIKOJE ME MENÇURI

Agjërimi e bën njeriun më gjakftohtë, më të qetë, më pak agresiv, më zemërbutë, më solidar. Agjëruesi ka vetëkontroll dhe disiplinë. Të gjitha obligimet ditore duhet t'ia nënshtrojë këtij vetëkontrolli. Agjëruesi duhet të bëjë pushim të caktuar, ndërmjet obligimeve ditore. Të freskohet



“Njerëzit gjithnjë do të jenë në të mirë, deri sa të nxitojnë në bërjen e iftarit.”



me oksigjen, ta freskojë vendin e punës, nëse gjendet brenda objektit dhe të ndjekë ecurinë e gjërave sipas planifikimit. Mbajeni në mend: shumë stresa janë pasojë e objektit me ajër të ndotur dhe pasojë e ngatërimit (mbingarkimit) të obligimeve. Nëse vëreni që shumicën e kohës jua merr ndonjë punë, verifikojeni vetveten dhe riprogramojeni kohën. Në këtë mënyrë, ditët e agjërimit do t'i lehtësoni nga ngarkesat e zakonshme.

1. Ibadetet le të shërbejnë si pushim ditor

Ibadetet janë shtyllat e jetës së njeriut. Në këtë aspekt namazi dhe agjërimi, si ibadete, kanë rolin kryesor. Këto obligime e pushojnë, por edhe e harmonizojnë aktivitetin ndërmjet mendjes, trupit dhe shpirtit. Të tillë janë iftari dhe syfyri, simbole të saktësisë dhe korrektesisë. Muhamedi (a.s.), thotë: “Njerëzit gjithnjë do të jenë në të mirë, deri sa të nxitojnë në bërjen e iftarit.” (Buhariu dhe Muslimi). Është mirë që gjatë gjithë kësaj kohe të lexohet Kuran, para ose pas namazit, aq sa është mundur. E do të ishte mirë që brenda muajit të lexohet tërë Kurani. Nëse gjatë ditës s'do të kishte pauzë tjetër për pushim, namazet do ta kompensonin edhe pjesën e pushimit, relaks fizik dhe prehje shpirtërore.



2. Fli mirë

Nëse kthimi nga namazi i teravisë zakonisht është rreth orës 23.⁰⁰, përpiku që brenda gjysmë ore të përgatitesh për gjumë. Në këtë mënyrë do të jesh më i freskët për syfy (sehur). Kjo vlen sidomos për ata që punojnë të nesërmen. Për ata që punën e kanë më vonë, ose natyra e punës së tyre nuk kushtëzohet me orar të caktuar, atëherë në gjumë mund të shkohet pas namazit të sabahut.

Është mirë që, pas namazit të drekës, në kohën e ushqimit të zakonshëm, jashtë ramazanit, të pushosh (flesh) pak. Kjo periudhë, për ata që janë të lirë, është e mirëseardhur. Ky pushim apo gjumë, do ta relaksojë njeriun edhe në shpirt edhe në trup.

3. Ha dhe pi mirë

Kujdesi ndaj ushqimit duhet të jetë i përherëshëm. Duhet të ushqehemi prej akshamit e deri në syfy. Të gjitha nevojat ushqimore, të ushqimit të ngurtë apo të lëngshëm, duhet t'i konsumojmë, në intervalet përkatëse. Kjo periudhë agjërimit duhet të shërbejë edhe si qortim për ne, që të mos bëjmë shpenzime të tepruara, sepse agjërimit është muaj kursimi e jo konsumi të tepruar. Shporta e myslimanëve, për fat të

keq, vitet e fundit po tregojnë rritje të konsumit të mishit e të lukseve të tjera gjatë ramazanit, kurse shumë myslimanë e njerëz të tjerë jetojnë në varfëri të skajshme apo rrezikojnë të vdesin për ushqim e pije. Është përgjegjësi e myslimanëve që agjërimit të bëhet shkollë kursimi e edukimi, arsimimi e angazhimi e jo shkapërderdhjeje e teprimi. Viteve të fundit, praktika jonë nuk është për t'u lavdëruar. Bëhen shumë shpenzime për ushqim dhe pije për miqtë e jaranët, por jo për të varfërit.

4. Koha e lirë

Përkundër shumë obligimeve, myslimani gjen kohë edhe për pushim, apo atë që e quajmë "kohë të lirë". Kjo kohë zakonisht më herët kalohet në salavat, nafle apo lexim Kurani. Mirëpo, kohëve të fundit, për ta arritur më lehtë kohën e iftarit, myslimanët shikojnë TV apo e kalojnë kohën kot në internet. Disa të tjerë e kalojnë kohën pas iftarit e deri në syfyr nëpër kafene, çajtoje, restorante apo lojëra të tjera. Nëse agjërimit do ta kuptojmë si kohë devotshmërie (takvallëku) e jo humbakohe, atëherë myslimanët duhet ta programojnë atë. Ramazani nuk është muaji i shahut, dominove, konterit, letrave të bixhozit, ahengjeve plot përgojim e përqeshje; as kohë e mitingjeve të poezisë, këngës apo filmave, por kohë e ibadetit të përkushtuar.

5. Përbushja e obligimeve

Çdonjëri prej nesh duhet t'i bëjë planifikimet materiale dhe shpirtërore. Krahas ibadeteve shpirtërore, kemi edhe obligime materiale. Duhet shikuar a janë plotësuar planifikimet e fillimit të ramazanit. Po ashtu, shiko që zekatul-fitrin ta dorëzosh në institucionin e bashkësisë islame të vendit ku jeton për përbushjen e obligimeve në pajtim me ajetin kuranor për sadekatet. Shih xhaminë e lagjes tënde, jetimoren apo shkollën e lagjes, ndonjë skamnor që pret ndihmën tuaj. Ndoshta nuk do të bësh shumë, por çdo aktivitet, sado i vogël, është më mirë se të braktiset krejtësisht shprehia e mirë e dhënies së ndihmës.

Kurani dhe Ramazani

Ali Byjyçapar

*A*gjërimi i Ramazanit, i cili qëndron nën hijen e Kuranit Fisnik, i fal jetës sonë të përkohshme një freski përjetësie. As që mund të mendohet që njeriu, i cili është nderuar me ekzistencën, ta humbë këtë mirësi të madhe.

Në këtë jetë të vështirë, pa dashje në mendje të vjen pyetja, "a ka ndonjë vend lumturie?". E ndërsa njerëzit mundohen t'i japin kuptim ndodhive, Ramazani i fton në atmosferën e Kuranit.

Ramazani është muaji i Kuranit.

Libri i pashoq, i cili i tregon njerëzimit mënyrën për të arritur përjetësinë, këtë muaj mbush me dituri hojet e shpirtit. Pastaj me qëllim që t'i përvetësojmë ato (dituri), na vë përpara jetën.

Për të kuptuar jetën, për të thithur të vërtetat brenda kohës së një dite dhe për t'u pajisur me zemra që do të luftojnë me të keqen, kemi nevojë për zërin e Kuranit. Shpëtimi i njerëzve që janë futur në rrugë pa krye, mund të jepet vetëm me Kurantin. Islami, i cili konceptin teori-praktikë e ka shkrirë në enën e punëve të mira, i ka ndaluar edhe debatet e kota që të përziejnë stomakun dhe tërheq vëmendjen ndaj këtyre gabimeve.

Përveç Allahut, kush do të japë informacion më të besueshëm në lidhje me vdekjen, e cila konsumon jetën dhe na e vështirëson çdo ditë që kalon?

Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon

këtë muaj, le të agjërojë! Sa i përket atij që është i sëmurë ose gjendet në udhëtim e sipër, le të agjërojë më vonë aq ditë sa nuk i ka agjëruar. Allahu dëshiron që t'jua lehtësojë dhe jo t'jua vështirësojë. Ai dëshiron që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka drejtuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë. (El-Bekare, 185.)

Agjërimi është një urë vlerash. Nëse njeriu nuk largohet nga mirësitë e përkohshme, nuk mund të arrijë ato të përjetshmet. Nëse fëmija nuk ndërpret qumështin, nuk mund t'i shijojë ushqimet e ndryshme. Në agjërim gjenden shumë gëzime dhe mirësi materiale e shpirtërore, individuale e shoqërore, jetësore e morale.

Fjalët e Profetit tonë të dashur (a.s.), na mbushin me shpresë:

"Agjërimi dhe Kurani do të jenë ndërmjetësues për robin në ditën e gjykimit¹. Agjërimi është gjysma e durimit. Heshtja e agjëruarit është dhikër, gjumi i tij është adhurim, duaja i pranohet, ndërsa shpërblimi i punës i shumëfishohet."

Çdo besimtar duhet ta shfrytëzojë këtë muaj, duke u larguar nga gjynahet dhe të këqijat, duke lexuar dhe dëgjuar Kuran, duke dëgjuar ligjëratat dhe duke falur namazet e teravisë. Nuk duhet ta kalojmë kohën me punë dhe fjalë të padobishme. Ramazani është pranvera e botës shpirtërore, prandaj le ta mbushim bahçen e kësaj bote me dhikër, Kuran dhe salavate për Profetin (a.s.) dhe ta ruajmë atë nga erërat e pakujdesisë.

1. Ahmed ibën Hambel; Musned, no: 626, 11/199).

Një shikim modern i mendimeve dhe konstatimeve të Ibën Haldunit në lidhje me politikat e administrimit publik dhe ekonomik

Vijon nga numri i kaluar...

POLITIKAT E ADMINISTRIMIT PUBLIK

Ibën Halduni nuk parashikon një menaxhim shtetëror të veçantë. Ai nuk i kundërshton strukturat politike si sulltanatet. Mirëpo, ai na tërheq vëmendjen se çfarëdo lloj menaxhimi shtetëror qoftë, shtypja e tepërt ndaj popullit ndikon në mënyrë shkatërruese tek individit (në botën psikologjike dhe shpirtërore) dhe për pasojë edhe në jetën ekonomike dhe sociale.

Ibën Halduni është i mendimit se parimisht, nënshtrimi ndaj një autoriteti politik (nënshtrimi ndaj ligjeve që vendosin të tjerët "përfaqësuesit e shtetit etj.", pengon formimin dhe zhvillimin e një personaliteti të lirë dhe të pavarur tek individët: "Njerëzit menaxhohen sipas rregullave të vendosura nga një grup i vogël drejtuesish. Nëse drejtuesit nuk veprojnë me drejtësi dhe butësi, por ndjekin rrugën e padrejtësisë, shtypjes dhe dhunës, tek individët dobësohet besimi në vetvete, ndjenja e trimërisë dhe e kurajës. Kështu që këtyre njerëzve, u shkatërrohet personaliteti dhe u thyhet egoja. Për pasojë, ata janë të gatshëm të pranojnë shtypjen dhe poshtërimin dhe humbasin kurajën dhe guximin për të mbrojtur vetveten."

Ibën Halduni, jep këto këshilla për zbutjen ose eliminimin e pasojave negative që shkakton në personalitetin dhe psikologjinë e individëve nënshtrimi ndaj ligjeve që vendosin autoritetet politike:

Rregullat shoqërore (morale dhe fetare), të cilave individit duhet t'u nënshtrohet, duhet të ofrohen në mënyrë të atillë, që njeriu të mos kaplohet nga ndjenja e të qenit i detyruar t'u nënshtrohet rregullave që vijnë nga jashtë dhe ndjenja e humbjes së lirisë, por t'i pranojë ato në mënyrë natyrale duke i përvetësuar vetvetiu. Pra, individit dhe rregullat të bëhen një trup i vetëm dhe ai të mos kaplohet nga ndjenja e të qenit i detyruar të zbatojë rregullat që vijnë nga institucionet dhe njerëzit jashtë tij. Nëse veprohet në këtë mënyrë, nderi, personaliteti dhe liria e individit nuk çënohen. Prandaj edhe fiset endacake, të cilat jetojnë me rregulla dhe ligje që nuk janë vënë nga dikush jashtë tyre, janë më të guximshëm dhe kanë më tepër besim në vetvete. Ndërsa ata që jetojnë në qytete nën presionin e ligjeve dhe organeve shtetërore, janë më pak të guximshëm dhe nuk kanë besim në vetvete. Për këtë arsye, rregullat e "sistemit politik fetar" përvetësohen shpirtërisht nga individët që i pranojnë këto rregulla. Përkundrazi, "politika e dalë nga mendja e njeriut" nuk përmban veçori të tilla.

Mund të thuhet se në këtë pikë, Ibën Halduni kërkon të na tërheq vëmendjen tek problemi i legjitimitetit. Nëse individët e pranojnë si legjitim regjimin politik që i drejton, nënshtrimi ndaj autoriteteve nuk krijon pasojë psikologjike. Siç do të thoshte edhe vetë Ibën Halduni, "nuk do t'i çënonte ndjenjat e nervozizmit të individit". Por në të kundërtën,

nëse njerëzit nuk e pranojnë si legjitim regjimin nën të cilin ndodhen (regjimet tepër shtypëse dhe nën pushtim), bota psikologjike e individëve rrënohet dhe populli e humbet dëshirën për të punuar dhe prodhuar.

Pra, mund të themi se në bazë të analizës që ka bërë për kohën e tij, Ibën Halduni mbështet këto mendime: Në periudhën e fillimit të formimit të një shteti, idealet dhe vlerat e përbashkëta që i lidhin drejtuesit me popullin janë shumë të fuqishme. Sundimtari dhe drejtuesit e tjerë respektojnë të drejtat dhe liritë e popullit, nuk e shtypin dhe janë të mëshirshëm me të. Pra, në këtë periudhë në të cilën nuk ka probleme legjitimiteti midis autoritetit politik dhe popullit, shtohet dëshira për punë dhe sukses. Gjithashtu shtohet dëshira për të kryer veprimtari ekonomike, shpirti luftarak e kaplon gjithë popullin dhe vihen në veprim të gjitha forcat dhe burimet prodhuese:

“Në sajë të mëshirës dhe dashamirësisë së shtetit, shtohet puna dhe shpresa e shtetasve. Ata punojnë me dëshirë në ndërtimin e vendit dhe përpiqen të përgatitin shkaqet e ndërtimit. Si rezultat, vendi rimëkëmbet dhe zgjerohet, ndërsa brezat dhe popullsia shtohen”.

Mirëpo jo gjithmonë ndodh kështu. Pas një kohe, drejtuesit zhyten në luks dhe shpenzime të tepërta dhe fillojnë të sillen mizorisht ndaj popullit. Nga kjo mizori dhe taksat e rënda, dëmtohet populli dhe veçanërisht ata që merren me bujqësi. Shteti vë dorë mbi pasurinë dhe pronat, ndërsa populli sa vjen dhe mjerohet nga taksat e rënda. Këto kushte që nuk i përshtaten dinjitetit njerëzor, i bëjnë njerëzit të bien në një gjendje të mjerueshme dhe të padurueshme. Dhe për pasojë, pakësohet ose eliminohet përpjekja e tyre për të prodhuar dhe fituar. Kjo gjendje nxjerr në pah një problem legjitimiteti midis popullit dhe autoritetit politik. Nëse autoriteti politik humbet respektin dhe legjitimitetin në sytë e popullit, ai (populli) pëson një krizë psikologjike dhe më në fund braktis punën. Tokat mbeten të papunuara dhe vendi futet në një krizë sociale, politike dhe ekonomike.

Një gjendje e ngjashme vërehet edhe tek një popull që detyrohet të jetojë nën poshtërimin dhe shtypjen e një autoritetit politik jo legjitim, i cili ka ardhur si pushtues. Këta njerëz, të cilët kanë pësuar një rrënim psikologjik, nuk humbasin vetëm dëshirën për të punuar dhe fituar, por së bashku me të humbasin edhe dëshirën për të jetuar. Aq sa edhe popullsia nuk shtohet, madje braktis edhe ushqimin. Si përfundim, pushojnë së ekzistuari mbi faqen e

dheut.

Ibën Halduni, duke dhënë si shembull kafshët e egra që bien në dorë të njerëzve, thotë se edhe kafshëve në kushtet e robërisë u pakësohet ose u zhduket dëshira për t'u ushqyer dhe riprodhuar. Ngjashëm me këtë, ai na jep të dhëna me shifra se si persianët, gjatë pushtimit nga ana e arabëve, në një kohë shumë të shkurtër u shkatërruan jo vetëm nga ana materiale, por edhe nga ana psikologjike.

Sipas Ibën Haldunit, tirania që e pengon popullin të jetë aktiv në fushën ekonomike, duhet kuptuar në mënyrë të gjerë. Pranë tiranisë më mizore, edhe ulja e pagesës së punëtorit, kërkimi i diçkaje (qoftë edhe e pakët) prej popullit në mënyrë të padrejtë, ngarkimi i popullit me detyrime që nuk parashikohen nga sheriati (ligji islam), mbledhja e taksave pa të drejtë, detyrimi i njerëzve të punojnë pa pagesë, blerja e mallrave të popullit me çmim shumë të ulët ose shitja e mallrave shtetërore, duke i detyruar njerëzit t'i blejnë me çmim të lartë etj., konsiderohen shtypje dhe padrejtësi ndaj popullit. Të gjitha këto “presin shpresën e popullit për të ndërtuar vendin duke punuar” dhe pengojnë forcimin e shtetit.

Mirëpo, ky ndryshim në dëshirën e popullit për të punuar dhe jetuar, nuk ndodh menjëherë, por dalëngadalë. Nëse shteti është i drejtë dhe respekton të drejtat dhe liritë e popullit, gjallërimi i ekonomisë dhe aktivizimi i mendjes dhe i shpirtit të popullit rritet dalëngadalë. Por, nëse shteti është tiran dhe e shtyp popullin me taksat e rënda, i gjithë populli, dalëngadalë bëhet pesimist dhe pasiv. Ndonjëherë, realizimi i këtij ndryshimi ndodh në një periudhë kohore prej një apo dy brezave.

Të kujtosh se pasuria e shtetit shtohet duke ulur shpenzimet e shtetit në maksimum dhe duke e mbushur arkën, është një gabim shumë i madh. Përkundrazi, pasuria e shtetit gjendet në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullit dhe në ruajtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, gjë kjo e cila do ta gjallëronte popullin nga ana ekonomike dhe do ta bënte atë më aktiv dhe prodhues.

Po me të njëjtën arsye, pra për mundësinë e rreziqimit të të drejtave dhe lirive të individit, Ibën Halduni është kundër veprimtarive ekonomike që mund të zhvillojë vetë shteti, si tregtia dhe bujqësia.

Ky qëndrim i tij ka dy arsye kryesore. Së pari, duke përdorur fuqinë politike dhe mundësitë e mëdha financiare që zotëron, shteti do të krijojë konkurrencë të pandershme kundrejt tregtarëve dhe fermerëve të tjerë. Tregtarët dhe fermerët, të cilët nuk arrijnë t'i mbijetojnë kësaj konkurrence, do të jenë të detyruar të falimentojnë dhe të tërhiqen nga veprimtaria ekonomike. Kjo konkurrencë e padrejtë dhe forcë e pabarabartë, dhunon të drejtat e atyre që ndërtojnë vendin, duke u marrë me tregti dhe bujqësi. Thyen dëshirën dhe ambicien e popullit për të punuar dhe prodhuar. Më në fund, jeta ekonomike hyn në krizë, shkon drejt shkatërrimit dhe shteti dëmtohet rëndë. Kjo, për shkak se në një krizë ekonomike, të ardhurat që humbet shteti nga vjelja e taksave janë më të shumta se sa ato që fiton duke u ingranuar edhe vetë në jetën ekonomike.

Së dyti, sipas Ibën Haldunit, forcimi i fuqisë politike të shtetit me fuqi ekonomike, pra drejtimi i jetës ekonomike nga ana e shtetit, vë në rrezik të drejtat dhe liritë e individit. Nëse pushtetarët fillojnë të merren me bujqësi, brenda një kohe të shkurtër, duke përdorur fuqinë politike, ata do të pengojnë aplikimin e çmimeve të lira dhe do ta detyrojnë popullin të blejë dhe të shesë mallra me çmimet që i përcaktojnë ata vetë. Kjo gjë e kthen përmbys jetën ekonomike të popullit dhe i hap derën tiranisë dhe padrejtësisë. Së fundi, edhe pse ata (pushtetarët) nuk e vënë re, të ardhurat nga taksat do të ulen.

Ibën Halduni këmbëngul në faktin se, jo vetëm në marrëdhëniet shtet-popull, por edhe në marrëdhëniet baba-fëmijë, mësues-nxënës dhe usta-çirak, ballarët, mësuesit dhe ustallarët duhet t'i shmangen sjelljes me autoritet të hekurt dhe dhënies së dënimeve të ashpra me qëllim mësim-edukimin. Prandaj, ai e quan detyrë të shtetit vendosjen e një kontrolli për të konstatuar dënimet e ashpra që japin mësuesit ndaj nxënësve. Kjo, për arsye se Ibën Halduni mendon që këto sjellje lënë gjurmë të thella dhe të këqija në botën shpirtërore të fëmijës. Thyen ndjenjën e besimit në vetvete dhe ul dëshirën për të punuar dhe për të arritur sukses. Shkaktojnë humbjen e dëshirës për të jetuar dhe i shtyn ata në gënjeshtër, dembelizëm dhe vese të tjera të këqija. Fëmijë që rriten në kushte të tilla, në vend që të jenë të drejtë dhe të kenë mendime të ha-

pura, për shkak të shtypjes së personalitetit me anë të frikës ndaj dënimeve, bëhen njerëz dyfytyrësh, pa karakter dhe hileqarë. Me kalimin e kohës, këto sjellje bëhen të zakonshme dhe pjesë e karakterit të tyre. Kështu që, njerëzit që nuk e kanë kuptuar mirë nderin e të qenit "halife e Allahut në tokë", bëhen të paaftë të mbrojnë veten, familjen dhe shoqërinë ku jetojnë. Bëhen të papërgjegjshëm dhe bien në nivele të ulëta dhe poshtëruese. Njerëz si këta, në ekonomi janë dembelë dhe kanë një dëshirë të ulët për sukses. Ndërsa në politikë, për arsye se kanë humbur ndjenjën e "kundërvënies", janë të paaftë t'u rezistojnë armiqtë të jashtëm. Pra, janë të privuar nga "guximi" dhe "iniciativa".

Mendimet e Ibën Haldunit, në lidhje me autoritetin publik (shtetëror) dhe liritë individuale, janë shumë interesante, sepse çështje të tilla janë të rëndësishme dhe të vështira edhe në historinë e mendimit politik të sotëm. Siç dihet, që nga periudha klasike e këtej, mendimet për çështjet paradoksale në fjalë, kanë qenë të polarizuara në dy drejtime. Sipas mendimit të parë, individët në vetvete (si njerëz), nuk kanë të drejta dhe liri. Ato që i quajmë të drejta dhe liri, nuk janë gjë tjetër veçse diçka (mirësi) që shteti (mbreti) u jep shtetasve të tij. Ndërsa sipas mendimit të kundërt, njeriu zotëron të drejta dhe liri, për shkak se ka lindur si i tillë. Autoriteti shtetëror është diçka brenda kufijve të "kontratës shoqërore" që populli i ka dhënë shtetit dhe si e tillë duhet të ngelet e kufizuar.

Nëse e vëmë re me kujdes, mendimi i Ibën Haldunit përkon me vijën e dytë që përmendëm. Çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ai e trajton si diçka të natyrshme dhe thelbësore dhe asnjëherë nuk e shikon atë si diçka (mirësi) që jepet nga kryetari i shtetit (mbretit). Sipas tij, kjo çështje është aq e qartë, sa nuk ka nevojë as të debatohet.

Nëse marrim në konsideratë periudhën në të cilën ka jetuar Ibën Halduni, shohim se mendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë përtej kohës së tij. Në Evropë, që nga "**Magna Carta Libertatum**" (Marrëveshja e madhe e lirisë) (1215), e deri në shekullin e tetë, të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur, kanë pasur për bazë mendimin e parë. Pra, të gjitha zhvillimet që janë shënuar në lidhje me të drejtat dhe liritë e njeriut, kanë qenë si pasojë e kërkesave që i janë bërë mbretit për të qenë "bujar" dhe janë bërë të ditura me anë të një dekreti që ka lëshuar ai (mbreti).

Nuk është e mundur të pajtohesh me diferencimet

dhe përgjithësimet midis Azisë dhe Evropës, që ka bërë Fernand Grenard në lidhje me këtë çështje. Të paktën për Evropën deri në shekullin e tetë:

*"Të gjesh një ekuilibër midis autoritetit shtetëror dhe lirisë: Ndërsa Evropa kërkon zgjidhje të pranueshme, Azia e zgjidh çështjen me mënyra të vështira, të paqarta dhe të pavendosura. Për një evropian, liria është një e drejtë, ndërsa për një aziatik indiferencë dhe neglizhencë. Në Evropë, autoriteti shtetëror është aq sa populli i jep atij (shtetit). Ndërsa në Azi, liria është ajo që autoriteti shtetëror nuk e merr vetë (në shenjë bujarie)."*¹

Sipas Platonit, *"të gjithë duhet të edukohen që të mos veprojnë sipas dëshirës, madje as të mos e mendojnë të veprojnë të pavarur, deri sa të humbin aftësinë për të vepruar të tillë. Askush nuk duhet të mësohet të bëjë punë me mendjen dhe iniciativën e vet. S'duhet të mendojnë tjetër, përveç nënshtrimit ndaj prijësit (shtetit)".*² Në mendimin perëndimor, duke filluar nga Platoni dhe Aristoteli, e deri tek Hegeli, Musolini dhe Hitleri, të cilët janë cilësuar nga Carl Popper si "armiqtë e shoqërisë së hapur", gjithmonë kanë ekzistuar ide autoritare që e shenjtërojnë dhe e adhurojnë shtetin dhe që kanë për bazë filozofinë se *"Shteti nuk është për individin, por individ është për shtetin".*

"Për një fashist, çdo gjë është brenda shtetit. Jashtë tij (shtetit) nuk mund të ekzistojë asgjë njerëzore apo shpirtërore dhe asgjë nuk ka vlerë... shteti është krijuesi i së drejtës... Shteti fashist e fut njeriun, të gjithin nën një disiplinë dhe bëhet shpirti i shpirtit të tij... Fashizmi kërkon disiplinën dhe autoritetin që do të zhytet në thellësinë e shpirtit dhe do të sundojë aty pa u kundërshtuar". (Musolini).³

Këtu shohim qartë se sa larg këtij mentaliteti poshtëruës është sistemi i Ibën Haldunit. Shohim se sa e beson dhe e mbron, siç thotë Popper, "shoqërinë e hapur". Madje shohim se ai është një mendimtar, i cili këtë besim e vendos në themelin e sistemit të mendimit në çdo çështje, politike, ekonomike, edukative etj.

Para se ta përfundojmë këtë temë, me qëllim që të nxjerrim në pah forcën e ndikimit të mendimit të Ibën Haldunit, duam t'ju tregojmë shkurt për rezultatet e disa kërkimeve që janë bërë në ditët e sotme, rreth gjashtë qind vjet pas tij. Këto kërkime janë në lidhje me shtypjen dhe formën e lirisë që krijon administrimi publik dhe autoriteti shtetëror. Ndikimin dhe marrëdhënien që ka midis zhvillimit dhe përparimit të shoqërive;

1. Grenard: 233-234

2. Popper: 110-111. I njëjti vend 74-75, 100, 138, 208, 261, 353-354.

3. Tunçay: V. III, 252-254.

Vëzhgimet dhe konstatimet që janë bërë në vende të ndryshme të botës së tretë, tregojnë se faktori më i rëndësishëm, i cili pengon zhvillimin e këtyre vendeve, është "keqmenaxhimi". Një specialist zhvillimi, Guy Sorman, duke u mbështetur në kërkimet dhe vëzhgimet që ka bërë në tetëmbëdhjetë vende të botës së tretë, shkruan:

*"Të ardhurat për frymë në botën e tretë dhe prapambetja teknologjike, nuk mund të arsyetojnë me ...kolonizimin...etj. Ajo që tregon se një shtet është prej vendeve të botës së tretë, është sistemi politik. Fuqia autoritare dhe totalitare, e drejta e fjalës dhe institucionet e vendeve të treta, janë në dorë të një kaste politike, e cila i përdor sipas dëshirës. Botë e tretë nuk do të thotë vetëm varfëria e masave. Por në të njëjtën kohë, do të thotë: fitore e vazhdueshme e të fortëve mbi të dobët (në çdo fushë), ideologjitë e çmendura që bëjnë ligjin, mbizotërimi i politikës ndaj ekonomisë, dhe hierarkisë ndaj aftësisë, mosnjohja e të drejtave të njeriut, ndalimi i kritikës dhe poshtërimi i njeriut".*⁴

Rezultati i këtij studimi trevjeçar që Sorman ka bërë në tetëmbëdhjetë vende të botës, si Egjipti, India, Kina, Brazili, Koreja, Kuba, Afrika Jugore etj., shkurtimisht mund të shprehet kështu:

Faji për zhvillimin e dobët nuk mund t'i hidhet as historisë, as pozitës gjeografike, as kushteve klimatike dhe as kulturës. Shkaku që shtyp njerëzit, i degjeneron dhe i nxjerr prej rrugës, duke u prishur moralin, është administrata publike. *"Si përfundim i një studimi konkret të popujve që kanë cilësi të ndryshme nga njëri-tjetri, konstatova se në vendet e botës së tretë, ato që përcaktojnë rregullin janë institucionet publike."*⁵

Përfundim

Kur shohim këto konstatime të kohës së sotme, nuk mund të mos na kujtohen konstatimet e gjash-të shekujve më parë të Ibën Haldunit. Kur shohim evidencat e tij, nuk mund të mos habitemi dhe të mos themi "Po, është e vërtetë". Këto janë rrezet e dritës, që ky gjeni na i ka dërguar që para gjashtë shekujsh.

M. S.

4. Sorman: 20-21.

5. Sorman: 97, 166.



Ramazani dhe agjërimi

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Ramazani është muaji i agjërimit, Kuranit dhe mëshirës. Ramazani ka një klimë të ngarkuar, pasi është muaji kur ka nisur të shpallet Kurani dhe kur është bërë obligim agjërimi, si një nga pesë kushtet e islamit. Ajo që e bën Ramazanin muaj të madhërueshëm është Kurani dhe agjërimi. Agjërimi është një adhurim që Allahu i Madhëruar e ka lartësuar me fjalët *“Agjërimi është për Mua. Shpërblimin ia jap vetëm Unë!”* (Buhari, Savm, 2.) Ky hadith kudsi ka dy domethënie:

1. Agjërimi zë një vend të veçantë në mesin e adhurimeve. Ndryshe nga adhurimet e tjera, vetëm agjërimi është një adhurim që tjetri mund të mos e vërejë, për vetë karakteristikën e tij, që nuk është diçka që shfaqet. Agjërimi është adhurimi më afër statusit të *ihsan*-it (të adhurosh Allahun, sikur e sheh Atë).

2. Në agjërime manifestohet atributi “Samed” i Allahut. Ky atribut ka kuptimin që gjithçka dhe gjithkush ka nevojë për Allahun, ndërsa Ai nuk ka nevojë për asgjë dhe askënd. Në sajë të agjërimit, tek njeriu manifestohet pikërisht

atributi në fjalë, duke u shkëputur nga nevoja e të ngrënit dhe të pirit. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar u drejtohet *“Shpërblimin ua jap vetëm Unë!”*, atyre që veshin petkun e atributit dhe moralit të Tij.

Allahu premton për ata që bëjnë vepra të mira, që do t’i shpërblejë nga dhjetë deri në shtatëqind fish. Porse, për ata që bëjnë sabër, shpërblimin do ta kënë të pafund. (Kurani, Zumer, 10). Duke u nisur nga thënia profetike *“Agjërimi është gjysma e durimit”*, kuptojmë se agjërimi njëkohësisht është edhe një veprim prej durimi, andaj dhe shpërblimi është i pamasë.

Agjërimi nuk është vetëm një veprimtari fizike që kufizohet me lënien mënjanë të ushqimit. Për të arritur qëllimin e tij agjërimi, si edukues i vullnetit të njeriut, frenues i egos (nefsit) dhe sistemues i mendimeve me qendër ibadetin, duhet mbajtur edhe me këto organe:

1. Syri duhet ruajtur që të mos shohë të ndaluarat, të dyshuarat dhe të panevojshmet.

2. Veshi duhet ruajtur që të mos dëgjojë gjëra të



ndaluara, gjëra që janë gjynah dhe që prishin natyrshmërinë e njeriut.

3. Gjuha duhet mbajtur larg fjalëve të kota, të panevojshme, thashethemeve dhe shpifjeve.

4. Zemra duhet mbushur me dashuri për Allahun dhe duhet pastruar nga mendimet e ndaluara dhe ambiciet e panevojshme.

5. Dora duhet mbajtur larg gjërave të ndaluara, të dyshuara dhe të shëmtuara.

6. Këmba ruhet duke mos ecur në udhën e diçkaje që nuk të është urdhëruar apo kërkuar nga Zoti.

Ebu Talib Mekki tërheq vëmendjen tek këto gjashtë pika dhe kujton se agjërimi, duke bërë kujdes këto organe, sjell virtyt tek agjëruesi. Agjërimi nuk është thjesht një adhurim që realizohet duke qëndruar pa ngrënë e pa pirë. Ka prej *evlijave* që mendojnë se edhe thashethemet prishin agjërimin, të paktën heqin shpërblimin shpirtëror të agjërimin. Qëllimi i agjërimin nuk është të qëndruarit pa ngrënë dhe pa pirë, por është të jetuarit pa gjynahe, ashtu sikurse qëllimi i namazit është të qëndruarit larg fjalëve dhe sjelljeve të shëmtuara. Pa hequr dorë nga gënjeshtria dhe të vepruarit me të, Allahu nuk ka nevojë për qëndrimin tonë pa ngrënë e pa pirë.

Të agjërosh është të përpiqesh të kontrollosh nefsën dhe dëshirat e përkohshme dhe të prishtura. Padyshim, edhe kjo ka kushtet e veta.

Krahas ruajtjes së stomakut nga ngrënia dhe pirja, ruan organet e lartpërmendura dhe të gjithë trupin nga rënia në kundërshtim me she-riatin. Kësaj i thonë agjërimi me pesë shqisa.


Allahu e ka krijuar njeriun, si gjallesë që ka nevojë të marrë ushqim për të vazhduar jetën e tij. Mirëpo kjo nevojë, nuk duhet të bëhet objektivi i jetës së njeriut. Në këtë kontekst, nefsi duhet ruajtur nga lojrat dhe dëfrimet e padobishme, pra duhet qëndruar larg gjërave të ndaluara dhe të kota. Çdo vepër e atij që ruan veten nga gjynahet, ka vlerën e agjërimin.

Le të kujtojmë diskutimin e famshëm: “Bota ekziston për njeriun për t’a ushqyer apo për t’i dhënë mundësinë që të jetojë?” Njerëzit e Zotit rekomandojnë ushqim aq sa për të jetuar dhe për të pasur fuqi për të bërë ibadet. Ndërsa *ehlu’d-dunja* (njerëzit e dynjasë) preferojnë të jetojnë për të ngrënë. Njeriu që jeton me qendër ushqimin, nuk shpëton pa u kapur nga grepi i Iblisit. Sepse profesioni i Iblisit është t’ia bëjë sa më të dashur njeriut ngopjen.

Shkaku përse u nxor nga xheneti Hz. Ademi, ishte tamahu për ushqim, dëshira për të ngrënë frutin e ndaluar në xhenet. Sikurse në çdo adhurim, edhe në agjërim, qëllimi i tij është sinqeriteti dhe devocioni. Besimtarët e mençur veprojnë me sinqeritet dhe bëjnë kujdes për të qëndruar larg dyfytërsisë, e cila ua zhvlerëson veprat e mira.

Qëllimi i agjërimin është vendosja e ushqimit në vendin e tij të vërtetë, në rolin e nevojës sa për të jetuar, duke mundur nefsën dhe frenuar dëshirat. Kur ushqimi është në këtë status edhe mundësia për të bërë haram është më e paktë. Pasi, duke ngrënë haramin, veshi dëgjon gjëra të padobishme dhe gjuha afrohet më pranë gjynahut. Andaj dhe Allahu i Madhëruar thotë: **“Ata janë dëgjues të gënjeshtres dhe e hanë me kënaqësi të madhe atë që është e ndaluar.”** (Maide, 42.)

Nëse agjëruesi, pasi çel yftarin, ka shenja pavullneti për ibadete, ai menjëherë duhet kuruar.



Kura është shuarja e ushqimit përmes faljes së namazit, leximit të Kuranit, dhikrit, istigfarit dhe duave që ai do bëjë. Andaj dhe Profeti (a.s.), thotë: “*Shuani ushqimin përmes dhikrit.*” (Keshfu’l khafa I, 74, nga Evsati i Taberanit)

LLOJET E AGJËRIMIT

Agjërimi kryesor dhe i obliguar është agjërimi i muajit të Ramazanit. Për t’u dhënë mundësinë besimtarëve që të arrijnë në shkallën e devocionit, ka edhe agjëtime të tjera përveç agjërit të Ramazanit:

1. Savmu’d-dehr: agjërimi gjatë tërë vitit, pa shkëputje. Ky lloj agjërimi nuk është rekomanduar, madje konsiderohet mekruh.

2. Savmu’d-Davud: ky lloj agjërimi, ashtu sikur vepronte Hz. Davudi, është një ditë të agjërosh e një ditë të mos agjërosh. Dita e agjërit është një urë për tek *sabri* (durimi), ndërsa dita jo agjërueshëm është urë lidhëse me *shukrin* (mirënjohjen).

3. Savmu ejjamu’l-bijdh: është agjërimi i ditëve 13, 14 dhe 15 të muajve hënorë. Thuhet se, kur zbriti në tokë Hz. Ademi, trupi i tij ishte bërë i zi nga gjynahu. Kur iu pranua pendimi i tij, Allahu i urdhëroi agjërimin *ejjamu’l-bijdh* (ditëve të bardha). Çdo ditë i zbardhej 1/3 e trupit të tij dhe në ditën e tretë, zbardhej i tëri. Për respekt të tij dhe për arsye të ndikimit që shkakton lëvizja e hënës mbi trupin e njeriut, është këshilluar të agjërohen këto ditë.

4. Agjërimi i të hënave dhe të enjteve: është një agjërim që është këshilluar për të kontrolluar nefsin dhe për të mos u bërë agjërimi rutinë.

5. Agjërimi i muajit Shaban: pas muajit të Ramazanit, muaji që Muhamedi (a.s.), agjëronte më së tepërmi, është ai i Shabanit. Gjysma e parë ose e dyta e muajit Shaban mund të agjërohet. Mund të agjërohet edhe më pak ose edhe më shumë se kaq.

6. Agjërimi i muajit Sheval: agjërimi i dhjetë ditëve të muajit Sheval, si përcjellës të muajit të Ramazanit.

7. Agjërimi i muajve Dhulhixhxe dhe Muharrem: është mustehab agjërimi i dhjetë ditëve të para të këtyre dy muajve. Veçanërisht agjërimi i ditës së dhjetë (Dita e Ashures) ose 9–10, apo 10–11 të muajit Muharrem.

Gjatë rrugëtimit tek Allahu, agjërimi luan një rol me rëndësi të veçantë për përgatitjen e devocionit. Besimtarët e mençur, kërkojnë mëshirë nga Allahu, duke pasuruar zemrat e tyre me agjërim edhe jashtë atmosferës së Ramazanit.

Origjinaliteti i Kuranit

Ma. Gilman Kazazi

A është po ai, i njëjti, që i zbriti Profetit Muhammed (a.s.), Kurani që lexojmë sot?
Absolutisht po. Regjistrimi i Kuranit, shkrimi dhe memorizimi i tij, është realizuar që në kohën e Profetit Muhamed (a.s.) e ka vazhduar të shkruhet dhe mësohet përmendsh deri në ditët tona. "Ndoshta nuk ekziston ndonjë libër tjetër në botë që ka mbetur i pandryshuar për 12 (tani 14) shekuj".¹

Myslimanët i mjafton premtimi i Allahut se ka për ta ruajtur këtë Libër. Siç e kemi obligim të besojmë se Kurani e ka zbritur Allahu, ashtu e kemi obligim të besojmë se Allahu ka për ta ruajtur atë.²

Në suren El-Hixhr, ajeti 9, thuhet: "**Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kurandin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.**"

Në suren Fussilet, ajeti 41-42, thuhet: "**...ai (Kurani) është një libër ngadhënjyes (i pashoq) * Atij nuk mund t'i vishet e pavërteta nga asnjë anë. Është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit.**"

Profeti Muhamed përcjell në një hadith fjalët e Allahut:

"...O Muhamed! Të kam dërguar ty që të të sprovtoj, e t'i sprovtoj (të tjerët) me ty. Të kam zbritur një libër që nuk e fshin uji (do të mbetet i ruajtur),..." (Muslim)

Në vazhdimësinë e kësaj teme do të përmendim faktorët kryesorë në ruajtjen e origjinalitetit të Kuranit ³:

1. FORCA E AFTËSISË PËR MEMORIZIMIN E POEZIVE TEK POPULLI ARAB

1. Shih: Sir Williams Muir, Life of Mohamet, vol.1, hyrje.

2. Shih: Prof.dr. Nurud-din Itr, Ulumul-Kuranil-Kerim, Damask, 1996, fq. 180.

3. Shih: Prof. dr. Muhamed Ebu Shuhbeh, el-Med'hal lidirasetil-Kuran, Kajro, 1992, fq. 354-378.

Arabët kanë qenë popull që nuk janë bazuar në shkrimin e poezive dhe gjenealogjisë (prejardhjes), por në memorizimin e tyre. Shkrimi dhe leximi nuk kanë qenë të përhapur shumë tek arabët. Kjo aftësi e tyre ua ka mundësuar dhe lehtësuar mësimin përmendsh të Kuranit. Kurani është nxënë përmendsh nga shokët e Profetit, që në kohën kur ai ishte gjallë. Një traditë e tillë vazhdoi të ruhej pas vdekjes së Profetit nga të gjithë brezat e myslimanëve e deri në ditët tona.

"Metoda e transmetimit të Kuranit nga një brez në tjetrin, duke ua mësuar përmendsh të rinjve gojarisht, kishte bërë që, qysh nga fillimi, të ulej rreziku i mbështetjes vetëm te kopjet e shkruara", thotë Xhon Burton.⁴

Nga veçoritë dalluese të Kuranit mund të përmendim se ai është i vetmi libër hyjnor që mund të mësohet përmendsh, i vetmi libër që Allahu e ka obliguar të mësohet përmendsh nga ithtarët e tij. Vetë Profeti Muhamed e ka ditur Kurandin përmendsh dhe ua ka mësuar atë shokëve të tij. Profeti Muhamed e përsëriste Kurandin nga një herë në çdo vit me engjëllin Xhebrail. Në vitin e fundit të jetës së tij e përsëriti dy herë. Nga sahabët e njohur që e kanë mësuar Kurandin përmendsh, mund të përmendim nga **muhaxhirët**: Ebu Bekrin, Umerin, Uthmanin, Aliun, Abdullah ibn Mes'ud, Ibn Abas, Ibn Umer, Ibn Zubejr. Nga **ensarët**: Ubadeh ibn Samit, Muadh ibn Xhebel, Ubej ibn Ka'b, Zejd ibn Thabit, Ebu Derda. Nga **gratë**: Aisheja, Hafsa, Umu Selemeh, Umu Verekah.

2. ZBRITJA E KURANIT PJESË-PJESË

Ka ndihmuar në memorizimin e tij nga myslimanët e parë. Zbritja e Kuranit në një periudhë 23 vjeçare ua ka lehtësuar atyre mësimin përmendsh.

4. Shih: John Burton, An Introduction to the Hadith, Edinburgh University Press: 1994, f. 27.

3. OBLIGUESHMËRIA E TË LEXUARIT DHE KËNDIMIT TË KURANIT NË NAMAZ

Përsëritja e Kuranit në çdo namaz, çdo ditë, ka qenë një tjetër faktor që ka ndihmuar në ruajtjen e tij. Në çdo namaz që fal myslimani, gjatë natës apo ditës, sunet apo farz, me xhemat apo vetëm, është obligim të lexohet nga suret apo ajetet e Kuranit. *Profeti Muhamed lexonte Kuran aq shumë gjatë namazit të natës, sa që iu enjtëshin këmbët.* (Buhariu)

Kur e kanë pyetur Profetin Muhamed (a.s.), se cili është namazi më i mirë, ka thënë: *"Ai namaz ku lexohet më shumë Kuran".* (Muslim)

4. OBLIGUESHMËRIA E TË PUNUARIT ME KURAN

Një gjë, e cila mësohet dhe me të cilën punohet, ngulitet në mendje më shumë sesa vetëm kur lexohet dhe nuk punohet me të. Kuranin e ka zbritur Allahu të praktikohet dhe zbatohet në jetë. Ai është kushtetuta e myslimanëve, themeli i besimit dhe baza legjislative e islamit.

5. NXITJA E SAHABËVE DHE E MYSLIMANËVE PËR LEXIMIN E KURANIT

Profeti Muhamed (a.s.), i nxiste myslimanët e parë në leximin sa më të shpeshtë të Kuranit, duke u treguar atyre shpërblimin e madh që ka leximi i tij dhe mirësinë e atij që ua mëson Kuranin të tjerëve.

"Lexoje Kuranin çdo muaj, ... lexoje atë çdo njëzet net, ... lexoje atë çdo shtatë net, ..." (Muslim)

"Lexojeni Kuranin, sepse ai do t'ju ndërmjetësojë tek Allahu ditën e gjykimit". (Ahmed)

"Kush lexon një gjermë nga Kurani, ka dhjetë sevape, ..." (Tirmidhi)

"Kur një grup myslimanësh mblidhen në një xhami, për ta lexuar Kuranin dhe për t'i mësuar njëri-tjetrit leximin dhe dispozitat e tij, mbi ta zbret qetësia, i mbulon mëshira, i rrethojnë melaiket e mëshirës dhe i përmend (i lavdëron Allahu tek krijesat që gjenden tek Ai)". (Ebu Davud)

"Më i miri nga ju, është ai që e mëson Kuranin për vete dhe pastaj ua mëson atë të tjerëve". (Buhariu)

6. DËRGIMI I MËSUESVE TË KURANIT NGA ANA E PROFETIT MUHAMED TE Fiset ARABE, QË PRANONIN ISLAMIN

Profeti dërgonte mësues për bashkësitë e vendeve të ndryshme, që t'i njihje ata me islamit dhe Kuranin. Imam Buhariu, nga Enes Ibn Malik, transmeton se: *"Tek Profeti Muhamed (a.s.), erdhën anëtarë të fiseve Ri'l, Dhekan, Usaj-jeh dhe Benu Lehjan. Ata pretenduan se e kishin pranuar islamit dhe kërkuan nga Profeti t'u dërgonte disa njerëz (që t'u mësonin fiseve të lartpërmendura fenë). Profeti Muhamed dërgoi me ta 70 ensarë nga lexuesit e Kuranit. U nisën të ktheheshin dhe, kur mbërritën tek vendi i*

quajtur Bi'r Meuneh, fiset e lartpërmendura i prenë në besë dhe i vranë që të gjithë lexuesit e Kuranit. Profeti Muhamed u lut përgjatë një muaji në namazin e sabahut kundër atyre fiseve..."

7. URDHËRI I PROFETIT MUHAMED QË TË PËRSËRITET KURANI E TË MOS LIHET NË HARRESË

Myslimanët janë të bindur se harrimi i asaj çfarë është mësuar përmendsh nga Kurani është gjynah. Tregon neglizhencë dhe mospërkushtim ndaj Fjalës së Allahut.

Profeti Muhamed thotë:

"Përsëriteni (angazhohuni me të) vazhdimisht Kuranin, ..." (Muslimi)

Ebul-Alijeh thotë: *"E kemi konsideruar nga gjynahet e mëdha, të mësohet Kurani e pastaj të flihet derisa të harrohet."*⁵ Gjithashtu transmetohet me një varg të saktë transmetuesish nga Ibn Sirin se, *"Gjeneratat e para e kanë urryer atë që harron Kuranin e për të thoshnin fjalë të rënda."*⁶

8. URDHRI I PROFETIT MUHAMED PËR SHKRIMIN E KURANIT

Kurani është shkruar plotësisht në kohën e Profetit Muhamed. Megjithatë, materiali i shkruar i Kuranit në kohën e Profetit nuk ishte i lidhur ndërmjet dy kapakëve në formën e një libri, sepse periudha e shpalljes hyjnore vazhdoi deri disa ditë para vdekjes së Profetit.

Kurani u rishkrua dhe u tubua në një njësi, në kohën e halifes së parë të myslimanëve, Ebu Bekrit (r.a.). Ebu Bekri ka vdekur dy vjet pas profetit Muhamed. Po ashtu, është rishkruar dhe shumëfishuar pas 15 vitesh nga vdekja e Profetit Muhamed, në 6 kopje në kohën e Uthmanit (r.a.), halifa i tretë i myslimanëve. Nëse mësimi përmendsh i Kuranit nuk do të ecte paralelisht me pjesën e shkruar, e cila do të shërbente si ekuilibër dhe mënyrë kontrollimi për të, atëherë mund të ekzistonte mundësia që pjesa e shkruar ta humbiste saktësinë e saj.

Numri i shkruarve të Kuranit në kohën e Pejgamberit ka qenë më shumë se 40 persona. Prej tyre, Ebu Bekri, Omeri, Othmani, Aliu, Ubej ibn Ka'b, Zejd ibn Thabit, ez-Zubejr ibn el-Avam e të tjerë. Sa herë që vinte Shpallja, Profeti ua diktonte dhe i drejtonte se ku duhej t'i vendosnin ajetet e zbritura, duke përcaktuar renditjen dhe kompozimin e lëndës kuranore. Nga faktet se Kurani ekzistonte si një dokument i shkruar, që kur Profeti ishte gjallë, janë porositë drejtuar shokëve të tij: *"Askush nuk duhet ta prekë Kuranin pa qenë i pastër."* (Ibn Hiban), *"Mos e merrni Kuranin me vete në udhëtim, sepse mund të bjerë në duart e armikut."* (Muslim).

5. El-Metalib el-Alijeh, Ibn Haxher, 10\170. Thotë Ibn Haxher në Fet'hul-Bari 9\86 se: "vargu i transmetuesve është i mirë."

6. Fet'hul-Bari, Ibn Haxher, 9\86.

Profeti (a.s.), jo vetëm ka urdhëruar që të shkruhej Kurani, por në fillim të islamit ka ndaluar të shkruhej tjetër gjë përveç tij. Kjo ndalesë u bë nga frika që të mos përzihej Kurani me hadithet (thëniet e Profetit).

"Mos shkruani nga unë asgjë përveç Kuranit, kush shkruan nga unë diçka pos Kuranit, le ta fshijë atë". (Muslim)

Në kohën e Ebu Bekrit, si rezultat i vdekjes së shumë hafizëve në luftën e Jemames (12.h.-633 e.s.), luftë e zhvilluar mes myslimanëve dhe renegatëve, pasuesve të Musjelemetu el-Kedhab, bien dëshmorë 70 hafizë. Umeri vjen tek Ebu Bekri dhe i ankohet. I shpreh frikën e tij ndaj hafizëve, duke kërkuar prej tij të japë urdhër për tubimin dhe rishkrimin e Kuranit. Kjo detyrë i caktohet Zejd ibn Thabit, një ndër shkruarit e Kuranit në kohën e Profetit. Ebu Bekri i tha: *"Ti burrë, djalë i mençur, nuk të akuzojmë për gjë (jeni besnik), ke shkruar shpalljen në kohën e Profetit, prandaj tuboje Kuranin (në një vëllim)." (Buhariu)*

Kjo kopje e plotë e Kuranit është ruajtur tek halifja i parë i myslimanëve Ebu Bekri, pastaj tek halifja i dytë Umeri. Pas vdekjes së Umerit, me porosi të tij, është lënë te vajza e Umerit, Hafsa. Kjo zonjë ka qenë gruaja e Profetit dhe hafize e Kuranit. Ky tubim i Kuranit në kohën e Ebu Bekrit, është quajtur *Mus'haf*.

Në kohën e Uthmanit, ka ndodhur një ngjarje tjetër, e cila ka qenë shkak për shumëfishimin e kopjeve të Kuranit dhe dërgimin e tyre në qendrat islame të asaj kohe: mospajtimi i disa myslimanëve në leximin e Kuranit gjatë luftës së çlirimit të Armenisë dhe Azerbajxhanit (653e.s.).

Si rezultat i këtij mospajtimi, Hudhejfeh ibn el-Jeman ka ardhur tek Uthmani, duke kërkuar: *"O Prijës i besimtarëve! Kape këtë çështje në dorë, përpara se myslimanët të ngatërrohen në Librin e tyre, siç janë ngatërruar të krishterët dhe jehudijtë". (Buhariu)*

Atëherë Uthmani ka kërkuar nga Hafsa t'ia dërgojë kopjen e Kuranit që ta shumëfishonte atë. Me këtë detyrë ka caktuar një komision prej katër vetësh: Zejd ibn el-Harith, Abdullah ibn ez-Zubejr, Seid ibn al-As, Abdurrahman ibn el-Harith. Mbas këtij shumëfishimi, ka dërguar në çdo qendër islame të asaj kohe nga një kopje të shoqëruar me një lexues të Kuranit. E gjithë kjo, në mënyrë që të përcillej leximi dhe shkrimi i saktë i Kuranit dhe t'i mbylleshin dyert çdo debati, mospajtimi dhe dyshimi në leximin e tij. Qendrat në të cilat është dërguar nga një kopje e Kuranit janë Medine, Meke, Damask, Kufe, Basra, Jemen.⁷

Një masë tjetër të re, të cilën e ka ndërmarrë Uthmani për prerjen e rrugëve që çojnë në mospajtimin e myslimanëve rreth Kuranit, është urdhri i tij për dëgjien e

7. Shih: Prof. dr. Muhamed Ebu Shuhbeh, el-Med'hal lidirasetil-Kuran, Kajro, 1992, fq. 252-255. Dr. Salah el-Halidij, el-Kuran ve nakdu metainrurubhan, Damask, 2007, fq. 338.



çdo mus'hafi personal që ka ekzistuar në atë kohë tek sahabët⁸. Ky vendim i tij është bërë në prezencën dhe pajtimin e sahabijve të mëdhenj në atë kohë.

Aliu (r.a.), ka thënë: *"Sikur të isha në pozitën e Uthmanit, do të vepra me mus'hafat personalë siç veproni ai"*.⁹ Gjithashtu ka thënë: *"Mos thoni për Uthmanin vetëm se mirë, se pasha Allahun, nuk ka ndërmarrë ndonjë hap në lidhje me mus'hafat, vetëm se në prezencën tonë"*.¹⁰

Në këtë mënyrë është përcjellë dhe ruajtur Kurani, i shkruar dhe i mësuar përmendsh, brez pas brezi deri në ditët tona. Sot ekzistojnë me miliona hafizë, me mijëra shkolla hafizësh, me miliona botime, të gjitha identike me atë që na kumtoi Profeti Muhamed (a.s.). Është tepër e dukshme që historia e tekstit kuranor nuk mund të krahasohet me atë të shkrimeve të tjera të shenjta. Ato u redaktuan dhe u përpiluan gjatë një periudhe tepër të gjatë kohore, ndonjëherë edhe me shekuj.¹¹ Asnjë nga religjionet e njohura sot nuk i zotëron shkrimet e shenjta të plota, të shkruara apo të memorizuara, që nga dita e shpalljes deri në kohën tonë.

Vetëm teksti i Kuranit, me të përfunduar Shpallja, ka mbetur i njëjti deri në ditët tona. *Një besim fetar është po aq autentik, sa autenticiteti i shkrimit të shenjtit që ndjek.*

8. Nga kjo vepër e Uthmanit, dijetarët kanë kuptuar se lejohet diegia e mus'hafave ose librave fetarë që janë dëmtuar dhe nuk mund të përdoren më. Kjo gjë bëhet për t'i ruajtur fletët e mus'hafave dhe të librave fetarë nga përdhosjet, fëlliqësitat apo shkeljet me këmbë.

9. Shih: Prof. dr. Muhamed Ebu Shuhbeh, el-Med'hal lidirasetil-Kuran, Kajro 1992 fq. 250. Sikur të kenë pasur mus'hafat e Uthmanit mangësi apo ndryshime nga ajo që la Profeti Muhamed, Aliu i cili qëndroi si halife pas Uthmanit në një periudhë 6 vjeçare përfatësisht, do t'i korrigjonte dhe do t'u tërhiqte vërejtjen myslimanëve, Vetë Aliu lexonte Kuranin që ishte në përputhshmëri me mus'hafin e Uthmanit, dhe lexonte si imam në nemaz po atë Kuran. Shih: Prof. dr. Nurud-din Itr, Ulumul-Kuranil-Kerim, Damask, 1996, fq. 184.


10. Po aty, fq. 250.

11. P.sh. Ungjijtë janë shkruar mes viteve 60 – 98, pas ngritjes së Isait (a.s.). Originali i katër ungjijve është zhdukur, nuk ekziston asnjë kopje që është dorëshkrim i autorit. Prej të katërve, autor i vetëm i një ungjilli është apostulli Mateu, ndërsa autorët e tre ungjijve të tjerë janë vepra të nxënësve të Isait (a.s.) ose individëve të panjohur. Shih: Dr. Muhamed Ali el-Havli, Komperacioni mes katër ungjijve, Shkup, 2002, fq. 5-6.



يَا أَيُّهَا أَهْلَ جُوقِيشَا

استعداداً لعيد الأضواء
في ليلة الأضواء
التي هي ليلة الأضواء



FESTA ENATËS SË KANILAVE
NË SHKODËR 1900-1912

FOTOJA E MUJAJIT

Financa Islame,

një alternativë etike ndaj tradicionales

Idlir Bekteshi

Aziz Tayebi është specialist i lartë i raportimeve financiare në ACCA¹ dhe jep kontribut të rëndësishëm në reagimet e këtij institucioni ndaj zhvillimeve globale në këtë fushë.

Financa Islame është një nga segmentet me rritjen më të shpejtë në industrinë e sotme bankare. E konsideruar më përpara si një pjesë rudiment e asaj tradicionale-perëndimore (më poshtë do të quhet thjesht tradicionale), aktualisht tregu që ajo zë është mjaft vital dhe konkruues. Megjithëse xhiroja e aktiviteteve financiare dhe bankare islame varion nga 500 – 1,000 miliardë dollarë, që përbën një pjesë të vogël të asaj të bankingut tradicional, rritja e saj impresionuese prej 10 – 15% në vit demonstroi potencialin serioz të tregut të këtyre aktiviteteve.

Është fakt që kjo rritje po vihet re gjithnjë e më tepër jashtë tregjeve tradicionale të kësaj fushe, siç janë ato të Këshillit të Gjirit dhe Malajzisë. Kjo do të thotë që aktorët e tregut dhe autoritetet vendimmarrëse po i kushtojnë vëmendje gjithnjë e më të madhe potencialit që ofron ky treg. Bursat e Nju Jorkut dhe Londrës kanë publikuar tregues të veçantë për investimet në institucionet financiare islame, krahas atyre ekzistuese, si Dow Jones dhe FTSE (të dy këto indekse tregojnë ecurinë e çmimit të aksioneve që tregtohen në bursë). Qeveria Britanike ka luajtur rol kyç në përpjekjet për ta bërë Londrën qendrën globale të financës islame. Kjo, nëpërmjet heqjes së taksës së vulës së dyfishtë mbi kreditë hipotekore të institucioneve isla-

me dhe planit të publikuar kohët e fundit mbi testimin e fizibilitetit të emetimit të letrave me vlerë mbi bazën e Sheriatit. Buxheti i vitit 2007, përfshin masa të reja në lidhje me bondet *sukuk* në mënyrë që të mundësohet emetimi dhe tregtimi i tyre në tregun financiar britanik.

Në fakt, rritja e shpejtë e instrumenteve *sukuk* (të njohura gjerësisht si letrat me vlerë islame) ka revolucionarizuar tregun e letrave me vlerë që operojnë sipas rregullave të Sheriatit. Këto instrumente, jo vetëm që i kanë dhënë spunto industrisë financiare në shkallë globale, por gjithashtu i kanë dhënë mundësi të reja zhvillimit të tregjeve sekondare të letrave me vlerë. Pasi në 2004, Landi Gjerman i Saxony – Anhalt, u bë emetuesi i parë jomysliman që hyri në tregun islam të letrave me vlerë, kompanitë amerikane dhe japoneze filluan të emetojnë bondet *sukuk*. Në Britaninë e Madhe, blerja e Aston Martin nga ana e kompanisë Ford, u realizua me anën e instrumenteve *sukuk*.

ÇFARË ËSHTË FINANCA ISLAME

Në Financën Islame bën pjesë çdo lloj aktiviteti financiar që përputhet me ligjin islam (Sheriatin). Për sa i përket financës, Sheriati shpjegon në detaje konceptet etike mbi parandë dhe kapitalin, marrëdhënien risk – fitim dhe përgjegjësitë sociale të institucioneve financiare.

Interesi (riba)

Aspekti më i njohur i sistemit financiar islam, është ndalimi i pagesës së interesit mbi kapitalin si dhe marrjes së tij. Në thelb, çdo përqindje interesi e paracaktuar dhe fikse, në varësi të shumës dhe kohëzgjatjes së kredisë, e pavarur nga rezultati i investimit, konsiderohet riba dhe është e IAC-CA (Inicialet në anglisht për Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar) është qendra globale e kontabilistëve profesionistë, e cila ka mbi 100 vjet që ofron kualifikime të nivelit mbarëbotëror mbi



kontabilitetin dhe financën. Zyrat Qendrore të saj janë në Glasgow të Britanisë së Madhe ndaluar. Ky ndalim nuk duhet ngatërruar me përqindjen e kthimit ose të fitimit mbi kapitalin, meqenëse realizimi i të ardhurave dhe ndarja e fitimit inkurajohen fuqishëm në Islam. Për më tepër, fitimi që përcaktohet pas përfundimit të operacioneve të biznesit, simbolizon krijimin e pasurisë shtesë nëpërmjet sipërmarrjes së suksesshme, ndërsa interesi i përcaktuar paraprakisht, është kosto e akumuluar, pa varësisht rezultatit të aktivitetit të biznesit dhe krijon pasuri edhe në rast se biznesi del me humbje.

RISKU DHE PASIGURIA (GHARAR)

Risku (rrezikshmëria) i paracaktuar me kontratë është gjithashtu i ndaluar. Në përgjithësi ndalohen shitja e mallrave, të cilat shitësi nuk ka mundësi t'i ofrojë vetë tek blerësi dhe hartimi i kontratave që kushtëzohen nga ngjarje të pasigurta. Me pak fjalë, nuk mund të shesësh për llogarinë tënde diçka që nuk e ke në pronësi (ekzistojnë opsione në praktikën financiare perëndimore që përfshijnë shitjen e mjeteve që janë marrë borxh). Po ashtu, çmimet dhe karakteristikat e mallrave përcaktohen në detaje dhe me miratimin e të gjitha palëve të përfshira, duke evituar kështu shitje të ngjashme me bastet. Megjithatë ndalimi i interesit mund të shihet si bërthama e doktrinës islame lidhur me financën, ka një sërë parimesh, të cilat mbështesin sistemin financiar islam:

- Favorizon ndarjen e riskut.
- Promovon sipërmarrjen.
- Bie në kundërshtim me sjelljet spekulative.
- Ruan të drejtën e pronësisë.

Këto parime janë evidente, nëse krahasojmë sistemin financiar islam, me atë tradicional.

KU KONSISTON DIFERENCA MES FINANCËS ISLAME DHE ASAJ TRADICIONALE?

Evoluimi i bankngut dhe financës islame buron nga dy objektiva kryesore: eliminimi i financimit me normë interesi (riba) dhe zhvillimi i produkteve me risk të ulët që u japin besim autoriteteve vendimmarrëse, aksionerëve dhe depozituesve. Ky i fundit është edhe më i domosdoshëm pas dështimit të disa modeleve të bankngut islam në Egjipt, Pakistan dhe Malajzi gjatë viteve '50.

Një nga karakteristikat me të dallueshme të tregut financiar islam gjatë kohëve të fundit, është zhvillimi i një game produktesh shumë të ngjashme me ato të bankngut tradicional. Përdorimi i këtyre produkteve u preferua nga shumë palë të interesuara, përfshi edhe vetë industrinë financiare.

Megjithatë, ka disa aspekte thelbësore të financës islame që e diferencojnë atë nga modeli tradicional. Përshkrimi i sistemit financiar islam thjesht si "ndalues i interesit", nuk është i saktë. Esenca e këtij sistemi e vë theksin tek promovimi i sipërmarrjes, ruajtja e të drejtës

së pronësisë dhe transparenca e detyrimeve kontraktuale. Këto dhe konkluzione të tjera të rëndësishme, dalin nga një shqyrtim i hollësishëm i Sheriatit. Konsiderimi i kapitalit vetëm si mjet këmbimi (pa vlerë të brendshme), është shkaku kryesor për ndalimin e interesit dhe formon shtyllën kryesore të bankngut dhe financës islame. Megjithatë, parime të tjera të rëndësishme përfshijnë:

- Ndalimi i riskut kontraktual.
- Favorizimi i ndarjes së riskut dhe kthimit.
- Kolaterali nuk duhet të jetë garancia e vetme në kredidhënie.

CILAT JANË INSTRUMENTET MË TË PËRDORURA TË FINANCËS ISLAME?

Duke marrë parasysh kufizimet e përmendura më sipër, akademikët e sotëm, kanë zhvilluar modele financimi, të cilat mund të aplikohen në situatën e sotme financiare, duke qenë njëkohësisht në përputhje me parimet islame. Disa nga instrumentet financiare më të përdorura në financat islame janë si më poshtë:

Murabaha: Përdoret në tregëti dhe për financimin e mjeteve të ndryshme. Në ndryshim nga kredidhënia tradicionale, banka e blen mallin (duke marrë kështu përsipër riskun) dhe ia shet debitorit me një çmim të rënë dakord që më parë.

Ijara: Është një instrument i përafërt me borxhin. Përdoret shpesh në rastet e blerjes së shtëpive. Karakteristika kryesore e Ijaras konsiston në atë që banka blen mallin dhe ia jep me qera debitorit kundrejt një pagese për një afat të caktuar. Me përfundimin e këtij afati, nëse janë shlyer të gjitha pagesat, malli kalon në pronësinë e debitorit. Përdoret më tepër për financimin e blerjes së pasurive të patundshme.

Musharakah: Është e ngjashme me një marrëveshje ortakërie. Pronësia ndahet në përpjesëtim me kapitalin e investuar nga secili ortak, po ashtu edhe fitimi. Këto kontrata përdoren shpesh në financimin e projekteve të përmasave të mëdha.

Mudarabah: Është një marrëveshje, ku njëra palë ofron kapitalin e tjetra manaxhimin. Ndarja e fitimit bëhet mbi bazën e marrëveshjes paraprake, kurse humbja përballohet vetëm nga ofruesi i kapitalit.

Sukuk: Është një letër me vlerë që përfaqëson pjesëmarrje në një investim të caktuar që gjeneron të ardhura. Aktualisht, investimi më i përhapur në këtë kategori është ai në pasuritë e patundshme. Ky instrument është përdorur më shumë për investime në infrastrukturë dhe zë vendin kryesor në transaksionet e financës islame.

Në mbyllje, vlen të citojmë një frazë të një raporti të Kongresit Amerikan mbi Financën Islame, të publikuar në Korrik të 2008-ës: "Integrimi i etikës dhe vlerave në financë shihet si një zhvillim pozitiv. Shumë investitorë e konsiderojnë SCF (inicialet në anglisht për Financën në përputhje me Sheriatin) si më të besueshme në kushtet e krizës së sotme globale dhe frikës nga rënia ekonomike".



Republika e Kosovës

Aspekte mjedisore dhe social-ekonomike
Organizimi politik-administrativ

Prof. dr. Selman Sheme

Kosova është shteti më i ri në Evropë. Deri në vitin 1912 krahina e Kosovës, Republika e Shqipërisë dhe gjithë gjeohapësira shqiptare në Ballkanin Perëndimor kanë qenë nën sundimin turk.

Trevat shqiptare kishin një sipërfaqe prej 75.000 km² dhe një popullsi prej 2.354.200 banorë.

Pas Shpalljes së Pavarësisë, më 1912, trojet shqiptare u copëtuan nga vendimet e padrejta të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 1913. Kosova dhe vise të tjera shqiptare iu aneksuan Serbisë, nën sundimin e së cilës ajo qëndroi deri në vitin 1999. Më 13 qershor 1999, rajoni shqiptar i Kosovës u çlirua nga UÇK-ja dhe veprimet ushtarake të NATO-s. Pas çlirimit nga Serbia, deri më 16 shkurt 2008, Kosova kishte statusin e territorit të administruar nga Kombet e Bashkuara, por ndërkohë kishte edhe organet e veta të shtetit, si Kuvendin, Qeverinë, organet e pushtetit vendor etj. Gjatë kësaj periudhe, shumë sektorë të jetës iu kthyen normalitetit dhe Kosova u përgatit për statusin final. Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi "Deklaratën e Pavarësisë", e cila zyrtarizoi formimin e shtetit më të ri të Evropës, "Republikën e Kosovës". Shpallja e Republikës së Kosovës u shoqërua me njohjen zyrtare të saj nga SHBA, Bashkimi Evropian dhe shumë shtete të tjera në botë. Kjo ngjarje realizoi aspiratën shekullore të popullit shqiptar të Kosovës për të jetuar i lirë dhe i pavarur në një shtet demokratik.

Kosova ndodhet në juglindje të Evropës, në pjesën qendrore të Gadishullit të Ballkanit. Territori i saj është udhëkryq ndërmjet Adriatikut, Fushës së Panoni-

së (Danubit të Mesëm) dhe Egjeut. Ajo kufizohet nga perëndimi me Republikën e Malit të Zi, nga veriu dhe lindja me Republikën e Serbisë, nga jugu dhe juglindja me Republikën e Maqedonisë dhe jugperëndimi me Republikën e Shqipërisë. Brenda këtyre kufijve ajo ka një sipërfaqe prej 10 908 km², afërsisht sa sipërfaqja e Malit të Zi.

Pozita gjeografike e Kosovës është e rëndësishme për lidhjet ekonomike, kulturore dhe politike me vendet e tjera të rajonit e më gjerë.

Në aspektin fiziko-gjeografik, Kosova ndahet në dy njësi:

1. Fusha e Kosovës
2. Rrafshi i Dukagjinit

Fusha e Kosovës shtrihet në pjesën lindore me lartësi mbidetare prej 510-530 m. Ajo ka një gjatësi rreth 90 km dhe gjerësi prej 15 km. Me Rrafshin e Dukagjinit e ndajnë malet e Drenicës, të Caralevës dhe të Prekorupës.

Rrafshi i Dukagjinit shtrihet në perëndim të Fushës së Kosovës dhe ka një lartësi mbi detin prej 320 – 350 m ose afro 180 m më i ulët se Fusha e Kosovës. Relievi kodrinor malor zë 63.5% të sipërfaqes së përgjithshme. Malet rrethojnë territoret fushore, të cilat zënë 36.5% të sipërfaqes. Në veri shtrihen malet e Kopaunikut, në veriperëndim Bjeshkët e Namuna (Alpet e Shqipërisë), në perëndim Pashtriku e Koritniku, në jug vargmali i Sharrit dhe në lindje Anamorava.

Maja më e lartë malore është Gjerjovica (2656 m) në Bjeshkët e Namuna, ndërsa pika më e ulët gjendet në shtratin e Drinit të Bardhë (265 m) në Rrafshin e Dukagjinit. Territori i Kosovës ka një lartësi mesatare prej 810 m. Malet që e qarkojnë Kosovën karakterizohen nga një morfologji tepër e thyer. Kuriozitetet e veçanta përbëjnë relievet glaciale, fluviale, denuduete, karstike etj. Monumentet natyrore të Kosovës, si Gryka e Rugovës, e Sushicës, Deçanit, Gjerjovicës etj., përbëjnë forma morfologjike jashtëzakonisht të bukura dhe interesante. Krahas Bjeshkëve të Namuna, peizazhe tejet të bukura dhe me terrene plastike vërehen në Malin e Sharrit. Pyjet prej ahu dhe halorësh, kullotat alpine dhe terrenet prej Shtëpisë së Stojkut dhe deri në Piribreg, ku gjendet Brezovica, përbëjnë resurse turistike me vlera të mëdha ku ushtrohet turizmi i bardhë, i gjelbër, turizmi për aventurë etj. Në malet që qarkojnë Kosovën gjenden edhe një numër i konsiderueshëm i bimëve endemike me vlera medicinale.

Në Kosovë mbizotëron klima e mesme kontinentale. Ajo karakterizohet me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë. Sasia mesatare e reshjeve varion nga 600 deri në 1000 mm (në viset malore). Kosova është e pasur me një rrjet të dendur hidrografik. Lumenjtë më të mëdhenj janë: Drini i Bardhë (i cili në Kukës bashkohet me Drinin e Zi dhe derdhet në Adriatik), Ibri dhe dega e tij Sitmica, që derdhen në Danub, Lepenca, degë e lumit Vardar që derdhet në Egje etj.

Kosova është e pasur me ujëra nëntokësore që shfrytëzohen për konsum komunal dhe ujëra termale për kurim, siç janë ato të Llixhave afër Pejës, Banjska afër Mitrovicës, Klllokoti afër Vitisë etj., ku mjekohen sëmundje të ndryshme, si reumatizma, sëmundjet e lëkurës, të stomakut etj. Në tërësi Kosova përmban resurse të mëdha natyrore të riciklueshme dhe të pariciklueshme, si xeherorë plumbi, zingu, kromi, kaustobiolite (qymyr linjit), minerale jometalorë, resurse hidroenergjitike etj., të cilat mundësojnë zhvillimin e industrisë dhe ekonomisë në tërësi.

POPULLSIA DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

Territori ku sot shtrihet Republika e Kosovës, në antikitet ka qenë i banuar nga fisi ilir i Dardanëve. Dardanët në mesjetë njihen me emrin shqiptarë. Sipas të dhënave të vitit 1916, në Kosovë jetonin 460.607 banorë. Gjatë 100 vjetëve të fundit, për shkombëtarizimin e krahinës, qeveria serbe ndoqi politikën e shpërnguljes me dhunë të popullsisë shqiptare nga trojet e veta.

Për pasojë, shumë shqiptarë të Kosovës u detyruan të emigronin në Turqi, në shtetin amë (Shqipëri) dhe në vende të tjera të Evropës e deri në Amerikë. Këto shpërngulje kanë ndikuar në ngadalësimin e ritmeve të shtimit të popullsisë. Megjithatë, si rezultat i shtimit të lartë natyror (lindjeve të larta), popullsia e Kosovës sot është rritur 5 herë në krahasim me vitin 1916. Popullsia e Kosovës në vitin 2006 ishte 2 130 000 banorë.

Republika e Kosovës është deklaruar shtet shumë-etnik. Ajo popullohet me shumicë nga shqiptarët (mbi 90% të popullsisë) dhe nga pakica serbe, malazeze, turke, rome dhe myslimane (boshnjake) etj. Dendësia mesatare e popullsisë është e lartë, rreth 196 banorë për km² ose sa dyfishi i dendësisë së popullsisë së republikës së Serbisë. Rajonet më të populluara janë territoret e rrafshëta dhe ato përreth qyteteve të mëdha, si Prishtina, Prizreni, Mitrovica. Qytete të tjera të rëndësishme janë Peja, Gjakova, Gjilani etj.

Qytetet dhe në tërësi Republika e Kosovës dallohen për një trashëgimi të pasur kulturore, që është dimension i rëndësishëm i kulturës kombëtare shqiptare. Disa nga monumentet më të spikatuara të kulturës materiale janë: në Mitrovicë Hamami i bukur turk, i shekullit XIX; në Prishtinë Xhamia e Mbretit (FA TIH), e ndërtuar në vitin 1461 nga sulltani turk Mehmedi II Fatih, Sahat-kulla, me kumbonë punuar në vitin 1764. Në qendër të qytetit të Prishtinës gjendet xhamia Çarshi ose Tash, të cilën e ka ndërtuar sulltan Bajaziti pas betejës së Kosovës. Gjithashtu, afër qytetit gjenden edhe dy tyrbe: ajo e sulltan Muratit dhe e Gazi Mestanit. Ndër qytetet më të bukura të Dardanisë Ilire, janë mbeturinat e qytetit antik të Ulpianës, dëshmi e kulturës materiale të periudhës së perandorit bizantin me origjinë ilire Justinianit. Interesante dhe për t'u shënuar është arkitektura e qytetit të Pejës, me një numër të konsiderueshëm shtëpish të feudalëve, ndër të cilat konaku i Tahir Begut, shtëpia e Jashar Pashës, Kulla e Sheremetit etj., të cilat, megjithëse janë ndërtuar në periudhën turke, janë shembuj tipikë të kullës shqiptare të Dukagjinit. Në qendër të qytetit të Pejës është Çarshia e Vjetër, Xhamia e bukur "Bajrakli", e shekullit XIV etj. Në Gjakovë, ndër veçoritë urbane turistike është interesante Çarshia e Vjetër rreth Xhamisë së Hadumit, e ndërtuar në shek. XVI.

Rreth 8 km nga Gjakova, në drejtim të Prizrenit, është ura e vjetër e Terzive, mbi lumin Erenik. Shembulli tipik i trashëgimisë kulturore të urbanistikës dhe arkitekturës iliro-arbërore-shqiptare, është qy-



teti i Prizrenit. Këtë e dëshmojnë numri i konsiderueshëm i monumenteve kulturore dhe historike, si Kalaja e Prizrenit në kodrën që dominon qytetin, shtëpitë dhe lagjet tregtare, hamamet, xhamitë, teqetë, karavan-sarajet, medresetë etj. Ndër monumentet publike të periudhës osmane dallohen: Xhamia e Sinan Pashës, ajo e Gazi Mehmed Pashës (Bajrakli-xhamia), hamami i Mehmed Pashës etj.

ASPEKTE EKONOMIKE

Kosova ka pasuri të mëdha nëntokësore, sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore, pozitë të favorshme gjeografike dhe një popullsi aktive, vitale dhe punëdashëse. Me gjithë kushtet e favorshme për zhvillimin e ekonomisë, pushtuesit serbo-jugosllavë zhvilluan në Kosovë një ekonomi të tipit kolonial. Ajo ka shërbyer për Serbinë si burim lëndësh të para dhe e fuqisë punëtore me çmim të lirë. Për pasojë, Kosova sot është një vend bujqësor-industrial i pazhvilluar. Tokat bujqësore zënë 54%, ndërsa pyjet zënë 40% të sipërfaqes së përgjithshme. Mbi $\frac{3}{4}$ e sipërfaqes bujqësore mbillen me drithëra (grurë e misër). Rajonet më të njohura të prodhimit të drithërave janë Fusha e Kosovës dhe Rrafshi i Dukagjinit. Prodhime të tjera të rëndësishme janë: luledielli, panxharsheqeri, duhani (Dukagjin e Morava e Sipërme), pemë të shumëllojshme etj.

Kosova ka një traditë të gjatë zhvillimi të vreshtarisë. Zonat më të njohura për vreshtari janë zona e Rahovecit, Suharekës dhe Prizrenit. Vera cilësore e Kosovës është e njohur në tregun ndërkombëtar, sidomos në Gjermani.

Blegtoria jep gati gjysmën e prodhimit të përgjithshëm bujqësor. Pjesën më të madhe të prodhimit blegtoral e japin bagëtitë e imëta, të përhapura kryesisht në zonat kodrinore e malore. Gjdhët janë përhapur sidomos në zonat fushore dhe në afërsi të

qendrave të mëdha të banuara.

Kosova ka kushte të përshtatshme edhe për zhvillimin e industrisë. Ajo është e pasur me minerale të shumëllojshme, burime energjetike të mëdha, lëndë të para bujqësore e blegtorale. Por për shkak të politikave koloniale që ka ndjekur Serbia, në Kosovë janë zhvilluar kryesisht industria e nxjerrjes së mineraleve dhe e prodhimit të energjisë elektrike.

Industria e Kosovës është e bazuar në rezervat e mëdha të qymyrgurit të përqendruara në Obiliq, ku janë ndërtuar edhe termocentralet për prodhimin e energjisë elektrike.

Qendra kryesore e metalurgjisë së prodhimit të zinkut dhe plumbit është kombinati metalurgjik i Trepçës në Zveçan të Mitrovicës. Në Kosovë ka disa uzina për prodhimin e pjesëve të këmbimit për automjetet, të pajisjeve elektrike, të aparateve elektro-shtëpiake, të industrisë kimike, të industrisë tekstile, ushqimore etj. Këto degë të industrisë janë të përqendruara në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Gjiilan etj.

Transporti në Kosovë është zhvilluar kryesisht sipas interesave të metropolit serb për shfrytëzimin e pasurive natyrore. Për pasojë, një pjesë e territorit, kryesisht zonat e rrethinave, kanë mbetur të mbyllura. Kosova ka 5 602 km rrugë automobilistike dhe 333 km rrugë hekurudhore, të cilat janë të lidhura me rrjetin e rrugëve ndërkombëtare.

Aeroporti i vendit ndodhet në Sllatinë, 17 km në jugperëndim të Prishtinës. Që nga viti 2000 ky aeroport kryen fluturimet në drejtim të Tiranës. Në riaktivizimin e biznesit dhe të lidhjeve ekonomike tradicionale të Kosovës me shtetin amë, Shqipërinë dhe krijimin e tregut unik kombëtar (Komunuellsit shqiptar në Ballkan), rol të rëndësishëm do të luajë rruga e kombit (magjistrali automobilistik Durrës-Prishtinë), si dhe ndërtimi në të ardhmen i korridorit Adriatik-Alpe apo "Lugina e Zhvillimit". Kjo rrugë mendohet të ndërtohet gjatë aksit nga Shëngjini nëpër Luginën e Drinit në Qafë-Morinë (Tropojë) dhe deri në Gjakovë. Këto rrugë, jo vetëm që do të ndihmojnë në shfrytëzimin sa më racional të resurseve natyrore, burimeve njerëzore dhe në specializimin e shkëmbimin e mallrave sipas parimit të "avantazhit krahasues", por edhe në bashkimin kulturor dhe shpirtëror të trojeve etno-kulturore shqiptare në Ballkanin Perëndimor.

Me këto procese zhvillimi, Kosova e pavarur e demokratike ndodhet përballë sfidës së madhe të integritimit në Bashkimin Evropian.



Të ndjesh Ramazanin

Nexhla Gynaj

Sdhe këtë vit, muaji i Ramazanit erdhi kur e prisnim dhe gëzoi gjithë rruzullin tokësor... na urdhëroi që të zbukurohemi, që të shpëlahmë me mëshirën e tij shpirtat që rënkojnë nën peshën e gjynaheve dhe që të na përfshijë begatia e tij. Ardhja e tij qe gëzim i pastër për të rinjtë, eliksir rinie për të moshuarit.

Agjërimi është çelësi i falënderimit për Allahun që na solli në këtë botë nga asgjëja dhe që na pajisi me begati të panumërta. Ai është edukator i shkëlqyer që edukon shpirtat e besimtarëve. Ai nuk mjaftohet vetëm duke u kujtuar njerëzve se begatitë që zotërojnë nuk janë prona e tyre e përhershme, por i fton të pasurit të ndihmojnë të varfërit në mënyrë që dallimin ekonomik që ekziston ta zhdukë përfare. Po të mos kishte ardhur muaji i agjërimit, atëherë si do ta kuptonin njerëzit që i kanë të gjitha të mirat, hallin e nevojtarëve? Për këtë arsye agjërimi u bë farz për të gjithë pa bërë dallim i varfër apo i pasur.

Besimtarët në muajin e Ramazanit ngjasojnë me një ushtri të rregullt. Të gatshëm nën urdhrin "Urdhëroni!" atëherë kur afron iftari si të ishin të ftuar në gostinë e Mbretit të Përvjetshëm. Zoti e ka pajisur rruzullin tokësor si një sofër të begatë dhe u ka treguar në këtë mënyrë robërve të Tij cilësitë, Rahman dhe Rrahim.

Adhurimi i agjërimit e forcon lidhjen me Krijuesin dhe bën që fjalët dhe veprimet e manifestuara në ibadete të fitojnë vlera të vazhdueshme. Në të kundërt, ata që nuk e përfillin aq shumë atë, u shndërrohen agjërimi në uri, mosharxhimi në kopraci dhe bujaria në shpenzim të kotë. Fjalët dhe veprimet e atyre që nuk kanë një lidhje të fortë me Zotin e tyre janë të parëndësishme, sepse jeta fiton vlerë prej saj.

Muaji i Ramazanit fsheh në vete një jetë të përvjetshme në botën e përkohshme, ku jetojmë këtë jetë të shkurtrë. Ata që kalojnë tetëdhjetë vjet të jetës së tyre duke

ndjerë frytet e muajit të Ramazanit janë ata që ruajnë me kujdes brenda sëndukut të veprave, pasurinë e tyre për jetën tjetër. Ramazani është një panair hyjnor që mbulon çdo vend dhe ka vlerë fitimi të madh për biznesin e ahiretit.

Vlera që e bën aq të rëndësishëm muajin e Ramazanit është Kurani. Për këtë arsye myslimani duhet të përpiqet në muajin e Ramazanit të lexojë sa më shumë Kuran, të vërë sa më shumë rregull në jetën e tij shpirtërore, të pajiset sa më shumë me moralin e Kuranit dhe të vërë sa më shumë kufi për kërkesat e nefsit në krahasim me muajt e tjerë...

Duke pasur parasysh edhe paralajmërimin hyjnor të Allahut: **"A nuk mendojnë ata rreth Kuranit? Apo zemrat e tyre janë të kyçyra?"** (Surja 47, ajet 24) duhet që ta kuptojmë sa më shumë Kuranin që lexojmë dhe të përpiqemi t'i praktikojmë sa më shumë në jetë ato që lexojmë.

Duhet të përpiqemi që të mos e humbim sihariqin e Profetit tonë se **"Kush e agjëron një muaj Ramazan duke besuar tek savapet dhe begatia e këtij muaji, kanë për t'iu falur gjynahet."** Nga agjërimi që nuk i bën shpirtat më të sinqertë, veprat më të drejta, fitimet më shumë hallall dhe moralin më të devotshëm, njeriu përjeton një rrudhje të brendshme.

Ata që e vlerësojnë muajin e Ramazanit që po kalojnë si të fundit në jetën e tyre dhe që përpiqen që të mbledhin sa më shumë trëndafilë nga kopshti i lumturisë shpirtërore, inshallah do të jenë të ftuar në botën tjetër. Kur thoni "shpresa e vetme për mua janë veprat e mia" dhe përpiqeni që të punoni me sinqeritet sipas kësaj fjale, atëherë nuk do ta keni të vështirë që të arrini edhe bukuritë e përhershme të Ramazanit. Zoti na e bëftë të mundur të gjithëve të jetojmë një Ramazan, ashtu siç e ka hije. Mos na ndaftë nga rruga e Tij dhe mos na turpëroftë përpara Tij!



Një Ajet

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

“O ju që besuat! Agjërimi u është bërë obligim siç ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” (Bekare, 183)

Agjërimi është një adhurim, obliguar për çdo mysliman, ashtu siç ka qenë detyrim edhe për të gjithë popujt e tjerë para islamit. Si çdo adhurim tjetër edhe agjërimi ka dobi të shumta individuale dhe shoqërore. Përveç se është adhurim që shpreh nënshtrimin e plotë ndaj vullnetit të Allahut, agjërimi njëkohësisht luan një rol të rëndësishëm, duke kontribuar në procesin e ndryshimit të vetvetes dhe ripërtëritjen shpirtërore. Ai ka ndikime të mëdha në përmirësimin e sjelljeve të njeriut dhe, për pasojë edhe përmirësimin e sjelljes kolektive. Agjërimi ka qëllime dhe përfitime me interes, jo vetëm për vetë agjëruenin, por edhe qëllime e përfitime që shkojnë në interes të të gjithë shoqërisë islame.

Agjërimi nuk është thjesht privim nga ngrënia dhe pija, por më tepër është privim i përkohshëm i së lejuarës, për të lehtësuar ndalimin e përhershëm të së ndaluarës. Së pari, ramazani sjell ndryshime dramatike në mënyrën gastronomike dhe, në këtë mënyrë, jep shenjën e parë për ndryshime rrënjësore që duhet të ndodhin gjatë muajit të agjërimin në qenien e njeriut. Ndryshimit të kohës dhe mënyrës së të ushqyerit, i shtohet ekstra edhe namazi i teravive, mbas namazit të jacisë. Kështu, fiziku i përshtatet këtij ndryshimi, duke u hapur rrugë ndryshimeve shpirtërore. Të gjitha këto ndryshime horizontale që sjell agjërimi, pasohen me një sërë ndryshimesh vertikale, si privimi i plotë nga çdo ndjenjë negative, duke shprehur mirësjellje, dashuri dhe respekt ndaj njëri-tjetrit. Në këtë fazë, çdo organ merr përsipër detyrën dhe përgjegjësitë e veta. Kështu, goja nuk privohet vetëm nga ushqimi, por edhe nga fjalët e pahijshme. Në të njëjtën kohë, agjëron edhe zemra, duke iu drejtuar Allahut me sinqeritet të plotë. Ky është muaji i ndryshimit edhe për faktin se është muaji, në të cilin ka zbritur Kurani Famëlartë, nëpërmjet të cilit ndryshoi e gjithë historia e njerëzimit. Muaji i ramazanit thërret në solidaritet dhe e nxit njeriun për bamirësi. Për këtë arsye, në muajin e ramazanit kemi edhe institucionin e sadekatu-l-fitrit, i cili u jepet të varfërve dhe kjo tregon se muaji i ramazanit është muaj i solidaritetit dhe i bamirësisë.

Të gjitha këto ndryshime që sjell agjërimi, janë në funksion të qëllimit të tij kryesor, i cili është devotshmëria. Sepse devotshmëria është faktori kryesor që motivon njeriun në kryerjen e veprave të pëlqyera nga Allahu teala dhe largimin prej veprimeve që janë të urreyera nga Ai. Devotshmëria e mban besimitarin larg çdo mëkati, sado i vogël qoftë. Besimtarët që janë të vetëdijshëm për rëndësinë e devotshmërisë, e shohin si një qëllim që duhet arritur me një dëshirë të zjarrtë. Dhe agjërimi na shfaqet si rrugë, si mjet për të arritur këtë qëllim fisnik.

Një Hadith

*Ebu Hurejra, (r.a.) transmeton
se Resulullahi (s.a.v.s.) ka thënë:*



"Kush agjëron muajin e Ramazanit, duke qenë besimtar dhe duke shpresuar shpërblimin prej Allahut, atij do t'i falen të gjitha mëkatet e shkuara."

Pranimi i veprave dhe ibadeteve nga ana e Allahut, bëhet i mundur vetëm me plotësimin e dy kushteve: besimit dhe sinqeritetit, siç shprehet qartë në hadithin e mësipërm me shprehjet duke "qenë besimtarë dhe duke shpresuar shpërblimin prej Allahut". Nga këto që thamë, mund të na vijë ndërmend pyetja se si mundet një njeri të shfaqë vepra besimtari, pa qenë besimtar? Por fatkeqësisht, realiteti me të cilin përballemi, është me të vërtetë jo i këndshëm. Shumë njerëz, megjithëse jobesimtarë, për arsye nga më të ndryshmet kryejnë një sërë ibadetesh. Nuk janë të pakta rastet, kur individë të ndryshëm besojnë se puna që kryejnë është obligim nga ana e Allahut teala, por, kur bëhet fjalë për zbatimin e saj, e përziejnë me hipokrizi, duke e kryer për shkaqe nga më të ndryshmet. Këto lloj veprash, sado të duken si ibadete, nuk e arrijnë gradën e vlefshmërisë. Dhe konkretisht, hadithi në fjalë tërheq vëmendjen për këtë anë të rëndësishme të ibadeteve, duke i përgëzuar ata që i plotësojnë këto kushte në agjërimin e tyre se do t'u falen të gjitha mëkatet e kaluara. Shprehjen "falen mëkatet", dijetarët e kanë komentuar si mëkate të vogla dhe, në rastet kur nuk ka mëkate të vogla, një agjërim i kryer sipas përshkrimit të hadithit, lehtëson mëkatet e mëdha. Përsëri duke u bazuar te hadithi, dijetarët kanë arritur në konkluzionin se, edhe nëse një person, për shkaqe të arsyeshme nuk arrin ta plotësojë muajin e ramazanit, futet në grupin e të përgëzuarve në hadith për sinqeritetin në qëllim. Në hadith nuk përfshihen vetëm njerëzit që kanë mëkate, por edhe ata që nuk kanë mëkate për t'u falur, të cilët me anë të agjërimit arrijnë pozita më të larta tek Allahu teala. Vetëm nëpërmjet mënyrës së agjërimit, sipas përshkrimit të hadithit, agjërimi i ramazanit mund të luajë rolin e vet në ndryshimin dhe ngritjen shpirtërore të njeriut. Ramazani është epiqendër për përforcimin e fuqive shpirtërore, psikike e morale në jetën e popullit apo të individit. Myslimani, i cili agjëron me vullnet të lirë e bindje të plotë, për hir të Zotit e afrimit ndaj Tij, merr pjesë aktive në rindërtimin e vlerave fisnike.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Kush beson në obligueshmërinë e ramazanit dhe shpërblimin e pret vetëm prej Allahut, atij do t'i falen gjynahet e shkuara.
2. Besimi tek Allahu dhe shpresa e shpërblimit vetëm tek Ai, është kusht për vlefshmërinë e ibadeteve.



VËLLAZËRIA

Vëllazëria islame është një dashuri hyjnore që Allahu i Lartmadhëruar e ka vendosur tek besimtarët e singertë, e cila, nëse kultivohet ose përjetohet, do të ketë një shpërblim të jashtëzakonshëm. Është burimi i qetësisë, gëzimit dhe lumturisë së individit, por edhe i shoqërisë. Vëllazëria islame nënkupton përfshirjen e të gjithë besimtarëve në ngrohtësinë e atmosferës dashurore të shpirtit, nënkupton të bëhesh mik shpirti me çdonjërin që ndan të njëjtat të vërteta besimore me ty, të gëzohesh me gëzimet e vëllezërve të fesë tënde dhe të hidhërohesh me hidhërimet e tyre, të bëhesh burim ngushëllimi e, nëse është nevoja, të jesh gati të sakrifkohesh.

Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Ka disa njerëz, të cilët nuk janë as nebi e as shehidë, mirëpo në botën tjetër, do të kenë aq grada të larta, sa do t’i kenë zili edhe nebitë edhe shehidët.”

Sahabët e nderuar pyetën:

- Kush janë këta dhe çfarë veprash të mira kanë bërë, o i Dërguari Allahut? Na informo, në mënyrë që edhe ne t’i duam dhe t’u qëndrojmë afër!

I Dashuri i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-

lem, u tha:

- Këta janë një grup njerëzish, të cilët, pa pasur asnjë lidhje farefisnore apo tregtare, pra vetëm për hir të Allahut të Lartmadhëruar, e duan shumë njëri-tjetrin. Betohem në Allahun e Lartmadhëruar, fytyrat dhe mimberet, ku ata do të ndodhen, janë të nurta. Në ditën e Gjyqit të Madh, kur të gjithë do të jenë të kapluar nga frika, ata do të jenë të çliruar tërësisht; atëherë kur njerëzit e tjerë do të jenë të trishtuar, ata do të jenë të lumtur.

Më pas, Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u lexoi këtë ajet kuranor:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut). Ata i pret lajmi i mirë në këtë jetë dhe në tjetrën. S’ka ndryshim në fjalët e Allahut; kjo është fitorja madhështore.” (Junus, 62-64) (Ebu Davud, Buju 76/3527; Hakim, IV, 170.)

Në një hadith tjetër, Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në lidhje me dashurinë e vëllait mysliman, që bëhet shkak për të fituar kënaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar, ka thënë:

“Një besimtar u nis për rrugë, për të vizituar vëllain (e tij të fesë) në fshatin tjetër. Për ta sprovuar



atë, Allahu i Lartmadhëruar dërgoi një Melek (në siluetën e njeriut), i cili e pyeti:

-Ku po shkon?

Ai iu përgjigj:

-Në fshatin këtu afër, kam një vëlla mysliman.

Meleku sërish e pyeti:

-Ke ndonjë interes me të?

Burri u përgjigj:

-Jo! Unë atë e dua vetëm për hir të Allahut të Lartmadhëruar. Kjo është e vetmja arsye, për të cilën po shkoj t'i bëj vizitë.

Pas kësaj, Meleku u shpreh:


-Ashtu siç e do ti vëllain tënd mysliman, ashtu të do edhe ty Allahu i Lartmadhëruar. Mua më dërgoi Allahu i Lartmadhëruar për të të dhënë këtë sihariq. (Muslim, Birr, 38; Ahmed, II, 292.)

Në një hadith tjetër thuhet:

“Shtatë grupe njerëzish do të jenë në hijen e Arshit atë ditë, kur nuk do të ketë asnjë hije tjetër..., (ndër ta bën pjesë) grupi i njerëzve që duan njëri-tjetrin vetëm për hir të Allahut, ata që takohen me njëri-tjetrin për hir të kësaj dashurie, por që edhe ndahen

me këtë dashuri...” (Buhari, Edhan, 36)

Qëllimi i dashurisë, që besimtarët e plotësuar ndjejnë për vëllezërit e tyre, është vetëm arritja e pëlqimit të Allahut të Lartmadhëruar. Përfitimi nga dua e vëllait tënd mysliman dhe miqësi me të, lidhet vetëm me një qëllim, me atë të mundësisë së të qënit më afër me Allahun e Lartmadhëruar.



“Shtatë grupe njerëzish do të jenë në hijen e Arshit atë ditë, kur nuk do të ketë asnjë hije tjetër..., (ndër ta bën pjesë) grupi i njerëzve që duan njëri-tjetrin vetëm për hir të Allahut, ata që takohen me njëri-tjetrin për hir të kësaj dashurie, por që edhe ndahen me këtë dashuri...”

(Buhari, Edhan, 36)

Në tasavvuf fjala **“ihvan”**, që do të thotë **“vëlla”**, shpreh ndihmën reciproke në rrugën që të shpie tek Allahu i Lartmadhëruar, mbështetjen e ndërsjelltë në çështjet fetare dhe shpirtërore, plotësimin e mangësive dhe ndarjen e çdo derti me njëri-tjetrin, duke u jetuar kështu vëllazëria islame në nivelin më të plotë dhe të thellë.

Një herë, Bishri Hafi dërgon Esved bin Salimin tek Maruf Kerhi. Esved bin Salimi, pasi arrin tek Maruf Kerhi, i thotë atij:

-Bishri Hafi dëshiron të vëllazërohet me ty. Mua më dërgoi tek ti për të ta thënë këtë. Ai kërkon prej teje ta pranoni vëllazërinë e tij.

Maruf Kerhi u shpreh:

-Unë nuk dëshiroj të ndahem as natën e as ditën prej atij me të cilin vëllazërohem.

Pastaj lexoi shumë hadithe që flasin për vlerat e dashurisë për hir të Allahut të Lartmadhëruar. Ai u shpreh kështu, në lidhje me faktin se si duhet të jetë vëllazëria:

“I Dërguari i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke bërë Aliun (r.a.), vëlla, e bëri atë shok (ortak) në diturinë e tij. I dha atij vajzën, aq të dashur për të. Bëhu dëshmitar ti, meqë ty të ka dërguar Bishri Hafiu për këtë çështje, se unë për hir të Allahut të Lartmadhëruar e pranoj vëllazërinë me të. Thuaji atij se do të shihemi në sohbe. Tani e tutje të mos më fshehë asnjë gjë që lidhet me të, të më informojë mua për çdo gjë...”

Kur Ibn Salimi ia transmeton fjalët Bishri Hafiu, ai lumturohet dhe pranon me dëshirë çdo kërkesë të Maruf Kerhit.

VËLLAZËRIA ISLAME ËSHTË MË ME VLERË...

Vëllazëria islame është një lidhje aq e shenjtë, sa nuk mund të krahasohet as me shoqëritë e përkohshme, as me miqësitë që zgjasin sa jeta, madje as me vëllazërinë e gjakut.

Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili i ka mësuar njerëzimit disiplinën dhe edukatën e vëllazërimit, ka thënë:

“Nëse do të pranoja nga njerëzit ndonjë mik, do të zgjidhja Ebu Bekrin. Mirëpo, vëllazëria islame është shumë më me vlerë.” (Buhari, Salat, 80.)

Vëllazëria islame përbën pikën kulmore të miqësisë. Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e mban më lart vëllazërinë islame se sa miqësinë, kur përmend Ebu Bekrin, radijall-llahu anhu, për të cilin ka thënë se ai është “Shoku i Shpellës”, ndër të tretët, i dyti që është më afër Allahut të Lartmadhëruar, Besniku më i madh!.. *“Të mbyllen të gjitha dyert, veç derës së Ebu Bekrit...”; “Ebu Bekri është nga unë, ndërsa unë jam nga ai...”,* për arsye të lidhjes së tij me Hazreti Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, vetë i Dërguari i Allahut i ka vënë atij epitelin **“më i afërti me sekretet e profetësisë”**...

Vëllazëria e gjakut lidhet në mënyrë direkte



me këtë dynja të përkohshme dhe relative. Kur erdhëm në këtë botë, ashtu siç nuk zgjodhëm prindërit, nuk zgjodhëm as vëllazërit. Në lidhje me këtë temë, njeriut nuk i është dhënë e drejta e zgjedhjes. Ndërsa në temën e përzgjedhjes së vëllazërve të fesë, ne kemi liri të plotë, pra është lënë në iniciativën tonë. Dhe saktësia e përzgjedhjes së këtyre vëllazërve, është ajo që i sjell dobi njeriut.

Hasan Basriu (r.a.), ka thënë:

“Miqë dhe vëllazërit tanë (nga feja) janë më të dashur tek ne, se pjesëtarët e familjes. Familjarët tanë na përmendin vetëm në këtë dynja, ndërsa miqë do të na kërkojnë edhe në Mahsher.” (Ihya, v. II, fq. 437.)

Muhamed bin Jusuf Isfehani (r.a.), ka thënë:

“Si mund të jetë njëllor familja më vëllazërinë e fesë? Të parët marrin pasurinë tënde dhe kalojnë kohë të bukur duke e harxhuar atë. Ndërsa të dytët mbajnë matem (zi)për ty, mendojnë për gjendjen tënde të varrit e të bëjnë dua, kur ti je nën dheun e zi.”

Njëri ndër kushtet themelore të vëllazërisë islame është mirënjohja. Të kultivuarit e dashurisë me vëllazërit e fesë gjatë gjithë jetës, por edhe pasi ndonjëri prej tyre ndërron jetë, të vazhduarit e miqësisë me familjarët, të afërmit e tij, bërja e duasë vazhdimisht për të, është pjesë e mirënjohjes.

*“Miqtë dhe vëllezërit tanë (nga feja) janë
më të dashur tek ne,
se pjesëtarët e familjes.
Familjarët tanë na përmendin vetëm
në këtë dynja, ndërsa miqtë
do të na kërkojnë edhe në Mahsher.”*

VËLLAZËRIA NDËRMJET ENSARËVE DHE MUHAXHIRËVE

Që ne të kuptojmë se si duhet të jetë vëllazëria e vërtetë, Allahu i Lartmadhëruar ka dhënë shembullin e vëllazërisë ndërmjet Ensarëve dhe Muhaxhirëve. Ai dëshiron që ta organizojmë gjendjen tonë duke vëzhguar ata.

Marrëveshja vëllazërore Muhaxhir-Ensar, që realizoi Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është një tablo e pashoqe virtyti. Ensarët nuk fshehën asnjë gjë nga pasuria dhe shprehën gatishmëri të plotë për ta ndarë atë në mënyrë të barabartë me vëllezërit e tyre, Muhaxhirë. Përballë bujarisë së Ensarëve, Muhaxhirët u treguan të matur dhe të pjekur dhe, në një gjendje shpirtërore, që nuk e njihje lakminë dhe pangopësinë, u shprehën:

“Allahu i Lartmadhëruar e bekoftë pasurinë tuaj! Mjafton të na tregoni rrugën se si mund ta fitojmë vetë atë.”

Ata dhanë shumë shembuj gjatë jetës së tyre, duke treguar se vëllazëria islame është më e lartë dhe më me shumë vlera se lidhja farefisnore.

Në luftën e Bedrit, që shënon qëndresën e parë ndaj kufrit (pabesimit), u gjendën përballë shpatë për shpatë, Ebu Bekri, radijall-llahu anhu, me të birin, Ebu Ubejd bin Xherrah, radijall-llahu anhu, me të atin, Hamzai, radijall-llahu anhu, me të vëllanë. Kështu, lidhja që kultivonte feja qëndronte mbi çdo lidhje tjetër...

Ja si i shpjegon Zubejr bin Avvami, radijall-llahu

anhu, skenat vëllazërore që janë jetuar në luftën e Uhudit:

“Nëna ime, Safije, nxori dy hërkat që kishte sje-llë dhe tha:

«I solla që t’i përdorni si qefin për Hamzanë.»

I morëm hërkat dhe erdhëm tek Hamzai, radijall-llahu anhu. Aty afër ishte një shehid (dëshmor) tjetër nga Ensarët, për të cilin akoma nuk ishte gjetur një qefin për ta mbuluar. Na erdhi turp të mbulonim me dy qefinë Hamzanë (r.a.) dhe të linim shehidin tjetër krejt të pambuluar. Menduam që me njërin prej tyre të mbulonim Hamzanë (r.a.), ndërsa me tjetrin shehidin ensar. Njëra herkë ishte e madhe e tjetra e vogël, prandaj hodhëm short, në mënyrë që të ishim sa më të drejtë.” (Ahmed, I, 165.)

Allahu i Lartmadhëruar e ka shprehur pëlqimin e Tij ndaj kësaj vëllazërie, duke e përfshirë atë në Kuran e duke përjetësuar kështu mesazhin dhe kujtimin e vëllazërisë së tyre:

Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndjejnë kurrfarë rëndimi, për atë që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtare... (Hashr, 9.)

Ajeti i mësipërm përfshin shumë elementë të drejtësisë së vëllazërimit. Sipas këtij ajeti, vëllazëria islame nuk ka për qëllim vetëm afërsinë dhe miqësinë në kohë të mira, nëpërmjet bisedave, kafeve e çajave, por afërsia, miqësia dhe mbështetja që shfaqet në kohë të vështira, duke u bërë ortak në hallin e vëllait tënd mysliman. E në mënyrë të veçantë, vëllazëria islame kërkon të vendosësh veten para tjetrit.

MOS IU BËJ BARRË, POR MIK, TJETRIT!

Njëherë, dikush e pyeti Xhunejd Bagdadin:

–Në kohët tona është zvogëluar shumë vëllazëria e vërtetë islame. Ku janë sot ata që duheshin për hatër të Zotit?

Xhunejd Bagdadi iu përgjigj:

-Në qoftë se ti kërkon dike, me të cilin të ndash hallet e tua e, që ai të të ndihmojë, nuk do ta gjesh, sepse në kohët tona nuk ka njerëz të tillë. Por ama, nëse dëshiron të gjesh ndonjë vëlla, të cilit ti do t'i bëhesh ndihmë e mbështetje, të tillë ke sa të duash.

Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Besimtari ia kalon mirë me të tjerët dhe të tjerët ia kalojnë mirë me të. Nuk ka hajër (mirësi) tek ai, i cili nuk shkon mirë me të tjerët dhe me të cilin të tjerët nuk shkojnë mirë. (Ahmed, II, 400; V, 335; Hakim, I, 73/59.)

Kushti i parë i të kaluarit mirë me vëllain tënd të fesë, është të kujdesesh që të mos biesh në ato pozita, sa të bëhesh barrë për tjetrin, përkundrazi, duhet t'ia lehtësosh barrën atij. Miqësia e atij, që nuk i bëhet rëndë kujt dhe dashuria e atij, që nuk i fut të tjerët në vështirësi, është e vazhdueshme.

Në vëllazërinë islame ka disa kushte, ndaj të cilave duhet treguar shumë vëmendje dhe rëndësi. Këto janë kushtet që përbëjnë edhe detyrimet tona ndaj vëllazërisë islame. Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka shprehur në mënyrë të përmbledhur këto detyrime:

"Myslimani ka gjashtë detyra ndaj vëllait të tij mysliman: Kur takohet, ta përshëdesë me selam, nëse vëllai i tij kërkon këshillë, ta këshillojë atë, kur ai të teshtitet, t'i thotë «Jerhamukell-llah», t'i bëjë vizitë atij kur sëmuret dhe kur ai vdes t'i shkojë në xhenaze." (Muslim, Selam, 5.)

"Përhapeni selamin, ushqeni të varfërit, bëhuni kështu vëllezër, siç ju urdhëron i Madhërishmi, Allahu." (Ibn-i Maxhe, Et'ime, 1.)

Vizionin e drejtësisë dhe të detyrimeve tona ndaj vëllazërisë islame duhet ta kemi shumë të gjerë. Niveli ynë i vëllazërisë tregon edhe nivelin tonë shpirtëror. Prandaj themi:

1. Ai besimtar, që ka gjendjen e mirë, duhet të

"Ai që nuk dëshiron për vëllain e tij mysliman, atë që dëshiron për vete, nuk mund të jetë mysliman i vërtetë."



ndihmojë vëllain e tij besimtar që është në nevojë, kur ai ia kërkon një gjë të tillë. Kjo përbën edhe kushtin e parë të vëllazërisë islame. Allahu i Lartmadhëruar ka thënë në Kuran:

"...Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu..." (el-Kasas, 77.)

Aliu, radijall-llahu anhu, ka thënë:

"Dy janë mirësitë që më gëzojnë më së shumti, por nuk e di se cila më gëzon më tepër. E para lidhet me besimin që një njeri tjetër ndjen ndaj meje, duke ardhur tek unë për të qarë hallin e tij në mënyrë të sinqertë e duke kërkuar kështu ndihmë prej meje. Ndërsa e dyta, kur Allahu i Lartmadhëruar më bën mua sebeb (shkak) për zgjidhjen e nevojës që njeriu në fjalë ka ose për lehtësimin e saj. Të bëhem sebeb për largimin e mërziisë nga një mysliman, është për mua më më vlerë sesa kjo dynja e mbushur me ar dhe argjend." (Ali el-Muttaki, *Kenzu'l-Ummâl*, VI, 598/17049.)

2. Niveli i dytë është t'i gjendesh në ndihmë vëllait tënd mysliman, pa e detyruar atë të ta kërkojë, duke arritur urtësinë e ajetit, në të cilën Allahu i Lartmadhëruar ka thënë: ***"...Do t'i njohësh nga pamja e tyre..."*** (el-Bekare, 273). Ky ajet kuranor kërkon prej nesh që të arrijmë një nivel aq të lartë shpirtëror, sa të mund t'i dallojmë vëllezërit në nevojë nga fytyrat e tyre. Nga turpi dhe nga morali, ata nuk mund të lypin. Është detyra jonë t'i dallojmë që nga fytyra. E ky është një nivel i lartë vëllazërie.

Ky ishte niveli shpirtëror i Omerit, radijall-llahu anhu, i cili me thasë mielli në shpinë, shëtiste në errësirën e natës, shtëpi më shtëpi, tek njerëzit



nevojtarë e me shumë halle.

3.Një nivel edhe më i lartë është arritja e **“birr”** (detovshmërisë), që do të thotë të arrish të kërkosh për vëllain tënd atë që kërkon për vete. Të mund të mos e shohësh atë si të huaj, pra ta shohësh atë si pjesën tënde.

Duke shkuar në luftën e Bedrit, sahabët përdorën nga pamundësia, një deve tre vetë, duke hipur me radhë. Të njëjtën gjë bëri edhe Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tek po udhëtonte përkrah Aliut, radijall-llahu anhu, dhe Ebu Lubbabes, radijall-llahu anhu. Edhe pse këta dy sahabë dëshironin me gjithë shpirt që t'ia falnin radhën Hazreti Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ai nuk pranoi, pasi nuk bënte dallim mes tyre dhe vetes. (Shih Ibn Sa'd, II, 21.)

Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Ai që nuk dëshiron për vëllain e tij mysliman, atë që dëshiron për vete, nuk mund të jetë mysliman i vërtetë.” (Buhari, Iman, 7.)

Një shembull tjetër i këtij niveli të lartë shpirtëror është Osmani, radijall-llahu anhu. Kur në Medine kishte pllakosur thatësira, ai, duke paguar një shumë të lartë, bleu pusin Rume, të cilin ua dhuroi myslimanëve. Sipas transmetimeve të ndryshme, ai hynte në radhë si gjithë të tjerët për të mbushur ujë.

4.Ndërsa niveli më i lartë i vëllazërisë islame është makami i **isarit**, të zgjedhësh vëllain tënd

mysliman ndaj vetes tënde, të mund t'ia dhurosh atij atë që të takon ty, duke i dhënë përparësi ndaj vetes. Të mendosh nevojën e vëllait tënd mysliman para nevojës sate, duke shprehur durimin e mjaftueshëm për ta bërë këtë. Kjo është edhe grada më e lartë e dashurisë reciproke mes njerëzve, për hatër të Zotit, gradë e cila gjendet tek besnikët, të devotshmit dhe vepërmirët.

Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, më shumë se për vete, mendonte për umeitin e tij. Çfarëdo që të kishte, ua jepte njerëzve në nevojë. Kishte raste, kur nuk ndizej me ditë oxhaku i shtëpisë së tij, kur nuk gjendej asnjë kafshatë buke.

Njëri nga sahabët, Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, kishte lidhur një gur në stomak, pasi nuk kishte gjetur asgjë të hante. Në këtë gjendje, takoi Ebu Bekrin, radijall-llahu anhu, të cilin, me shpresën se do ta ndihmonte, e pyeti për një ajet kuranor. Ebu Bekri, radijall-llahu anhu, ia ktheu përgjigjen dhe menjëherë u largua. Më pas, andej pari u duk Omeri, radijall-llahu anhu, i cili bëri të njëjtën gjë që bëri Ebu Bekri. Ata të dy nuk kishin pasur asnjë mundësi materiale për ta ndihmuar Ebu Hurejren, radijall-llahu anhu, prandaj në heshtje e të mërzitur ishin larguar prej tij. Ndërkohë Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e pa Ubu Hurejren, e kuptoi gjendjen e tij nga fytyra, prandaj e ftoi në shtëpi. Në shtëpinë e Hazreti Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kishin sjellë një enë të vogël me qumësht. Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, u gëzua shumë kur pa qumështin, mirëpo Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i tha atij që të thërriste sahabët e Suffes. Sahabët e Suffes ishin mysafirët e islamit. Ata nuk kishin as familje, as pasuri e askënd ku të strehoheshin. Kur Hazreti Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i dërgonin ndonjë sadaka, menjëherë ua jepte banorëve të Suffes, ndërsa prej tyre nuk pranonte asgjë. Kur atij i bënë ndonjë dhuratë, një pjesë të dhuratës e mbante për vete, ndërsa pjesën tjetër ua dërgonte atyre.

Kur i Dërguari i Allahut ftoi sahabët e Suffes, Ebu Hurejre u mërzi pak. Qumështi nuk mja-

ftonte as për banorët e Suffes e jo më të tepronte edhe për të. Ai iu bind urdhërit të të Dërguarit të Allahut dhe shkoi t'i ftonte banorët e Suffes. Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, urdhëroi Ebu Hurejren, radijall-llahu anhu, t'i qeraste të gjithë sahabët e Suffes. Secili prej tyre piu qumësht nga ena, deri sa u ngop. Kur të gjithë sahabët e Suffes u ngopën, Ebu Hurejra, radijall-llahu anhu, ia zgjati enën me qumësht Resulullahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Ai e mori enën në dorë dhe iu drejtua Ebu Hurejres:

-Ulu dhe pi!

Ai u ul dhe piu, deri sa u ngop. Sa herë që Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, ia drejtonte enën Hazreti Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ai zotëri i thoshte:

-Ulu dhe pi

Më pas Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, i tha Hazreti Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

-Betohem në Atë që të ka dërguar ty si Pejgamber të së vërtetës, nuk mundem më të pi as edhe një pikë qumësht.

Më pas Hazreti Pejgamberi, alejhis-salatu ves-salam, e mori enën në duart e tij, falënderoi Allahun e Lartmadhëruar, tha besmelenë dhe piu qumështin e mbetur në enë. (Shih. Buhari, Rikak, 17.)

Kjo histori, që është jetuar në ditët e luftës së Hendekut, është shumë domethënëse:

Kur sahabët po gërmonin tokën për të bërë një hendek, hasën në tokë një shkëmb aq të madh, sa nuk mund ta thyenin. Shkuan tek Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem dhe e informuan. Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi

ve sel-lem, i cili nuk kishte futur gjë në gojë për tri ditë radhazi, zbriti në hendek, e goditi shkëmbin dhe e bëri copë e grimë. Ndërkohë Xhabiri, radijall-llahu anhu, i kërkoi Resulullahut, alejhis-salatu ves-salam, leje për të shkuar në shtëpi. Kur mbërriti, i tha gruas së tij se i Dërguari i Allahut, ishte në një gjendje të tmerrshme urie. Ai e pyeti atë:

-Çfarë ka për të ngrënë në shtëpi?

Gruaja i tha se kishte pak elb dhe një kec. Xhabiri, radijall-llahu anhu, e preu kecin dhe e bloi elbin. Mishin e vendosi në tenxhere, ndërsa bukën në furrë dhe menjëherë vrapoi tek i Dërguari i Allahut, të cilit i tha:

-O i Dërguari i Allahut! Kam pak ushqim për ju. Na urdhëroni, së bashku me dy-tre vetë!

I Dërguari i Allahut e pyeti se sa ushqim kishite. Xhabiri, radijall-llahu anhu, ia tregoi sasinë e ushqimit. Më pas i Dërguari i Allahut tha:

-Sa mirë, paska ushqim edhe të bollshëm edhe të mirë. Shko e thuaji bashkëshortes që, deri sa të vij unë, të mos e heqë tenxheren nga zjarri dhe të mos e nxjerrë bukën nga furra!

Mandej u tha sahabëve që të ngriheshin të gjithë së bashku, Muhaxhirë dhe Ensarë e të shkonin për të ngrënë. Xhabiri, radijall-llahu anhu, erdhi tek bashkëshortja e tij shumë i merakosur. Ai i tha gruas së tij të dashur:

-Medet çfarë na gjeti! Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, po vjen së bashku me shumë sahabë, nga Muhaxhirët dhe Ensarët.

Gruaja i tha:

Gruaja i tha:



“Ne kemi parë ato kohë, kur të gjithë mendonin thellë-thellë se secili prej nesh ulente më shumë se ari dhe argjendi. Tani jetojmë në një kohë tjetër, kur njerëzit duan më shumë se vëllain e tyre mysliman, arin dhe argjendin.”

(Hejthemi, X, 285)

-A të pyeti sa ushqim kemi?

Kur Xhabiri, radijall-llahu anhu, i tha se e kishte pyetur, ajo u shpreh se nuk kishte vend për telash, duke e qetësuar kështu bashkëshortin e dashur të saj. Nuk kaloi shumë kohë dhe sahabët mbërritën në shtëpi. Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u tha sahabëve:

-Hyni, pa u shtrënguar me njëri-tjetrit!

I Dërguari i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ndante bukën dhe vendoste mishin mbi të. Sa herë e bënte këtë e mbyllte tenxheren dhe furrën. Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, bëri të njëjtën gjë, deri sa sahabët u ngopën. Në fund ushqimi teproi. I Dërguari i Allahut iu drejtua gruas së Xhabirit:

-Ha nga kjo, qeras edhe komshinjtë, sepse uria po i shkatërron njerëzit! (Shih. Buhari, Megazi, 29; Vakidi, II, 452.)

Kjo shprehje e Ibn Omerit, radijall-llahu anhu, që shpalos pjekurinë shpirtërore të periudhës së artë, kur jetuan sahabët, të cilët i jepnin përparësi tjetrit ndaj vetës së tyre, është shumë kuptimplote:

"Ne kemi parë ato kohë, kur të gjithë mendonin thellë-thellë se secili prej nesh vlente më shumë se ari dhe argjendi. Tani jetojmë në një kohë tjetër, kur njerëzit duan më shumë se vëllain e tyre mysliman, arin dhe argjendin." (Hejthemi, X, 285.)

Kjo tablo merr një kuptim shumë më të madh, në kohët tona, kur ekuilibri mes materiales dhe shpirtërores është prishur, dashuria besimore ka humbur dhe shpirtrat janë plogështuar. Myslimanët janë prishur e janë ftohur me njëri-tjetrit për interesa të ngushta të kësaj bote. Vëllazëria islame është dobësuar nga injoranca, egoizmi dhe shterpësia emocionale.

Ndërsa Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, urdhëron që të kultivohet në mënyrë të sinqertë atmosfera dashurore ndërmjet besimtarëve, duke i dhënë përparësi njëri-tjetrit e jo nefsit apo egos personale.

Duhet theksuar mirë fakti se dashuria nuk është një kauzë e zbratur. Nuk mund të mendohet për ekzistencën e dashurisë pa u shkrirë me hallet e të tjerëve, pa sakrifikuar për të tjerët, e pa ua falur të metat atyre.

Vëllazëria islame nuk përbëhet nga fjalët e bukura, të cilat nuk shkrihen dot në praktikë. Ajo mund të jetohet vetëm kur shprehet në mënyrë konkrete me vepra të bukura. Ata që përgëzon Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, me sihariqin e vëllazërisë islame, janë njerëzit e plotësuar që ia dalin të jenë të suksesshëm me vepra konkrete në dashurinë vëllazërore.

Një ditë Hazreti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u tha sahabëve:

-Do të dëshiroja shumë të shihja vëllezërit e mi. Sa më ka marrë malli për ta!

Sahabët e nderuar e pyetën:

-A nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguari i Allahut?

I Dashuri i Allahut u përgjigj:

-Ju jeni sahabët e mi. Vëllezërit e mi janë ata që akoma nuk kanë ardhur (në këtë dynja). (Muslim, Taharet, 39, Fedail, 26.)

Që të mund ta meritojmë *gjendjen e të qenit vëlla* me Hazreti Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duhet medoemos të shkrihem me hallet e vëllezërve tanë dhe t'u shërbejmë me mish e me shpirt atyre. Ai që u shërben njerëzve, i ka shërbyer Allahut të Lartmadhëruar. Ai që i shërben umetit, i ka shërbyer Hazreti Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Na bëftë Allahu nga robërit e tij të dashur, që meritojnë fermanin e shpëtimit nga të çuarit në vend të përgjegjësisë së vëllazërimit, duke reflektuar dhe zbatuar siç duhet dashurinë vëllazërore në çdo çast të kësaj jete kalimtare. Na i mbushtë Zoti zemrat tona me rrezatimet shpirtërore të vëllazërisë islame!

Amin!

Dispozitat e sheriatit islam për institucionin e Zekatit

Ma. sci. Flamur Sofiu

HYRJE

Zekat në kuptimin gjuhësor do të thotë shtim dhe rritje, ndërsa në kuptimin e sheriatit është obligim material që duhet dhënë për pasurinë e zotëruar. Zekati është njëra prej pesë shtyllave dhe obligimeve të fesë Islame. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Dhe jepeni zekatin”**. Kur Pejgamberi (s.a.v.s.), e dërgoi Muadhin në Jemen, i tha: *“Mësoji ata se Allahu ua ka bërë si obligim zekatin, që u merret të pasurve e u jepet të varfërve”*. Të gjithë myslimanët janë të një mendjeje se zekati është obligim-farz dhe të gjithë shokët e të Dërguarit (s.a.v.s.), pajtohen me faktin se duhet luftuar me ata që refuzojnë ta japin zekatin. Mbi këtë bazë, kuptohet qartë se ai që mohon obligueshmërinë e zekatit, ka dalë prej fesë (ka bërë kufër), e nëse refuzon ta japë, atëherë prijësi i myslimanëve do t’ia marrë me dhunë dhe do ta dënojë për shkak të këtij veprimi. Nëse nuk mund t’ia marrë me dhunë, atëherë shteti islam e dënon atë, ashtu siç ka vepruar Ebu Bekri (r.a.), (me ata që kanë refuzuar për ta dhënë zekatin pas vdekjes së të Dërguarit (s.a.v.s.) dhe është shprehur: *“Sikur të mos më japin zekatin që kanë dhënë për kërpeshin e deveve në kohën e të Dërguarit (s.a.v.s.), kam për t’i luftuar ata”*.

POZITA E ZEKATIT NË ISLAM

Zekati konsiderohet si shtylla e tretë në islam, pas shehadetit dhe namazit. Këtë renditje e argumenton hadithi i Pejgamberit (s.a.v.s.), i cili flet për pesë shtyllat e islamit.

Zekati është bërë obligim në vitin e dytë hixhrij, në muajin Sheval.

Obligueshmëria e zekatit vërtetohet me Kuran, Sunet dhe me Ixhma. Ajetet që flasin për obligueshmërinë e zekatit janë të shumta, por ne do të përmendim vetëm disa prej tyre: **“...dhe jepeni zekatin...”, “Merr prej pasurisë së tyre (të atyre që pranuan gabimin) lëmoshë, që t’i pastros**

me të dhe t’u shtosh (të mirat)...”¹

Edhe hadithet që argumentojnë obligueshmërinë e zekatit janë të shumta:

“Islami është ngritur mbi pesë shtylla: Dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit dhe agjërimi i muajit të ramazanit”² Kur Pejgamberi (s.a.v.s.), e ka dërguar Muadh bin Xhebelin (r.a.), për në Jemen, i ka thënë: “Thirri ata që të dëshmojnë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se unë (Muhamedi) jam i dërguari i Zotit. Nëse ata i nënshtrohen kësaj, atëherë tregohu atyre se Allahu ua ka bërë obligim pesë kohët e namazi. Po qe se edhe kësaj i nënshtrohen, atëherë tregohu atyre se Allahu ua ka bërë obligim dhënien e zekatit, i cili merret nga pasanikët dhe u jepet të varfërve.”³

NORMA E ZEKATIT

Zekati është farz (obligim i prerë). Mohuesi i zekatit konsiderohet i dalë nga besimi si mëkatar, ndërsa ai i cili e jep ka shpërblimin e Allahut (xh.sh.).

Dënimi për mosdhënien e zekatit është dy llojesh: dënimi në këtë botë dhe dënimi në botën tjetër (ahiret).

Dënimet për mosdhënien e zekatit në këtë botë janë dënime të caktuara prej Allahut (xh.sh.) dhe prej prijësit të myslimanëve.

Sa i përket dënimet të paraparë prej prijësit mysliman, Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë:

“Kush e jep zekatin me qëllim të shpërblimit, ai do të shpërblehet. Por nëse nuk e jep, ne do t’ia marrim atë dhe një pjesë të pasurisë...”⁴

1. Et-tevbe: 103.

2. Transmeton Buhariu.

3. Transmeton Buhariu, Muslimi dhe Tirmidhiu.

4. En-Nesaiju.

Sa i përket dënimit për në botën tjetër, këtë e vërtetojnë fjalët e Allahut (xh.sh.):

“Ata që bëjnë koprraci me të mirat që u dha Allahu, të mos mendojnë se kjo është në dobi të tyre. Jo, ajo është në dëm të tyre. E mira që kursyen, do t’u mbështillet në qafë në ditën kiametit. Allahut i mbesin trashëgim qiejt dhe toka. Ai di mirë atë që veproni”⁵, “Ata që e kanë arin dhe argjendin e nuk e japin për në rrugën e Allahut, lajmëroji për një dënim të dhembshëm.”⁶

KUSHTET E OBLIGUESHMËRISË SË ZEKATIT

Që zekati të jetë i obliguar, duhet të plotësohen disa kushte, pa të cilat zekati nuk konsiderohet si obligim.

Ato janë:

1. Dhënësi të jetë mysliman.
2. Të jetë në moshën madhore. I mituri dhe e mitura nuk janë të obliguar të japin zekatin⁷.
3. Të jetë i aftë mendërisht. Ai që nuk është i aftë mendërisht, nuk obligohet me dhënien e zekatit.
4. Të jetë i lirë. Personi që nuk e ka statusin e të qenit i lirë, nuk e ka obligim zekatin.
5. Sasia e pasurisë. Çdo lloj pasurie e ka të caktuar sasinë që duhet dhënë zekat. Në shkencën e fikhut, kjo sasi njihet si *nisab*. Nëse pasuria nuk e arrin vlerën e *nisabit*, atëherë zekati nuk obligohet të jepet.
6. Kalimi i një viti duke e pasur nisabin e pasurisë.
7. Zotërim i plotë i pasurisë. Me këtë nënkuptohet që pronari duhet ta ketë pasurinë në duart e tij. Nëse ndodh që ai ka pasuri, por nuk e ka në duart e veta, nuk obligohet ta japë zekatin, deri sa ta ketë në duart e tij.

8. Pasuria të jetë e pastër nga borxhet. Për t'u dhënë zekati, duhet që dhënësi të mos jetë i futur në borxhe, e nëse ka borxhe, nuk obligohet të japë zekatin, por të paguajë borxhin.

9. Pasuria të jetë tepricë dhe të jenë të plotësuar nevojat e domosdoshme të jetës. Pra të ketë shtëpi, rroba, orendi etj.

10. Të jetë pasuri që shtohet, siç mund të jetë lindja e bagëtive apo ari dhe argjendi.

Shënim: Për të qenë i vlefshëm në aspektin juridik islam, kushtëzohet që dhënësi të bëjë nijet (të vendosë) për dhënien e zekatit. Nëse vetëm jep para, por nuk e ka për qëllim dhënien e zekatit, ai nuk e ka kryer obligimin.

PASURITË PËR TË CILAT OBLIGOHET ZEKATI

Zekati në kafshë

Zekati në kafshë nuk jepet, derisa të plotësohen këto kushte:

- a. Të arrijnë nisabin, të cilin e parasheh sheriatu islam, sepse zekati kërkohet vetëm nga të pasurit. Nisabi i zekatit të kafshëve është i ndryshëm, si më poshtë.
- b. Të jenë në kullosë së paku gjashtë muaj e më tepër.

5. Ali Imran: 180

6. Et-Tevbe: 34

7. Të tri medh'ebet e tjera, përveç hanefitëve, janë të mendimit se duhet dhënë zekatin edhe për atë që nuk është i hyrë në moshën madhore dhe për atë që është i çmendur.

Për shtazët që ruhen në stallë nuk jepet zekat. Po ashtu nuk jepet zekat edhe për ato shtazë, të cilat kullosin dhe përdoren për lëvrim, bartje etj. dhe konsiderohen nevoja të jetës së përditshme.

c. Të kalojë një vit. Nisabi duhet të jetë i plotë në fillim dhe në mbarim të vitit.

Zekati i deveve

Nisabi i zekatit të deveve është prej 5-9. Pra, në këtë rast jepet një dele, kurse prej 10-14 jepen dy dele e kështu me radhë.

Zekati i lopëve dhe buallicave

Nisabi i lopëve dhe buallicave është si vijon:

Numri i lopëve dhe buallicave	Sasia e duhur për tu dhënë zekati
30-39	një viç motak
40-59	një viç dyvjeçar
60-69	dy viça motakë
70-79	një viç motak dhe një viç dyvjeçar
80-89	dy viça që i kanë mbushur nga dy vite
90-99	tre viça që kanë mbushur nga një vit

Kur numri i lopëve apo buallicave arrin në 100, atëherë duhet të jepen dy viça që kanë mbushur nga një vit dhe një viç që ka mbushur dy vite. Nga kjo kuptohet se për çdo 30 krerë jepet nga një viç që ka mbushur një vit, kurse për çdo 40 krerë nga një viç që i ka mbushur dy vite. Për 100 lopë apo buallica duhet të jepen zekat dy viça që kanë mbushur nga një vit dhe një viç që i ka mbushur dy vite. Në bazë të këtij rregulli ndryshohet dhënia e viçit në çdo dhjetë lopë apo buallica prej njëvjeçar në dyvjeçar. Për 110 krerë jepet zekat dy viça që kanë mbushur nga dy vite (për çdo 40 lopë një viç dyvjeçar) dhe një viç njëvjeçar (për 30 lopë të mbetura).

Zekati i deleve dhe dhive

Nisabi i zekatit të deleve dhe dhive fillon prej 40 e më tepër. Ky nisab është si vijon:

Numri i deleve dhe dhive	Sasia e duhur për tu dhënë zekati
40-120	një dele
121-200	dy dele
201-399	tri dele
400	katër dele

Kur numri i deleve arrin në 400, atëherë në çdo 100 dele jepet zekat një dele. Pra për 500 dele jepen 5 dele, për 600 dele jepen 6 dele e kështu më radhë.

Delja që do të jepet zekat duhet ta ketë mbushur një vit.

Zekati i kafshëve të imëta

(i vogli i devesë, viçat, qengjat, kecat etj)

Për kafshët e imëta nuk duhet dhënë zekat e, po qe se janë të përziera me kafshët e mëdha, atëherë zekati jepet për të gjitha. Edhe nëse ndodh që në mesin e kafshëve të vogla është e përzier vetëm një e madhe, duhet dhënë zekat. Kur ndodh që shumica janë qengja e pakica janë dele, duhet dhënë zekat delen, edhe nëse në mesin e qengjave është vetëm një dele.

Zekati në kafshët që janë pronë e ortakëve

Zekati në kafshët që janë pronë e përbashkët nuk jepet, derisa pjesa e secilit prej ortakëve ta arrijë nisabin. Kështu, nëse dy ortakë kanë 50 lopë, nuk duhet të japin zekat, sepse kanë nga 25 krerë. E nëse arrijnë të kenë 60 lopë, atëherë duhet dhënë zekat.

Zekati në ar dhe argjend

Sipas unanimitetit të të gjithë dijetarëve islamë, duhet dhënë zekat për ar dhe argjend.

Nisabi i arit është 20 mithkal-dinar ose përafërsisht prej 85⁸ gramë e më tepër, në çfarëdo qofshin ato, monedha, ar, unaza, relike, bylyzykë, lugë, pirunë etj. Në këtë rast jemi të detyruar të japin 2.5% ose 1/40 e pasurisë. Kjo vlerë mund të paguhet në ar, por edhe në vlerën e tij. Ai që ka më pak se sa nisabi, nuk obligohet të japë zekat. Pra, nëse dikush ka 65 gramë ar, ky nuk duhet të japë zekat.

Nisabi i argjendit është 200 dërhëm, që është e barabartë me 700 gr. Ai që e ka këtë sasi të argjendit, është i obliguar të japë zekat.

Shënim:

Nëse dikush zotëron ar dhe argjend, shumica e të cilëve arrin vlerën e nisabit, duhet të japë zekat në vlerën 2.5%. Ndërsa kur ndodh që ari dhe argjendi të jenë të përzier me ndonjë xehe tjetër, atëherë duhet shikuar raportin e përbërjes së tyre në krahasim me xehe tjetër. Kur ky raport tregon se përbërja e arit dhe e argjendit është më e madhe, në këtë rast duhet llogaritur sikur i tëri të jetë ar apo argjend. Nëse xehja ka përbërje më tepër se sa ar dhe argjend, në këtë rast ari dhe argjendi llogariten si mall i tregtisë, dhe vlerësohen si të tillë. Nëse jepet zekati në ar dhe argjend me monedhë të vendit, atëherë duhet të konsultohet kursi i arit dhe argjendit dhe të jepet zekati në vlerë të 2.5%. E kur ndodh që të jepet zekati prej vetë arit apo argjendit, atëherë nuk duhet konsultuar kursi i arit apo argjendit, por duhet të jepet 2.5% nga sasia e tyre.

Zekati në stoli

Zekati për stoli duhet dhënë doemos⁹, qoftë stoli për

8. Shumica e dijetarëve janë të mendimit se sasia e arit për të cilin duhet dhënë zekat është 85 gram, kurse hanefitët janë të mendimit se është prej 91-100 gr.

9. Disa nga dijetarët e medh'hebeve mendojnë se nuk është e domosdoshme dhënia e zekatit për stoli. Po ashtu ekziston edhe mendimi se, nëse femra e përdor arin për stolisje nuk jep zekat, por nëse e ruan të deponuar, atëherë duhet dhënë zekat.

femra apo për meshkuj¹⁰, edhe pse për meshkuj stolia me ar është e ndaluar.

Zekati në bankënota

Nisabi i parave-bankënotave duhet të llogaritet në ar apo argjend. Nëse bankënotat e arrijnë vlerën e 85 gramë të arit apo vlerën e 700 gramë të argjendit, duhet dhënë zekat 2.5% e vlerës së tyre.

Disa nga dijetarët mendojnë që nisabi i bankënotave të vlerësohet me ar e jo me argjend, për arsye se në kohën e sotme nisabi i argjendit është më i ulët. Mirëpo një pjesë e madhe e dijetarëve bashkëkohorë janë të mendimit që nisabi i bankënotave të vlerësohet me argjend e jo me ar, duke menduar se kjo është në interes të të varfërve, për shkak se, nëse vlerësohet në argjend më shumë veta duhet të japin zekat¹¹.

Që zekati të jetë obligim për para-bankënota, duhet të plotësohen këto kushte:

1. Nisabi të jetë i pastër nga borxhi
2. Të kalojë një vit.
3. Nisabi të jetë mbi nevojat e domosdoshme.
4. Paratë duhet të arrijnë nisabin e duhur.

Shënim:

Pronari i parave të depozituara në bankë apo të ruajtura në shtëpi është i detyruar të japë zekat.

Zekati në mall tregtie

Pasuria me të cilën tregtari bën tregti duhet dhënë zekat. Ajo mund të jetë e ndryshme, si rroba, ushqime, makina, ndërtesa etj. Për të gjitha këto duhet të jepet zekat, duke u plotësuar këto kushte:

1. Pasuria me të cilën bëhet tregti të arrijë vlerën e nisabit.
2. Të kalojë një vit prej fillimit të asaj tregtie.
3. Në momentin e blerjes së pasurisë pronari të bëjë *nijet* që ajo pasuri të jetë për tregti.

Zekati për mall tregtie jepet 2.5% në fitimin e pastër.

Shënim:

Nëse dikush e ka blerë një mjet që ta përdorë për nevojat personale e jo për tregti, por më vonë vendos ta shesë, kjo pasuri nuk konsiderohet mall tregtie dhe për të nuk jepet zekat. Por kur dikush e blen një mjet për tregti, por e përdor edhe për punë personale, ky konsiderohet mall tregtie dhe duhet dhënë zekati, nëse ky mall i plotëson kushtet e duhura. Në zekat nuk hyjnë mobiljet, mjetet e ndryshme, frigoriferët, depoja, veglat e punës e të ngjashme, sado që të kushtojnë ato, nëse ato nuk janë mall tregtie.

10. Stolia dhe zbulurimi i meshkujve me ar është i ndaluar në fenë islame.

11. Unë përkrah mendimin e parë, për arsye se, nëse e vlerësojmë në argjend atëherë është vështirë të gjendet njeri që e meriton zekatin. Po ashtu jam i mendimit që vlerësimi i bankënotave të bëhet duke u vlerësuar në interesin e atyre që e marrin zekatin.

Fitimi i arritur gjatë vitit i bashkëngjitet vlerës së përgjithshme të pasurisë dhe zekati jepet për gjithë pasurinë.

Pronari i pasurisë duhet ta vlerësojë pasurinë prej momentit kur i bëhet obligim e jo prej kohës kur e ka blerë..

Zekati i frutave dhe i të mbjellave

Zekati për fruta dhe të mbjella jepet menjëherë mbas të vjelave dhe korrjeve, sado që të jetë sasia e tyre.

Kur tokat ujitet me ujë dhe shiut ose të lumit, zekati për atë prodhim jepet 10% e, në qoftë se toka ujitet në mënyrë artificiale atëherë duhet dhënë zekat 5%.

Dhënia e zekatit për fruta dhe të mbjella duhet të plotësojë disa kushte, përveç kushteve të përgjithshme të zekatit:

1. Që nga toka të këtë rendimente-prodhime. Nëse toka nuk jep prodhime, atëherë pronari saj nuk obligohet me dhënien e zekatit, sepse obligim është dhënia e një pjese nga rendimentet e prodhuara.

2. Që toka të mbillet më qëllim shfrytëzimi dhe prodhimi. Nga kjo kuptohet qartë se gjithçka që mbin vetvetiu nga toka duke mos e mbjellë, nuk jepet zekat, si bari, drunjtë etj.

3. Që toka të mos jetë e tatuuar. ¹²Kur për tokën jepet tatim, atëherë nuk jepet zekat.

Nisabi i të mbjellave dhe frutave

Ebu Hanife (r.a.), mendon se nuk ka *nisab* të caktuar për fruta dhe të mbjella, por duhet dhënë 10 % për ato prodhime të tokës që ujitet nga lumenjtë dhe uji i shiut, ndërsa 5 % për ato që ujitet artificialisht, qoftë ajo sasi e pakët apo e shumë.

Dy nxënësit e Ebu Hanifes (r.a.), imam Ebu Jusufi (r.a.) dhe Muhamedi (r.a.), janë të mendimit se *nisabi* është kusht për dhënien e zekatit në prodhimet bujqësore që kanë mundësi të mos prishen brenda një viti. Sipas tyre, zekati i këtyre të mbjellave dhe frutave është 5 *vesk*, që është e barabartë me 652.8 kg.

Zekati i tokës së dhënë me qira

Ebu Hanife (r.a.), është i mendimit se pronari i tokës së dhënë me qira duhet të japë zekatin e prodhimeve të tokës, ndërsa dy nxënësit Ebu Jusufi (r.a.) dhe Muhamedi (r.a.), janë të mendimit se zekatin duhet ta japë personi, i cili e ka marrë tokën me qira e jo pronari i tokës.

Zekati i mjaltit

Hanefitët janë të mendimit se për mjaltë duhet dhënë zekat 10%, por me kusht që mjalti të jetë kultivuar nga toka për të cilën jepet zekat. Nëse është kultivuar nga toka e tatuuar, nuk jepet zekat. Për nisabin e mjaltit, dijetarët hanefitë ndajnë këto mendime:

1. Ebu Hanife (r.a.), është i mendimit se duhet dhënë 10% e sasisë së mjaltit.

2. Imam Ebu Jusufi (r.a.), mendon se sasia për të cilën duhet dhënë zekat është 653 kg.

Zekati për apartamente, fabrika dhe shtëpi me qera

Zekati merret nga ajka e pasurisë dhe produkti i saj për çdo vit, siç merret për mallrat tregtare, në vlerën 2.5%. Po

12. Sipas mendimit të hanefitëve, nëse toka tatóhet, për të nuk duhet dhënë zekat, ndërsa tri medh'hebet e tjera janë të mendimit se duhet dhënë.

*"O ju që keni besuar!
Jepni nga më e mira e saj
dhe nga ajo që nxjerrim ne
për ju nga toka..."*



ashtu zekati merret vetëm nga prodhimi, por duke mos u kushtëzuar kalimi i vitit. Kjo vlen për prodhimet bujqësore në vlerën 5% dhe 10%.

Për zekatin e apartamenteve, fabrikave e të ngjashme, dijetarët ndajnë mendimet e tyre. Mendimi më bashkëkohor është që zekati të jepet vetëm për prodhimin e nxjerrë, duke bërë analogji me zekatin e të mbjellave dhe frutave.

Zekati në pasurinë e fshehur në tokë

Me shprehjen *كُفْرًا*, në kuptimin terminologjik, nënkup-tohet pasuria që është xehe dhe ajo që ka fshehur njeriu. Si pasuri nëntokësore konsiderohet hekuri, bakri, nafta etj. Ndërsa pasuri e fshehur është ari apo argjendi.

Pasurisë së gjetur në tokë i jepet zekati 20 % nga pasuria e gjetur, qoftë ajo pasuri e pakët apo e shumë. Për këtë lloj të pasurisë nuk kushtëzohet kalimi i një viti, por duhet dhënë menjëherë, pasi të jetë gjetur. Ky rregull vlen për pasurinë që kanë fshehur jomyslimanët, ku vërehen shenjat dhe simbolet joislame. Nëse ndodh që të gjendet ndonjë pasuri me simbole islame, atëherë për këtë lloj të pasurisë zbatohen dispozitat e sheriatit që kanë të bëjnë me gjënë e gjetur.¹³

Zekati i xeheve

Hanefitët i ndajnë xehe nëntokësore në tri grupe:

1. Pasuri e ngurtë, që përpunohet, si ari, argjendi, bakri, hekuri, plumbi e të ngjashme. Për këto lloje xehe, zekati jepet 1/5, qoftë pak apo shumë ajo pasuri, qoftë mysliman apo *dhimijj*¹⁴ ai që e ka nxjerrë atë dhe nuk kushtëzohet që të kalojë një vit. Për këtë, ajeti kuranor argumenton:

*"O ju që keni besuar! Jepni nga më e mira e saj dhe nga ajo që nxjerrim ne për ju nga toka..."*¹⁵

2. Pasuri e ngurtë që nuk shkrihet, si thëngjilli, zinku, gipsi, gëlqerja etj. Nëse këto xehe nuk nxirren për tregti, nuk duhet të jepet zekat. Po u nxorën për tregti, atëherë duhet dhënë zekat 2.5 %, duke u konsideruar si mall tregtie.

3. Xeheja, e cila është në gjendje të lëngët dhe nuk mund të ngurtësohet, si nafta, gazi etj. Nëse këto xehe nuk përdoren për tregti, nuk duhet dhënë zekat e, nëse përdoren për tregti, atëherë duhen konsideruar si mall tregtie dhe duhet dhënë zekat 2.5%.

13. Hanefitë janë të mendimit se, nëse pasuria e gjetur është me simbole islame, atëherë në fillim duhet të lajmërohet, të reklamohet dhe të ruhet një vit. Pasi të kalojë një vit, lejohet që personi ta shfrytëzojë atë. Ai që e gjen këtë pasuri, ka mundësi ta japë sadaka ose ta shfrytëzojë për nevojat e veta personale. Nëse e ka dhënë sadaka ose e ka përdorur dhe shfrytëzuar e pastaj është paraqitur pronari i saj, atëherë mbetet çështja në duart të pronarit. Ky i fundit vendos ta falë atë pasuri si sadaka ose kërkon kompensimin e pasurisë nga ai që e ka gjetur.

14. Dhimij është ai person jomysliman që jeton në shtetin islam.

15. El-Bekaretu: 267.

Psikoanaliza dhe feja, një qasje psikologjike

Nuredin Nazarko

Si psikoanaliza, ashtu edhe feja shqetësim kryesor kanë njeriun, madje pa njeriun as që do të kishin kuptim. Njeriu, si pikëbashkim mes psikoanalizës dhe fesë, nuk na jep të kuptojmë se domosdoshmërisht pikëbashkimi është provë e ngjashmërisë mes dy sistemeve, edhe pse mund të përngjasojnë së jashtmi. Dallimi thelbësor qëndron në mënyrën si i qasen njeriut, psikoanaliza nga njëra anë dhe feja nga ana tjetër. Varësisht nga mënyra e qasjes mund të kuptojmë konsideratën e tyre respektive për njeriun. Jo vetëm për tematikën në fjalë, është e rëndësishme, madje shumë e rëndësishme të dimë se çfarë kuptojmë me fe, pasi ekzistojnë disa fe monoteiste apo politeiste. Megjithë ngjashmëritë që shpërfaqin, fetë kanë dallime qenësore, thelbësore në konceptin e rrugës që duhet të ndjekë njeriu drejt rikthimit të përjetshëm dhe takimit me Qenien. Edhe pse Fromm-i shprehet se *“...me fe, unë kuptoj çfarëdo sistemi pikëpamjesh dhe veprimesh, të cilit i përmbahet ndonjë grup njerëzish dhe i cili i jep individit sistemin e orientimit dhe objektin e adhurimit.”*, duke synuar një përcaktim më gjithëpërfshirës, nuk e tejkalon kuptimin e fesë përtej krishtërit.

Në këtë trajtesë, me fe do të kuptojmë sistemin e të jetuarit që respekton dikotominë njerëzore, nuk i kundërvihet kësaj dikotomie në jetësimin e parimeve të epërme, duke i zbuluar njeriut shenjat që do ta orientojnë drejt Qenies së Zotit.

Monoteizmi nuk mund t'i ofrojë subjektit njerëzor objekt adhurimi, edhe pse njeriu shpeshherë jo vetëm kërkon, por edhe realizon objekte adhurimi ose i gjen në natyrë. Monoteizmi është i pakompromis, cilado qoftë dëshira e njeriut. Monoteizmi është i qartë dhe i

prerë se asgjësend nuk adhurohet, përveç Qenies. Do të ishte e papranueshme për logjikën e monoteizmit, madje blasfemi, që Qenien ta ofronte si objekt adhurimi. Qenia është ajo që është dhe adhurohet ashtu siç është në qenien e vet, pasi për subjektin njerëzor është absolutisht e pamundur të perceptojë Qenien. Duke përfshirë objektin e adhurimit, Fromm-i i referohet krishtërit pavalian, ku njeriut i ofrohet objekti i adhurimit, njeriu-zot apo zoti-njeri që perceptohet, preket dhe para të cilit përulohet për adhurim. Por çfarë është adhurimi? Adhurimi nuk është ndonjë sistem i ndërlikuar ritualesh që pakkush mund t'i kuptojë, që pakkush mund t'i praktikojë. Në konceptin e ngushtë të adhurimit, adhurim konsiderohen rituale të caktuara me rend kryerjeje të përcaktuar që realizohen në objekte të caktuara ose jo për adhurim. Adhurimi është fjalë dhe veprim, që na shërben si provë vërtetësie për fjalën. Në konceptin e gjerë të adhurimit, që përfshin edhe konceptin e ngushtë të tij, adhurimi përcaktohet si dashuri e plotë me nënshtrim të plotë. Adhurimi si fjalë dhe veprim buron nga dashuria e plotë me nënshtrim (frikë dhe shpresë), të plotë ndaj të adhuruarit. Njeriu, besimtar ose jo, politeist apo monoteist, jeton në adhurim, paçka se mund ta mendojë adhurimin vetëm si kryerje të ritualeve fetare të caktuara dhe, përderisa nuk kryen ndonjë ritual të kësaj natyre, nuk adhuron. Njeriu nuk mund të zgjedhë të adhurojë ose jo, ai mund të zgjedhë të adhurojë Qenien apo krijesa të tjera, si kulti i të parëve, kulti i udhëheqësit, shenjtori, totemi, uni, paraja etj. Adhurimi nuk do të mund të ishte i tillë në cilësinë e tij, pa praninë e zemrës, së cilës filozofia perëndimore i ka adresuar harresën, duke shenjtëruar arsyen, logjikën që e sheh të buri-muar nga truri dhe jo zemra. Adhurimi pa praninë e zemrës është tërësisht formal, i pashpirt. Adhurimi është fokusi dhe zemra, epiqendra, prej nga valët e

1. Fromm, E, "Psikoanaliza dhe feja", Tiranë, 2002, fq. 27

përjetimit të adhurimit shpërhapen në tërë qenien e njeriut, duke pushtuar çdo qelizë të tij.

Por në ç'mënyrë i qaset njeriut psikoanaliza? Psikoanaliza i qaset njeriut sipas parimit "e vërteta (jo si zbulësë, N.N), të bën ty të lirë"², duke synuar çlirimin e unit njerëzor nga ndrydhja, shtypja, nënshtrimi. Përderisa trajton çrregullimet, disfunkcionet mentale të përcaktuara si neuroza, psikoanaliza rrëmon për të gjetur rrënjët e neurozës, me qëllim që të përcaktojë mënyrat e trajtimit të pacientit, jo vetëm për të eliminuar simptomat, por vetë neurozën, sepse simptomat janë vetëm shfaqje, zilja e alarmit të neurozës që po përjeton pacienti. Edhe pse është e vështirë të përcaktosh saktësisht se ky apo ai çrregullim neurotik ka këtë apo atë origjinë, Frojdi thekson se "kompleksi i Edipit është bërthama e çfarëdo neuroze."³ Ndrydhja që pëson kompleksi i Edipit, dëshirat, instiktet tek njeriu, nga frika e ndëshkimit atëror, veçanërisht në 5 vitet e para të jetës, është përcaktuese për atë se si do të zhvillohet personaliteti i njeriut në të ardhmen. Ndrydhja ndodh edhe kur njeriu maturohet, por më e rëndësishmja është ajo që ndodh në fëmijërinë e hershme. Frojdi në studimet e tij mbi çrregullimet neurotike, përfshiu konceptin e së pandërgjegjshmes që shfaqet si rezultat i ndrydhjes. Për Frojdin, instiktet e ndrydhura nuk

zhduken nga njeriu, nga karakteri i tij, por ato enden në një sferë të papërcaktuar të psikikës njerëzore, duke u rifshaqur me forcë tek njeriu, pas periudhës së latencës seksuale, për t'u bërë përcaktuese në orientimin jetësor të njeriut.⁴ Në momentin që njeriu shfaq simptoma të neurozës, duhet t'i drejtohet psikoanalistit si pacient. Shtypja, ndrydhja e pulsioneve seksuale dhe mosçlirimi i tyre, prodhon çrregullime mendore që mund të dëmtojnë seriozisht shëndetin dhe aftësitë e njeriut. Pulsionet nuk duhen ndrydhur nga normat morale, por duhen shprehur, që njeriu të mos e ndiejë peshën tmerruese të ndrydhjes së unit, nga frika e ndëshkimit, prej të shprehurit të pulsioneve. Gjatë kurimit psikoanalitik ku "duhet analizuar karakteri i njeriut dhe të ndihmohet ai në procesin e

riorientimit të karakterit të tij"⁵, moment i rëndësishëm është rrëfimi i pacientit për të kaluarën e tij, nën gjendjen e hipnozës. Rrëfimi, që edhe krishtërimi e përmban rrëfimin para priftit për faljen e mëkateve dhe çlirimin e njeriut nga pesha e fajit, shërben për ndërtimin jo vetëm të fenomenologjisë së neurozës, por shërben edhe si çlirim i pacientit nga pesha tmerruese e të vërtetave në brendinë e personalitetit të tij, të fshehura në thellësitë e shpirtit dhe zemrës së tij. Nuk ndërmendim për të vërtetën si zbulësë, por për veprimet e kryera nga pacienti nën peshën e ndrydhjes së pulsioneve, që për një arsye apo për një mori arsyesh, asnjëherë nuk i ka rrëfyer askujt. Rrëfimi nën hipnozë e çliron pacientin nga pesha e frikës së ndëshkimit atëror, nga pesha e paragjyqimeve dhe presioni psikologjik i opinionit publik, duke përjetuar lirinë e brendshme për shprehjen e të vërtetave të shpirtit të tij. "Në të vërtetë, të ndihmohet njeriu që të ndajë të vërtetën nga gënjeshtria në vetvete – ja qëllimi kryesor i psikoanalizës, i metodës terapeutike,

e cila paraqet në vetvete mishërimin empirik të tezës "E vërteta ju bën juve të lirë."⁶ Duke iu përmbajtur parimit se në gjenezë të neurozave është ndrydhja e pulsioneve seksuale, kurimi psikoanalitik synon të bindë pacientin që, jo thjesht të ndajë anët pozitive nga anët negative të karakterit të tij, por edhe ta pranojë vetveten ashtu siç

është, ta bindë se shkeljet morale, mëkatet, nuk janë mëkate, se të tilla i përcakton feja, edhe kjo një neurozë, por sjellje tërësisht normale në bazë të të cilave reagon një shtazë e evoluar. Duke përfshirë në kufijtë e normales atë për të cilën feja e përcakton si shkelje, mëkat, psikoanalisti, nëpërmjet rrëfimit, mendon të çlirojë pacientin nga ndjenja e të qenit në faj, nga ndjenja e turpit, më gjerë akoma, nga pesha e moralitetit që ndrydh pulsionet seksuale. Psikoanalisti synon të shkërmoqë besimin e pacientit se shkelja e moralit është mëkat, përderisa optika frojdiane e konsideron paqëndrueshmërinë e moralitetit fetar si një prej fatkeqësive të fesë për njeriun. Në momentin kur njeriu shkel parimet morale, duke mos ndrydhur pulsionet, e duke besuar se është sjellje tërësisht "normal", në shkërbimin e parimit të të qenit shtazë e evoluar, nuk e ndjen më peshën e fajit dhe të thyerësit të pa-



2. Ibid., fq. 14

3. Ibid., fq. 75

4. Më gjerësisht shih përshkrimin e neurozës tek "Moisiu dhe feja m - noteiste", Frojd, Z, fq. 114-117, Tiranë 2005.

5. Fromm, E, "Psikoanaliza dhe feja", Tiranë 2002, fq. 64

6. Ibid., fq. 75

rimeve morale. Tashmë, përjeton ndjesitë e të qenit “i lirë”, “i pavarur”, “i sigurtë”, në përmbushjen e unit të vet, në pabindshmëri ndaj parimeve morale. Psikoanaliza qëmton skutat e personalitetit njerëzor, për të normalizuar neurozën, por ky normalitet ku pacienti duhet të zhvendoset, nuk mund t’i shpëtojë impaktit të gjykimit të psikoanalistit që është i varur kryekëput nga “filozofia dhe sistemi i tij i vlerave.”⁷ Duke synuar nëpërmjet fenomenologjisë së neurozës, të hetojë shkaqet dhe mënyrat e duhura, sipas saj, të kurimit, psikoanaliza përafrohet me fenë, në sensin e normalizimit të njeriut, ekuilibrit të tij, edhe pse trajektorja e gjykimit të fesë mbi njeriun lëviz mes skajeve, “njerëz jemi” dhe “njerëz duhet të jemi”, pra mes faktit dhe qëllimit të synuar të njeriut si njeri. Vërtet psikoanaliza kërkon të shërojë shpirtin njerëzor, që njeriu të ndihet i lirë së brendshmi, por mënyra se si psikoanaliza synon çlirimin e njeriut nga neuroza, ndryshon tërësisht nga mënyra se si feja synon ekuilibrimin e njeriut. Në qendër të vëmendjes feja ka vendosur raportet mes njeriut dhe Qenies së Zotit, si duhet të reagojë njeriu në rrugëtimin drejt Zotit, çfarë duhet të përmbushë për të jetuar në paqe me unin, shoqërinë, Zotin. Fromm-i sheh si të rëndësishëm kuptimin e dallimit “midis feve autoritare dhe humaniste”⁸. Sipas Fromm-it, feja autoritare ka në thelb “nënshtrimin, nderimin, adhurimin”⁹

ndaj forcës më të lartë, Zotit që përmes gjithpushtetshmërisë, kontrollon njeriun duke pasur pushtetin mbi të, kontrollon njeriun madje edhe duke e detyruar që ta adhurojë. “Feja autoritare nxjerr ideale kaq abstrakte dhe të largëta, sa ato zor të kenë ndonjë lidhje me jetën reale dhe të njerëzve realë. Ideale të tillë, si “jeta pas vdekjes”, apo “e ardhmja e njerëzimit”, mund të sakrifikojnë jetën dhe lumturinë e njerëzve, që jetojnë këtu dhe tani.”¹⁰ Feja humaniste nuk përqendrohet tek autoriteti, pushteti, kontrolli, por “është e përqendruar në jetën e njeriut dhe aftësitë e tij”¹¹. Feja humaniste në këtë kontekst synon të ndërrojë gjësojë njeriun, për vendin dhe pozitën e tij në botë. Njeriu duhet të kuptojë të vërtetat mbi qenien e tij, mbi kufizueshmërinë e tij dhe të përpiqet të realizojë

7. Ibid., fq. 67

8. Ibid., fq. 38

9. Ibid., fq. 38

10. Ibid., fq. 40

11. Ibid., fq. 40

vetitë më të mira dhe më të arrira, në themel të të cilave qëndron dashuria. Ai duhet t’i japë kuptim ekzistencës së tij mbi botë. Feja autoritare dallon nga feja humaniste. Ja se si e përshkruan Fromm-i dallimin që konsiston në mënyrën se si i qasen këto fe njeriut: “Si qëllim i njeriut, në fenë humaniste, është arritja e fuqisë më të madhe, por jo e pafuqisë më të madhe, si virtyt është vetërealizimi dhe jo nënshtrimi. Besimi paraqet në vetvete bindjen e vendosur, të bazuar në përvojën individuale të arsytimeve dhe të ndjenjave dhe jo në pranimin e gjykimeve të ndonjë autoriteti. Si gjendje shpirtërore ekzistuese është gëzimi, në një kohë që si gjendje shpirtërore e fesë autoritare zakonisht ndodh që të jetë dëshpërimi dhe ndjenja e fajit.”¹² Kjo lloj ndarje në të vërtetë ekziston, por autoritarja përfundon në kufijtë e judaizmit, ku theksohet me tepër bindja e nënshtrimi ndaj ligjit të Zotit, qoftë edhe përmes detyrimit dhe frikës. Humanistja përfundon në kufijtë e krishtëritimit dhe, jo se nuk kërkon bindjen ndaj ligjit të Zotit, por këtë e realizon, jo përmes forcës, por përmes dashurisë, mëshirës, përdëllimit, faljes, vetërealizimit etj., për realizimin e parajsës në përtejbotë. Orientimi tërësor i njeriut drejt njërit apo tjetrit krahas, sjell disharmoninë e dikotomisë njerëzore. Aspekti autoritarist do ta bëjë më të bindur, më të nënshtruar dhe gjithmonë në gjendjen e frikës dhe të pashpresës, i gatshëm për përmbysje, pamëshirshmëri, luftë deri në realizimin e parajsës këtu dhe tani. Aspekti humanist do t’i ofrojë vetërealizimin, përmes ndër-gjegjësimit dhe vlerave të tjera si dashuria, mëshira, falja, etj., por nuk do t’i ofrojë kuadrin ligjor që do t’i shenjojë kufijtë që duhet të respektojë në zbatimin e ligjit të Zotit. Njeriu është krijuar sipas shembëlltyrës së Zotit dhe sipas kësaj devize biblike, në procesin e vetërealizimit si qenie njerëzore, njeriu synon përsosmërinë, sepse e tillë është shembëlltyra prej nga u krijua. Përpjekja e njeriut për përsosmëri, pra për barazi me Zotin, ngjalli xhelozinë, inatin, zilinë, shqetësimin e Zotit të Gjithpushtetshëm ndaj krijesës që synon pozitën e Tij dhe pikërisht këtu e ka burimin motivi i premtimit të Tij, për shfarosjen e racës njerëzore, duke u ndier i penduar për atë çfarë kishte krijuar.¹³ Njeriu u bind që nuk mund të bëhej si Zoti,

12. Ibid., fq. 40

13. Më gjerësisht shih Fromm, E, “Psikoanaliza dhe feja”, fq. 44 – 47

sepse Zoti kishte pushtetin dhe kontrollin mbi të dhe mund ta shfaroste kur të dëshironte. Për të realizuar synimin e tij, përsosmërinë, njeriu shpalli vdekjen e Zotit, tepër njerëzor me përshkrimin e mësipërm dhe në këtë mënyrë, iu hap rruga për marrjen në dorë të kompetencave të Zotit dhe ushtrimit të pushtetit si të ishte zot. Për psikoanalistin, kjo është një situatë tërësisht normale, sepse njeriu po ribën aktin e të parëve të tij, ku eliminohet ati patriarkal, dhe zëvendësohet nga pasardhësit në drejtimin e klanit, fisit. Zoti biblik, i dobët, i thyeshëm, i paditur, frikacak edhe kur ka pushtetin, më shumë se sa Zotin përshkruan njeriun që synon të bëhet zot.

Bazuar mbi konceptin e fesë, që parashtruar për këtë trajtesë, Zoti është Qenie absolute me emra dhe cilësi, me anë të të cilëve njeriu i drejtohet Zotit në adhurimin ndaj Tij. Qenia e Zotit as që mund të perceptohet nga njeriu, edhe pse dëshira për shikimin e Zotit është relevante. Kërkesa e Moisiut drejtuar drejtpërdrejt Zotit për ta parë, ishte shprehje e qartë e dëshirës së madhe të njeriut për të parë Krijuesin e tij. Mosrezistimi për të parë dhe një pjesë të vogël të dritës së Qenies, ishte provë e pamundësisë dhe kufizueshmërisë së njeriut për t'i rezistuar madhësisë së Qenies. E si ka mundësi që Zoti të shqetësohet se njeriu do t'i marrë pushtetin?! Zoti e krijoi njeriun e parë pa kurrfarë modeli të mëparshëm dhe, bashkë me gruan e tij, i vendosi në parajsë, në kopshtin e Edenit. Zoti i urdhëroi që vetëm një pemë të mos i afroheshin, duke i paralajmëruar që të tregonin kujdes ndaj djallit, sepse ai ishte armiku i njeriut që kishte si qëllim çuarjen e tij në mosbindje ndaj Zotit. Kjo ishte prova e parë e njeriut, për bindjen ndaj urdhrave të Zotit. Çifti njerëzor, i joshur nga djalli me premtimin se konsumimi i pemës do t'i bënte ata të përjetshëm dhe të pushtetshëm, zgjati dorën drejt pemës së ndaluar. Konsumimi i pemës rrëzoi perden e realitetit të supozuar përmes propagandës së djallit. Njeriut iu bë e qartë njëherë e përgjithmonë e vërteta e përjetshme se ishte vetëm një njeri dhe, si i tillë, kurrë nuk mund të barazohej me Zotin dhe se do të kishte gjithmonë nevojë për ndihmën dhe përkujdesjen e Zotit. Zgjatja e dorës drejt së ndaluarës, tregoi se mosbindja u bë pjesë e pandarë e njeriut dhe forca e dëshirave mund ta



mposhtë njeriun, edhe pse i njeh kufijtë e përcaktuar nga Qenia. Zoti e zbriti çiftin njerëzor në Tokë, duke i përcaktuar vdekjen, si fundin e fillimit të pafundëm, për kthimin në shtëpinë e humbur nga mosbindja. Zbritja e njeriut në tokë nuk do të thoshte braktisje, hedhje dhe lënie në harresë e njeriut. Zbritja ishte mundësia e humbur e njeriut për të qenë në fqinjësi të Zotit, por edhe mundësia që nëpërmjet jetësimit të parimeve të epërme, të fitonte atë çfarë kishte humbur. Zbritja në tokë, pranimi i pendimit, falja, zbritja e zbulesës nga Zoti për t'i rrëfyer njeriut shenjat që duheshin ndjekur në rrugën e kthimit, ishin shprehje e mëshirshmërisë dhe përkujdesjes së Zotit ndaj njeriut dhe jo shprehje e forcës ndëshkuese të Tij, edhe pse nën pushtetin e Tij ndodhet gjithësa ekziston. Zoti i qartësoi njeriut përmes zbulesës, sistemin e të jetuarit, ku çdo fjalë dhe veprim i njeriut, shndërrohet në adhurim ndaj Zotit, Një dhe të Vetëm; adhurim me dashuri, frikë, shpresë, në themel të të cilit qëndron zemra e sinqertë. Njeriu si njeri, është i predispozuar të shkelë

kufijtë e vendosur. Në momentin e shkeljes, të bërit mëkat, njeriu ligëshohet, ndjen keqardhje dhe vetëdijësohet për nevojën që ka për Zotin, për krijuesin e Tij, për faljen dhe mëshirën e Tij. Kjo nuk do të thotë se, meqënëse njeriu qenka i nënshtruar ndaj Zotit në çdo aspekt, pengohet vetë-realizimi i njeriut në jetë, si rezultat i trysnisë së frikës

nga ndëshkimi i Zotit. Ndëshkimi hyn në lojë atëherë kur njeriu ende nuk është vetëdijësuar mbi atë se çfarë duhet të respektojë. Ndëshkimi luan rol edukativ edhe mbi pjesën tjetër të njerëzve, që mendojnë të shkelin kufijtë. Ndëshkimi nuk është shfaqje e forcës së Zotit ndaj njeriut, por shfaqje e mëshirës së Tij, që të mos molepset nga dekadencia dhe shpërfytyrimi i të qenit njeri si personalitet dhe si anëtar i shoqërisë. Keqardhja, pendesa për shkeljen e kryer, e afron njeriun drejt Zotit me të gjithë qenien e vet, duke kërkuar faljen, mëshirën dhe shpëtimin vetëm prej Zotit. Duke ndjerë praninë e Qenies së Zotit, njeriu gjen forcën mbështetëse në hapërimin e realizimit të vlerave dhe parimeve të epërme, që i japin statusin e të qenit njeri, statusin e të qenit kandidat për fitimin e parajsës në përtejbotë. Njeriu nuk ka nevojë të rrëfehët para priftit, psikoanalistit, për shkeljet, mëkatet e tij, prirjet e tij, edhe pse për problemet e përditshme mund të konsultohet me çdokënd që e sheh të arsyeshme, që të

ndihet i çliruar nga pesha e fajit. Njeriu rrëfhet vetëm përpara Zotit, pa ndërmjetësinë e askujt, me besimin se nuk është i harruar e i braktisur, me besimin se Ai fal, mëshiron. Ky rrëfim në fshehtësi dhe me përlulje, është nderim për njeriun, sepse gjithmonë do të gjejë një derë hapur, ku zëri i tij, ku pëshpërimita e shpirtit të tij do të dëgjohet nga Ai që sundon gjithçka dhe ka pushtetin mbi gjithçka. A thua vallë të ketë lumturi më të madhe për njeriun, vlerësim më të madh për qenien njerëzore se sa zëri i tij të dëgjohet në respekt të plotë dhe pa frikën e përcmimit, fyerjes, ofendimit për shkak të mëkatit, nga Zoti i Gjithfëuqishëm dhe i Gjithëpushtetshëm?

Njeriu nuk mundet të zgjedhë apo të mos zgjedhë, sepse edhe atëherë kur mendon se ka vendosur të mos zgjedhë, ka realizuar një zgjedhje. Me siguri që njeriu do të zgjedhë sistemin e orientimit, sistemin e të jetuarit, në bazë të të cilit ngre dhe organizon jetën e tij. Njeriu si qenie dikotomike, është përballë tri zgjedhjeve: të përkujdeset tërësisht për trupin (materializmi), të përkujdeset tërësisht për shpëtimin e shpirtit (religjioni) dhe të ekuilibrojë, harmonizojë në njësinë e qenies së vet, kërkesat materiale dhe religjioze në respekt dhe bindje të plotë të parimeve të epërme (feja në kuptimin që kemi parashtruar). Përbushja e nevojave materiale, si ngrënia, pirja, çlirimi dhe kënaqja e libidos, përkujdesja ndaj performancës fizike, fitimi i parave etj., janë tërësisht natyrore dhe legjitime dhe njeriu nuk duhet të ndihet i trysnuar, në qoftë se punon në përbushjen e tyre. Përbushja e këtyre nevojave shndërrohet në problem në momentin kur njeriu i kthen në qëllim të jetës së tij, si qëllimi më i lartë që duhet jetësuar, këtu dhe tani, nëse është ose jo indiferent në respekt të parimeve të epërme. Përbushja e qëllimit këtu dhe tani, me çfarëdolloj mjeti, i udhëhequr nga interesi vetjak material, ka sjellë zbrazëtirën shpirtërore të njeriut, vetmimin e tij, edhe kur është i rrethuar nga njerëzit. Kjo braktisje dhe harresë e qëllimit të të qenit në botë, dhe kthimi në instrument të plotësisht të çfarëdolloj dëshirë dhe pasioni, e ka errësuar jetën e njeriut, duke e shndërruar nga një krijesë me detyrën e mëkëmbësisë së tokës, në një krijesë të xhungëlzimit të botës, në përbushje të asaj që Markuze e emërton njëdimensionalitet. Përbushja e nevojave shpirtëro-

Realizimi i lirisë së brendshme tek njeriu, është kusht për realizimin e lirisë së jashtme dhe, pikërisht kjo, është e vërteta që të bën të lirë, ku psikoanaliza dhe feja bashkohen, por që ndahen në mënyrën e realizimit të këtij parimi.

re të njeriut, për shpëtimin e shpirtit, rezultoi me lënie pas dore të përbushjes së nevojave trupore dhe me ndrydhje gjithmonë e më të rreptë të dëshirave, pasioneve fizike si *conditio sine qua non*, për shpëtimin e njeriut në përtejbotë. Plotësimi i këtyre dëshirave konsiderohet mëkat, ndotje e shpirtit me dëshirat e ulëta të botës materiale që sundohej nga djalli. Dëlirësia e shpirtit, përkorësia në veshje, ushqim, fjetje, largimi nga bota dhe zullumet e saj, vetmimi në adhurim, ishin shfaqje të logjikës së përbushjes së nevojave shpirtërore. Por a ndikoi kjo logjikë pozitivisht në jetën e njeriut? Ja se si e përshkruan L. Tolstoi deshifrimin e kësaj logjike të të jetuarit nëpërmjet gojës së atë Sergit: *“Ja pra, ç’domethënie pati ajo ëndrra ime. Pashenka është njeriu që duhej të isha unë, por që nuk isha. Unë rrojta për njerëzit i fshehur prapa Zotit, ajo rron për Zotin, dhe i duket se rron për njerëzit. Po, një punë e mirë, një gotë ujë që jepet pa bërë hesap shpërblimin, është më e shtrenjtë se bamirësitë e mia drejtuar njerëzve. Po a ka qenë, vallë, tek unë edhe dëshira e sinqertë, qoftë*

edhe një pjesëz e saj, për t’i shërbyer Zotit? – e pyeti veten dhe përgjigje qenë fjalët: “Po, por ishte e fëlliqur, ishte e molepsur nga etja për lavdi njerëzore. Jo nuk ka Zot për atë që ka rrojtur, siç rrojta unë, për lavdi njerëzore. Do ta kërkoj atë.”¹⁴ Një prej njerëzve të ditur ka thënë se asketizmi i vërtetë nuk është t’i largohesh botës, por të nxjerrësh nga zemra

dashurinë për botën, duke e mbajtur botën në dorën tënde, për ta përdorur si mjet dhe jo si qëllim. Realizimi i lirisë së brendshme tek njeriu, është kusht për realizimin e lirisë së jashtme dhe, pikërisht kjo, është e vërteta që të bën të lirë, ku psikoanaliza dhe feja bashkohen, por që ndahen në mënyrën e realizimit të këtij parimi. E para me vështrimin tërësisht nga toka dhe e dyta me kredhje drejt qiellit, por me këmbë në tokë.

Në përfundim themi se fjalët lapidare të Tolstois na kumtojnë nevojën njerëzore për ekuilibrim të përbushjes së nevojave shpirtërore dhe nevojave trupore, në respekt dhe bindje të plotë të parimeve të epërme me zemër të sinqertë, duke mos e çlartësuar unën e tij nga pozita e mëkëmbësisë, por as duke pretenduar se është zot i jetës, fatit të vet dhe natyrës që e rrethon, përderisa është i vdekshëm.

14. Tolstoi, L. “Atë Sergi”, Tiranë 1992, fq. 65-66

Ramazani

koha kur uria të shkon

Umut Bullut

Jemi në kohën kur uria të shkon si rroba e bukur në trup. Kjo është koha kur shpirti ynë idhnak që rreh brigjet si dallgë, bëhet i thellë si oqean. Nuk ka asnjë kohë tjetër, kur në kraharorin tonë mbajmë me krenari një uri kaq kuptimplote.

Nga një këndvështrim, Ramazan do të thotë “të kup-tosh”. Edhe pse nuk është një uri e plotë, të bën të kup-tosh më mirë atë që nga uria lidh gurët në bark. Duhet të ndërjegjësohemi se jetojmë krah për krah me të gjithë dhe, kur të pyetemi se “ç’është uria?”, përgjigjen ta kemi gati. Uria e stomakut është e rëndësishme sepse thyen kryeneçësinë e krenarisë njerëzore.

Gëzohemi dhe e harrojmë urinë në këtë kohë, kur shohim të formohet një bashkësi e ekuilibruar, ku në njërën anë qëndrojnë “Agnija-i shakirin” (të pasurit falënderues) dhe në tjetrën “Fukara-i sabirin” (të varfrit durimtarë).

Po për ju, a ka rrugë tjetër përveçse t’i vishet kësaj urie një kuptim hyjnor? Për mua kjo është një mirësi hyjnore dhe është e pamundur që këtë mirësi ta gjesh në ndonjë kulturë tjetër.

Nga një këndvështrim tjetër, për ata që kuptojnë, Ramazani është një rast madhështor për të kujtuar anët tona njerëzore, si mëshirën, ndërjegjen, dhembshurinë dhe dashurinë...

Shohim se koncepti i *urisë* është relativ. Ndërsa uria e atyre që sulmojnë të mirat e kësaj bote me dëshirën për t’i shteruar të gjitha nuk ka fund, ata që hanë prej mirësive, duke u mjaftuar me pak, kurrë nuk ngelen të uritur.

A nuk varet gjithçka prej këndvështrimit? Kur shohim se ka njerëz që, megjithëse fitojnë para në shifra astronomike, vuajnë dhe janë të pangopur dhe të tjerë

që punojnë me pagë të ulët, por kalojnë për bukuri, a nuk fillojmë të kuptojmë më mirë sekretin hyjnor, të quajtur “begati”?

Qentë lindin nga dhjetë këlyshë në vit, ndërsa delet vetëm një qengj. Por shohim se delet janë tufa tufa, ndërsa qentë në numër të kufizuar. Ata që kuptojnë nga këto punë, thonë se delja është më e begatë se qeni. Nëse e vëmë trurin në punë dhe mundohemi të shohim me sytë e zemrës, a nuk mund të mësojmë që jetën e kësaj bote ta shohim ashtu siç është në të vërtetë?

Në atmosferën e Ramazanit materializohet, si begatia materiale, ashtu edhe ajo shpirtërore. Në këtë kohë, marrëdhëniet midis njerëzve janë më të begata se sa në kohë të tjera. Gjithashtu, jemi dëshmitarë se edhe bota jonë shpirtërore ngjyroset më tepër në këtë kohë.

Në një farë kuptimi, kjo kohë duhet marrë si një pikënisje. Fillo gjithçka nga zeroja. Fillo të shohësh gjithçka me një shikim ndryshe nga më parë. Këtu qëndron edhe sekretin e begatisë. A nuk e kërkojnë shumë prej nesh një gjë të tillë? Një arsye për të filluar gjithçka nga e para me një shpresë të re. E pse të mos jetë kështu?

Eja pra, kapu pas një shprese të re. Në jetë ende nuk ka marrë fund çdo gjë. Do të shohim se dyert e një jete të re nuk janë edhe aq të kalbura. Sikur nuk dinim që ajo priste veç një prekje tonën.

Kur të trokasim në derën hyjnore me uri në dorë dhe me shpresa të mëdha brenda vetes, do të shohim se gjithë bota do të vihet në radhë për të na ndihmuar. Unë e besoj këtë, o lexues... nëse ti nuk e beson, ta provosh gjë s’të kushton...

Frig e Zotit është krye e fillozofisë

Mund të thuhet se në viset e qytetnueme për me e mbajt qetsin e për me e sigurue tregtin e për me i bâ ballë gjithë ngatresavet mjafton policia e gjiudarmaria e mjeteve tjera qeveritare. Por ky mendim s'është l vërtetë.

Mundet me u thanë dituria e plotësueshme mjafton për njerinë sa me u mbrojt nga ligësitë, pra ahëre ç'duhen fet? Edhe ky mendim s'është as pak i vërtetë.

Mundet të thuhet se mjaft është consianca (vëzhdan) për njerinë sat ë munda me i bâ ballë nevojave njerëzore e shoqënore.

Po, jo jo, as pak se edhe ky mentim nuk â i drejt.

Polecat, gjindarmat munden me e prapë një punë qi ngjet para syve të tyne, a në një vend qi shifet e kallzonet prej së tjerësh. Por krimet e ngjasin për nga herë në shesh? Mâ të shumat e tyne a nuk punohen pshehtë? Ahëre kush mund me i zbulue këto krime? Godit shumë herë që për një krim a faj kapet një i pafajqim krejt e krimtari s'bin as fare në dor. Pra mâ i forti polic, mâ i rrepti gjindarma për njerinë është frig e Zotit, e jo tjetër.

Pengimi mâ i madhe midis krimeve është vetëm e vetëm ajo frigë.

Feja është mâ e sakta gjindarme q'ajo i bâ hetimet

mâ të fella në shpirtin e zëmrën e njeriut.

Feja është kanuni mâ i interesatçim për njerinë qi nëçdo kohë dhe nëçdo vend s'i duhet por e kqyr me një rreptësi e me një forcë të mjaftueshme, e kështu shumë herë nga keqësit e mbron. Por sos qi besimin t'a ket mar me themel.

Të vim ke edykasioni qi marim prej nanave e prej babave, a nuk është po aji përfundimi i stërvitjeve fetare?

Ashtu edhe një fillosof qi s'don me besu as kurrëgjja, edhe aji a nuk është rritun midis një populli fetar edhe kësë soj sado qi thot se: "un s'kam nevojë për fe", por moralet e bukura qi jan ngul në zëmrët t'atij a nuk jan po ato besimeqi ka mar në vogëli prej fetarëve? Mundim të themi i ka zbukuru me dituni.

Sa për konsiancën s'mundim me than fare gjâ, se me ke temën nuk po shofim do një gjymtyr në korpën e njeriut. Por edhe sikur në past do një konsiancë (vizhdan) duhet edhe ky të pshtetet në besimin e fesë së sikujt. Ahëre pra themi: kush s'ka iman s'ka as vizhdan. Kur asht kështu, lipset me shku mbas fjalës të Profetit të math q'urdhënon (r.....). Frig e Zotit asht krye fillosofisë.

A. VASFI

Një hap përparimit

Prej se ramë më një gjumë të randë a mâ mirë të thomi pse mësuem më lënguem prej mjerimit konservativ qi dita me ditë vinte tuj na hangër shpirtin e tuj na brë imanë, s'deshti të na bijë kurr në mend të mendohemi pakës me gjetun mënyrën se si më muejtun e më çuem krye prej kësajë humnerje qi kemi ra, ndoshta që mëkat më besuem se nesërma mund të bâhej mâ mirë për né se sodja.

Një mentalitet kësodore, pa dyshim dhe ati qi ka

besim të plotë se puna e qindrimi ngadhnojn mbi të gjitha veshtirësinat, i a then kurajën civile, i ndalon aspiracionin (frym) e lirë qi merr në fantazi të njëj ditë të lumnuëshme e çon s'mramit me thanë se kët element fatalist si t'onin, asht krejt si e pa mendun më ja hî qi të bahet një punë e mirë.

T'ishtë të gjithë njëzija njësoji, s'do t'u gjindtë kushi t'i bâje ballë më punë këtij mentaliteti, por dësht Zoti e ndollën dhe në mes t'onë ca gjymtyrë të vjefshem qi

s'u tunden farë në mendimet e tynë të lira e të mira; e luftuen kët mentalitet e i thanë se më ndejë kështu si jemi e me pritë me duër ndij Mehdi q i të dalë një- hej mëkat, pse asht fik'e konak e m'u kondëndue me gjendje të sodshme, s'asht tjetër veç si me dashtë me ngulë kambë për m'e dbuem sa mâ parë këndej prai Islamijetin. E që se njimend, rrokull vitit q i jemi, u formue Xhema-ati Ismalija në heqipëni më qëllim q i elementi Mysliman të ngjallohet e të më kambet për mbas parimeve të shëndoshta e të lira q i ka në vet vëdi fëja Islame e t'i thojë lamtumirë një-herë e përgjithmonë këtij mjerimi q i sot mjesrisht na ka rrethuem. Sot..... u hudh një themel. Moti q i të vij, Kongresi i dytë ka me mbushë e plotsuem të metat q i ka me pa e nevojët tjera q i ka me ndië Kongresist vjeta me vjetë kan me çfaqë mendimet e tynë llirsh të ashtu sikuër e lypë interesa e besës e nevoja e ynë në kohen e sodit.

Unë s'due të shkoj aq larg e kët po ja lâ kohës; due të këthehëm të Kongresi i sivjëtshem i cili me statutin e bukur q i na la në dorë, na i çfaqë mëndimet e tija për organizimin t'onë. Brendija e Statutit i përgjögjet pikë- risht nevojve t'ona. Në mes sa e sa tjerave, shohim me shum gërrim q i Këshilli i Naltë i Xhema-ati Islamijes, ngarkohet më nxerrë një rivistë për cilën Myslimani i sotshëm ka të madhen nevojë. Randësija e rivistës asht e madhë, sidomos për në q i s'kemi të botueme libra feje në gjuhën t'onë. Rivista Zani i Naltë q i ka m'u pritë me duer hapët prej çdo Myslimani, si organ i Xhema-atit në fjalë, veç q i do të na çpallë veprimet me randësi q i kryhën apo q i do të kryhen, me artikuj

të bukur q i ka me botue, ka më qënë dhe një ushqim moral e matrial për shpirt e mënde të çdo Myslimani pse në te do të gjejnë sende q i vinë për vehte, do të mësojnë gjana të reja q i s'i ka digjume asnjherë e do të shohë se si feja e ynë i ka dhanë shkasin e hovin mâ të madhin qytetnimit e përparimit ndjërzuer. Me ânë të ksajë riviste, do kemi rastin e bukur të njohim njerzit e mëdhaj të Myslimanve q i kan ardhë e të shohim veprimet e shkëlqyëshme q i na kan lânë. Shkurti kjo rivistë, do të jetë për Myslimanin një pasqyrë e gjallë, me ndihem të cillës ka me muejtun të luftoj llirsh të sendet q i pa kurr një të drejtë në vet vëdi kan marrë një fytyrë e ngjyrë fëtarë e na dalin për ballë.

Këshilli i Naltë i Xhema-ati Islamijes tue botuem kët rivistë, po na thot në elemenitt Mysliman, se me përkrahjen e nxehtë q i ka më pasë prej nësh, ka me u përpjekë me mish e me shpirt me krye edhe pikat e tjera të statutit, realizimi i të cilavë na i kondetë të gjitha ndisit e nevojët t'ona q i kemë.

Mue një detyrë fëtarë për-nji-heri dhe kombëtarë më nxiti të shpëtoj me falënderue Këshillin e Naltë të Xhema-ati Islamijes q i pati mirësin të nisi me xjerrë në dritë Zanin e Naltë me fitim të math dëtyruem shëjtë q i ka marrë për sipri, q i kështu dhe Myslimanit të ngartë në Shqipënin e lirë, përgjithsisht t'i hapet orizandi i pemjes, ashtu sikur paten qënë dikuer Myslimant në botë.

29-VIII-1922.

Shkodrani

Fanatizma

Mâ i madhi demoralizim asht ajo e fanatizmës sespe fanatizma ushqehet me qumshtin e popullit.

Fanatizma asht mâ i dâmshmi i domoralizmit sespe asht katili i arsyes, asht një armik q i njeriut ja shkurton gjykimin e kuptimin.

Për me e çrranjos kët armik na duhet shum stërvitje mendore, sa mâ shum ritet mendja shoqënore aq dobsohet fuqija e fanatizmës.

Asht çudi se mâ të mirët vetëm për fe.... edhe në zakone, edhe në mjeshtëri ka fanatizmë, një mjeshtëri s'do t'a ndryshoj at q i asht i msuem.

Fanatizma edhe në land të politikës hyn. Antarët

e një partije e kundërshtojn tjatrin si tradhëtorë, e vërteta asht vetëm një ndryshim precipi...

Fanatizma asht armiku i çdo përparimi, sa mâ shpejt do të shpëtoj prej fanatizmës aq mâ shpejt do të gjytnohemi.

Fanatizma asht e veshme me egoizmë me mashtë, pra s'asht e mundun një fanatik të jet lulzuem e ti dashun.

LYBETENI

Marrë nga Zani i naltë

Ndiko, që kjo shoqëri të bëhet edhe më e mirë!

Për të arritur sukses në jetën e tij, njeriu duhet të mbjellë optimizmin në shpirt. Optimizmi na fal shpresë tek Allahu, na forcon imanin dhe dëshirën për të punuar. Asgjë në jetë, nga më e vogla deri tek gjërat më të mëdha nuk mund të ndryshohen pa optimizëm.

Kurani Famëlartë na mëson se ndryshimi i një populli mund të arrihet vetëm përmes vullnetit dhe përpjekjeve të tij për të ndryshuar për më mirë. Allahu (xh.sh.), thotë:

“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ai të mos ndryshojë vetveten.”
(Rad, 11.)

Që të ndryshojmë për mirë dhe të rimëkëmbemi, duhet t’i themi vetes: Mjaft me pasivitet dhe tolerancë ndaj gjërave negative. Sot është koha të bëhesh aktiv dhe pozitiv për shoqërinë ku jeton. Gjithçka duhet të fillojë nga vetvetja, për të vazhduar më pas tek të tjerët. Që sot duhet t’u themi “Mjaft!” gjërave të pahijshme dhe negative që shohim në shoqëri. O besimtar! Mos thuaj kurrë “Nuk ka ç’më duhet”, por fillo nga vetja jote për të ndryshuar diçka për hir të Allahut (xh.sh.).

Asnjëri nuk e merr guximin ta ngrëjë zërin, që fenomenet negative, të cilat i shohim në shoqërinë tonë të pakësohen sado pak. Të gjithë jemi ambientuar me këtë pasivitet dhe nuk na bëjnë përshtypje këto gjëra.

Edhe nëse nuk ndryshojmë gjë, prej nesh kërkohet të jemi pozitivë dhe aktivë në jetë. Të jesh pozitiv, do të thotë t’i ftosh njerëzit drejt së mirës, me mënyrën më të pranueshme dhe më të mirë. Allahu (xh.sh.), thotë:

“Thirri në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ta në mënyrën më të mirë!” (Nahl, 125.)

Sahabët e kanë pyetur Pejgamberin (a.s.):

“O i dërguar i Allahut! A mund të ndëshkoemi, ndërkohë që në mesin tonë ka ende njerëz të mirë dhe të ndershëm?”

Pejgamberi (a.s.), është përgjigjur:

“Kur e keqja shtohet dhe kur askush nuk përpiqet ta frenojë atë ose nuk mundohet të ofrojë një zgjidhje pozitive, atëherë ndëshkimi do t’i përfshijë që të gjithë.”



*“Shirri në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur
dhe diskuto me ta në mënyrën më të mirë!”*

- Nahl, 125 -

Në popullin Beni Israil ishte një besimtar i devotshëm i Allahut (xh.sh.), i cili falej dhe agjëronte shumë si dhe kryente edhe shumë ibadete të tjera. Atë nuk e shqetësonte gjendja e popullit të tij, i cili kishte lënë rrugën e Allahut (xh.sh.) dhe nuk e udhëzonte atë në punë të mira, as nuk e ndalonte nga punët e këqija. Ai shikonte vetëm punët e tij. Allahu (xh.sh.), e urdhëroi Xhibrilin (a.s.), që ta shkatërronte atë popull.

Kur shkoi Xhibrili (a.s.), vuri re se në mesin e tyre kishte një të devotshëm që adhuronte Allahun (xh.sh.). Atëherë u kthye tek Allahu (xh.sh.) dhe i tha:

- O zot, në atë vend gjendet edhe një njeri që po të bënte ibadet Ty.

Allahu (xh.sh.), iu përgjigj:

- Fillo me atë të parin, sepse ai nuk i ka udhëzuar njerëzit për punë të mirë dhe nuk i ka ndaluar ata nga e keqja.

Nëse nuk i fton njerëzit të distancohen nga gjynahet, nëse nuk kontribuon në shoqëri për mirë, nëse nuk je aktiv në ruajtjen e fesë dhe nderit të njerëzve, dije o besimtar se nuk e ke bërë detyrën ashtu siç duhet.

Në Sahihun e Buhariut raportohet se Pejgamberi (a.s.), u ka treguar sahabëve rastin e anijes, tek e cila qe shfaqur një e çarë, ndërsa lundronte në det. E tillë është edhe shoqëria. Një e çarë apo një e krisur tek ajo, menjëherë jep pasoja negative. Nëse nga të çarat e anijes mbyten disa dhjetëra persona, nga të çarat (me shkatërrimin) e shoqërisë, mbytet një brez i tërë, mbyten fëmijët tanë. Prandaj, sa herë të shohësh një gjë negative në shoqëri, mos qëndro pasiv, por reago. Shkruaj një artikull, dërgo një letër, ngrije zërin. Nëse nuk ndryshon gjë, të paktën do të dalësh faqebardhë para Zotit dhe me ballin lart, sepse je munduar për të bërë dhe për të ndryshuar diçka për mirë.

Ky hadith i Pejgamberit (a.s.), është një mesazh i qartë për ata që shprehjen: “Ç’më duhet mua kjo punë?” e kanë shprehi dhe sllogan të jetës së tyre.

Umeri (r.a.), ka thënë: “Nëse veprohen punë të liga në fshehtësi, ato nuk dëmtojnë tjetërkënd përveç personit që i bën ato. Nëse punët e mbrapshta dhe të këqija veprohen haptazi dhe njerëzit nuk reagojnë që t’i ndalojnë, ato dëmtojnë të gjithë shoqërinë.”

Shkenca e mjekësisë në historinë e shkencës islame

Ma. Artur Tagani

Mjekësia dhe degët e ndryshme të saj, janë shkenca që u kanë tërhequr më shumë vëmendjen shkencëtarëve myslimanë dhe për këtë arsye, krahasuar me shkencat e tjera, këto shkenca janë zhvilluar më shumë. Shumica e shkencëtarëve myslimanë janë njëkohësisht edhe mjekë të mëdhenj. Pasuria e mjekësisë në Islam, tërhoqi vëmendjen e perëndimorëve dhe ky ndikim vazhdoi tek ata gjer në shekullin XVIII.

Historia islame ka pasur aq shumë shkencëtarë të mjekësisë dhe aq shumë vepra të rëndësishme lidhur me këtë shkencë, saqë, jo vetëm që nuk mund t'i përmendim të gjithë, por është e pamundur të veçojmë edhe më të rëndësishmit. Thjesht do të mjaftohemi me një panoramë të përgjithshme dhe të shkurtër.

Në historinë e shkencës islame, mjekësia zë fill që me kohën e profetit **Muhamed (a.s.) Buhariu** (vd. 270), (një prej koleksionistëve të thënieve profetike), në veprën e tij "**Sahih**", ka ndarë një kapitull të tërë me nëntitullin "**et-Tibbu'n-nebevi**" (mjekësia profetike), në të cilën janë të shënuara thëniet e profetit Muhamed (a.s.), lidhur me mjekësinë.

Më pas, me përkthimin që iu bë veprave të mjekësisë nga gjuha sanskrite dhe nga ajo greke dhe me punësimin e mjekëve të kombësive të ndryshme në spitalet e para abasite, myslimanët nisën të interesoheshin për këtë shkencë dhe e zhvilluan atë me zbulime krejtësisht të reja. Por qëllimisht apo si rezultat i padijes, shumica e historianëve të mjekësisë, shumë merita nuk ua atribuan autorëve të tyre të vërtetë, shkencëtarëve myslimanë.

Është pak e njohur se këta myslimanë ishin të parët që kishin përdorur sistemin e recetave. Ishin ata që krijuan shkencën e psikofiziologjisë (**el-Kindi**), që shpjeguan faktorët e jashtëm të sëmundjeve (**Ali bin Ridvan**), treguan arsyet se përse syri merr ngjyrë të zezë anormale (**Ali Isa el-Bagdadi**), shpjeguan infeksionet (**Ibn Sina**), zbuluan seton-in (**Raziu**), nisën osteologjinë moderne (**Abudul-latif el-Bagdadi**), zbuluan sistemin e kapilarëve (**Ali Ibn Abbas el-Mexhusi**), bënë të parët ndarjen e menengjtit të parë dhe të dytë (**Ibn Sina**). Ishin ata që zbuluan dhe përdorën vaksinën e lisë (**Razi**). Ishte sërish ky mjek i madh mysliman që hodhi idenë e heqjes së gurëve në fshikëzën e urinës apo në veshka, përmes operacionit apo asgjësimin e tyre, duke përdorur ilaçe. Ishin të parët që përdorën zhivën në farmaceutikë (**el-Kindi**); ishin ata të parët që përdorën terapinë përmes muzikës. Falë tyre, shumë vegla dhe mjete pune që sot përdoren në degët e ndryshme të mjekësisë kanë origjinë të gjuhës arabe.

1. PËRKUFIZIMI I SHKENCËS SË MJEKËSISË, SIPAS IBN SINASË

Në fillim të veprës "**el-Kanun fi'tibb**", **Ibn Sina** (vd. 1037) e përkufizon shkencën e mjekësisë në këtë mënyrë:

"Mjekësia është një shkencë që analizon shëndetin dhe sëmundjen e njeriut. Ajo interesohet për përdorimin e metodave të përshtatshme për shërimin e sëmundjeve." (Ibn Sina, el-Kanun fi'tibb, Bulak, v. I, pj. I)

2. DEGËT E SHKENCËS SË MJEKËSISË SIPAS TABERIUT

Mjeku i parë mysliman **Ali bin et-Taberiu** (vd. 870), në veprën "**Firdevsu'l-hikme**", në pjesën 326, i radhit degët e shkencës së mjekësisë në këtë mënyrë:

Pediatria, oftalmologjia, mjekësia e përgjithshme, gjinekologjia, arti i transfuzionit dhe i analizave të gjakut, rehabilitimi, mjekësia e shpirtit (psikologjia mjekësore apo psikiatria).

3. PËRKUFIZIMI I MJEKUT SIPAS NIZAMI-I ARUZI-T

Në veprën "**Çahar Makala**", autori **Nizami-i Aruzi** (shek. XII), e përkufizon mjekun në këtë mënyrë:

"Mjeku është i mëshirshëm në sjellje, i mençur dhe inteligjent si natyrë. Por pa pranuar madhështinë e shpirtit të njeriut, mjeku nuk mund të bëhet i mëshirshëm. Pa pasur njohuri rreth logjikës, nuk mund të jetë i mençur dhe pa ndihmën e Allahut, nuk mund të ketë mendime të sakta." (Nizami-i Aruzi, **Çahar Makala**, përkth. Në ang. i E.G. Browne.)

4. ZBULIMI I QARKULLIMIT TË GJAKUT NGA IBN NEFIS

Padyshim, një nga zbulimet më të rëndësishme është qarkullimi i gjakut. Zbuluesi i parë i kësaj, është **Ibn Nefis** (vd. 1288). Por historia e mjekësisë daton në shekullin XVI, si shekulli i zbulimit të qarkullimit të gjakut nga **Michael Servitus**-i. Mirëpo, sikur të analizohet mirë, do të vërehet se shumë shekuj para **M. Servitus**-it dhe **W. Harvey**-it është zbuluar pikërisht nga mjeku i shquar mysliman **Ibn Nefis**.

Ibn Nefisi e shpjegon kështu qarkullimin e gjakut:

"Gjaku lëviz nga barkushja e djathtë, veprim i cili është i detyrueshëm për në barkushen e majtë, e cila është edhe burim jete. Mes këtyre barkusheve nuk ka ndonjë kalim tjetër. Ndryshe nga ç'mendonin disa mendimtarë, zemra nuk ka ndonjë urë të dukshme për të pompuar gjakun e as ndonjë të padukshme, sikur besonte Galen-i. Përkundrazi, poret dhe fshikëza e zemrës janë të mbyllura dhe të trasha. Mirëpo, ky gjak, pasi të pastrohet, detyrimisht do të kalojë për në qeskat e mushkërive, përmes venave të mushkërive. Aty, duke bërë kontakt me ajrin, gjaku pastrohet gjer në pikën e fundit të tij. Pas këtij procesi, për t'u realizuar jeta, gjaku kalon në atriumin e majtë të zemrës, nëpërmjet arterieve të mushkërive..." (Ibnu'n-Nefis, **Sherhu'l-Kanun**, Damask, Bot. 1934, fq. 76.)

5. DËMET E ALKOOLIT SIPAS RAZIUT (VD. 925)

"Pirja e alkoolit është një prej veseve që sjell me vete sëmundje dhe probleme të ndryshme. Atyre që konsu-

mojnë shumë alkool mund t'u ndodhë ndonjë paralizë e papritur ose mund të kenë probleme me frymëmarrjen. Po ashtu, sjell edhe shumë shqetësime të ndryshme, si ngushtimi i venave, që është shkak për vdekjet e papritura, si pasojë e ndërprerjes së lidhjes mes venave dhe trurit. Nëse në sistemin nervor ka një dobësi të caktuar, ai do të ketë temperatura të pashpjegueshme, qelbëzim gjaku, fryrje të zorrëve, kllapi dhe verdhëza. Këto janë nga dëmet që shkakton pirja e alkoolit. Përtej këtyre, alkooli shkakton humbje të kontrollit të trurit dhe të arsyes, demonstrim gjërash të fshehta, si dhe paaftësinë për të gjykuar çështje të rëndësishme materiale dhe shpirtërore..." (Razi, **The Spirit Phisics**, gruppërkthyesish në ang., London, 1950, fq. 78.)

6. NARKOZA ËSHTË PËRDORUR FILLIMISHT NGA MJEKËT MYSLIMANË

Historia e shkencës së mjekësisë njeh vitin 1850, si viti kur u përdor për herë të parë anestezia (narkoza), nga **Junken**-i. Mirëpo, kjo nuk është e vërtetë.

Mjeku dhe historiani mysliman i mjekësisë **Salahad-dini**, në veprën e tij "**Nuru'l-ujun**", tregon se anestezia (arab."tanvim") e parë është përdorur në shekullin IX, nga shkencëtari mysliman **Thabit bin Kurra** (shek. IX). Shumë shekuj para **Gurit**-it, **Kappeler**-it, **Lecrec**-it, **Ullman**-it dhe **Brown**-it, një tjetër mjek mysliman, **Ali bin Isa** (shek. IX), në veprën e tij "**Tedhkiratu'l-kehhalin**", shpjegon vetë se ka përdorur anestezin kur ka bërë operime të ndryshme në sy.

7. ZBULIMI I MIKROBIT DHE AKSHEMSEDINI

Rreth 400 vite para **L. Pasteurit**, mjeku dhe sufisti i madh mysliman **Akshemsedini** (vd. 1498), ndërkohë që shpjegon arsyet e disa sëmundjeve, përmend edhe mikrobin për herë të parë në historinë e mjekësisë. Për arsye se ai përdor fjalën "tohum" (shqip: farë), Pasteuri më pas, përdor të njëjtën fjalë, por në frëngjisht "germe".

Akshemsedini në veprën "**Maidetu'l-hajat**", shpreh kështu:

"Të gjitha sëmundjet, kanë tohum-ët e tyre përkatëse, sipas karakteristikave të gjallesave. Ka sëmundje që transmetohen përmes trashëgimisë. Disa prej tyre, rishfaqen pas shtatë viteve. Tohum-ët e sëmundjeve që vijnë përmes ushqimit, mund të zmadhohen." (Akshemseddin, **Maidetu'l-hajat**, fq. 50.)

Këtu **Akshemsedini** nuk përmend vetëm ekzistencën e mikrobeve, por afro 60 vite para **Hieronymus Fracastor**, përmend se sëmundjet mund të jenë të trashëgueshme dhe ngjitëse.

Ebu Hamid Gazaliu dhe kritika e tij e filozofisë

Ebu Hamid Gazaliu ka qenë një nga personalitetet më të fuqishme dhe mendjet më të mëdha që janë paraqitur në Islam, siç e dëshmon këtë edhe ofiqi i nderit *Huxhetulislam* (argumenti i islamit) që e ka vetëm ai dhe disa të tjerë. Ebu Hamid Muhamed Gazaliu u lind më 450/1059 në Gazale, qytezë në rrethin e Tusit në Horasan. Ai dhe vëllai i tij, Ahmedi, kanë qenë ende fëmijë kur e humbën babain.

Para vdekjes, babai ia besoi kujdesin ndaj tyre një miku, nga i cili morën edhe arsimimin e parë. Pastaj Gazaliu i ri shkoi në Nishapur, një nga qendrat më të rëndësishme intelektuale të botës myslimane të asaj kohe. Atje njohu liderin e asaj kohe të shkollës esharite, Imamul Haremejnin dhe u bë nxënës i tij.

Pas vdekjes së mësuesit të vet (478/1085), miqësohet me vezirin e famshëm selxhuk Nidhamulmulkun, themeluesin e Universitetit të Bagdadit (*Medrese Nidhamijje*), ku edhe do të emërohej profesor, 484/1091.

Kjo periudhë shënon etapën kyçe në jetën e tij. Ky mjedis i përshtatej zhvillimit, ndikimit të fuqishëm të personalitetit të tij dhe thellimit të diturive në fushën filozofike.

Kësaj periudhe të jetës së tij i përkasin dy vepra. Së pari, libri "Synimet e filozofëve"

(*Mekasidul-felasife*), i cili në Perëndim është përkthyer në latinisht (Toledo, 1145 nga Do-

minicus Gundisallinusi), me titullin *Logica et philosophia Algazelis Arabis*, por pa pjesën hyrëse dhe përfundimin, në të cilat Gazaliu shpall synimin e vet.

Ky libër ka bërë që skolastikët latinë ta konsideronin Gazaliun filozof të afërt me Farabiun dhe Avicenën. Për këtë arsye, kundër tij qenë drejtuar edhe polemikat me filozofët "arabë".

Vepra tjetër, nga e njëjta periudhë, është sulmi i famshëm dhe i rreptë mbi filozofët.

Do të ishte qesharake të thuhej, siç është folur në shekullin e kaluar, se kjo kritikë i ka shkaktuar filozofisë goditje, nga e cila ajo nuk ka mundur të këndellet.

Viti i tridhjetë e gjashtë i jetës, për Gazaliun, ka pasur domethënien e kthesës vendimtare. Në atë çast, para ndërgjegjes së tij është shtruar aq ashpër problemi i së vërtetës intelektuale, sa i ka shkaktuar krizë të brendshme mjaft serioze, e cila e detyroi të bënte kthesë si në veprimtarinë e tij profesionale ashtu edhe në jetën familjare. Në vitin 488/1095 braktis universitetin dhe familjen, duke i flijuar për hir të kërkimit të sigurisë së brendshme, si garantuese e së Vërtetës. Mund të përfytyrojmë se sa ia ka trazuar shpirtin ky vendim i Gazaliut, rektorit të Universitetit *Nidhamijje*, komentuesit zyrtar të mësimin esharit, që në atë kohë identifikohet me vetë ortodoksinë e islamit sunit. Ky vendim zbulon fuqinë e jashtëzakonshme të persona-

litetit të Gazaliut.

Gazaliu largohet nga Bagdadi dhe niset rrugës së kërkimit të sigurisë mendore dhe shpirtërore. Dhjetë vjet ka bredhur nëpër botën islame, i veshur me rroba sufiste. Ai shkoi në Damask, Jerusalem (të cilin ende nuk e kishin pushtuar kryqtarët), në Aleksandri dhe Kajro, në Meke dhe Medine. Tërë kohën ia përkushtoi përsiatjes dhe aktiviteteve shpirtërore sufiste. Pasi e kapërceu krizën dhe e mposhti dyshimin shpirtëror, u rikthye në vendlindje, ku edhe ligjëroi në Nishapur. Vdiq në Tus, më 501/1111 (më 19 dhjetor), në moshën 53 vjeçare, më i ri se Ibn Sina (Avicena).

Gazaliu është ballafaquar me problemin e njohjes dhe sigurisë personale në tërë gjerësinë e vet. Por a është ai i vetmi, ndër të gjithë mendimtarët islamë, që kanë kërkuar njohjen e sigurisë eksperimentale të botës së brendshme? Kjo është temë thelbësore te Suhraverdi, ndërkohë që më parë Avicena dhe Ebulberekat Bagdadi, qenë ballafaquar me problemin e vetëdijes dhe ndërlikimeve të saj.

Ajo që e bën patetik hulumtimin e Gazaliut, është dramaticiteti që e shoqëroi në jetën e tij. Kur ai flet për njohjen e vërtetë, kjo ka theksin e autenticitetit të plotë të një dëshmie personale. Në *Munkidh* (Shpëtimi nga lajthitja), ai proklamoi: *"Njohja e vërtetë është ajo në të cilën sendi i njohur plotësisht zbulohet (para shpirtit), aq sa nga aspekti i saj nuk mbetet kurrëfarë dyshimi dhe kurrëfarë lajthitjeje nuk mund t'ia errësojë shkëlqimin. Kjo është shkallë në të cilën zemra nuk do ta lejonte, madje as ta parashtronte dyshimin. Çdo dije që nuk përmban këtë shkallë të sigurisë, është dije e mangët dhe e nënshtruar para lajthitjes"*.

Kjo paraqet filozofinë e jashtëzakonshme pozitive dhe çdo filozof do t'ia pranonte me kënaqësi vlerën dhe meritën. Rasti i kundërt, fatkeqësisht, nuk vlen. Qëndrimi negativ i Gazaliut ndaj filozofisë bëhet më i rreptë, aq sa

befason. Në aspektin polemik të veprës së tij, pa dyshim zbulohet vuajtja e brendshme e tij e thellë.

Me këtë polemikë janë të përshkuara katër vepra të tija, në të cilat sulmon me radhë ismailitët, të krishterët, të ashtuquajturit "mendjelirët" dhe më në fund filozofët. Ajo që befason edhe më shumë, është besimi të cilin njeriu, që të ketë sukses në polemikë, ia jep logjikës dhe dialektikës racionale.

Libri polemik kundër të krishterëve do të dëshironte të bëhej "përgënjeshttrim i njerëzishëm i natyrës hyjnore të Jezusit", në të cilën autori mbështetet në thëniet precize nga Ungjilli.

Një libër polemizues, të cilin Gazaliu pa dyshim e ka hartuar pas kthimit në Nishapur, sullet mbi "liberalët" (*ibahijun*), që është kategori mjaft e gjerë, ku bëjnë pjesë sufitë jashtë radhëve, filozofët endacakë dhe "heretikët" e të gjitha llojeve. Do të mund të thuhet se personat në të cilët ai synon, u përgjigjen atyre, të cilët në shekullin XVI dhe XVII, në Gjermani i kanë quajtur *Schwärmer*, "entuziastë." As këtu, ata që mendojnë më ndryshe, nuk janë kursyer nga akuza për ndyrësitë më të këqija morale.

Për nga rëndësia, këta libra nuk mund të krahasohen me ndërmarrjen që Gazaliu ka tentuar ta zbatojë me librin e vet të madh kundër filozofëve, që e titullon *Tehafutul-felasife*.

Do të mund të përkthehet shumë mirë edhe si "Vetëshkatërrim i filozofëve." Këtu del paradoksi i Gazaliut, i cili, i bindur në pamundësinë e arsyes që të depërtojë deri te siguria, me plot siguri beson që me anë të dialektikës racionale e zhdokë filozofinë e filozofëve. Averroesi ka qenë krejtësisht i vetëdijshëm për këtë vetëmohim: nëse lejohet paaftësia e plotë e arsyes, kjo paftësi shtrihet edhe në mohimin vetjak. Për këtë, Averroesi do t'i përgjigjet me mohimin e mohimit, dhe do të shkruajë "Vetëshkatërrim i vetëshkatërrimit" (*Tehafut ut-tehafut*).

Gazaliu bën përpjekje të madhe që t'u provojë filozofëve se prova filozofike nuk provon asgjë; për fat të keq, edhe vetë është i detyruar të provojë pikërisht me mënyrën e provës filozofike.

Me rreptësi të veçantë sulmon mësimin e tyre mbi përhershmerinë e botës; për të, rrjedha e inteligjencave, është vetëm një metaforë. Ai nuk ka sens për përsosurinë dhe bukurinë e kësaj teorie. Vlerëson se filozofët janë të paaftë që ta provojnë domosdoshmërinë e Demiurgut, unitetin hyjnor, dijen e Zotit mbi sendet jashtë vetë atij. I entuziazmuar me entuziazmin e vet, madje do të përgënjeshtrojë dëshmitë filozofike për të ekzistuarit e substancave joshkatërruese shpirtërore, ndonëse vetë atij, në veprat e tjera i nevojitet spiritualiteti i shpirtit të pavdekshëm. Për filozofët, qenia shpirtërore është qenie e cila e njeh veten dhe është e vetëdijshme për këtë. Shqisat trupore organike nuk janë të afta për këtë. Pa dyshim, përgjigjet Gazaliu, por mbase kjo duhet konsideruar çudi!

Këtu qëndron esenca e të përsiaturit të tij; "arma vrasëse" e kritikës së tij është mohimi esharit i kauzalitetit e, me këtë edhe i idesë së Avicenës, e cila të ekzistuarit e qenieve të mundshme, të paafta që të jenë nga vetvetja, e bazon në domosdoshmërinë e parimeve që e kompensojnë mosqenien e tyre. Për Gazaliun, të gjitha rrjedhat natyrore zhvillohen sipas rregullimit të paracaktuar të vullnetit hyjnor, të cilin ai mund ta ndërpresë në çdo çast. Është i përjashtuar çdo mendim mbi normën e brendshme të një qenieje, mbi domosdoshmërinë e brendshme të saj. Filozofët pohojnë, për shembull, se zjarri është parim i ndezjes; ai e bën këtë sipas natyrës së vet dhe nuk mundet të mos e bëjë këtë. Gazaliu nuk e pranon këtë domosdoshmëri, dhe thekson se veprimi i zjarrit duhet të reduktohet në Zotin, i cili vepron qoftë drejtpërdrejt, qoftë me ndërmjetësimin e Engjëllit. Kundrimi eksperimental na lejon të themi se djegia e pambukut, për shembull,

ndodh *gjatë kohës* së kontaktit të tij me zjarrin, por kjo nuk është provë se kjo ndodh *për shkak* të kontaktit të zjarrit dhe pambukut; shkak mund të jetë diçka krejt tjetër.

Më në fund, filozofët mashtrohen, konsideron Gazaliu, kur mohojnë ringjalljen trupore, realitetin tekstual të parajsës dhe skëterrës dhe kur e pranojnë jetën pas vdekjes ("kthimin" në atë botë, *me'ad*) vetëm për qenien shpirtërore, për shpirtin.

Mbase këtu është zgjidhja, të cilën deri tash nuk e kemi vërejtur fare dhe që i redukton konsequencat e kritikës së Gazaliut në masën e tyre të vërtetë. Do të ishte e gabueshme të thuhej që filozofia, pas Gazaliut, është dashur të shpërngulet në Perëndimin islam, siç do të ishte e gabueshme të thuhej, që filozofia nuk është këndellur nga goditja që ai i ka dhënë. Ajo, thjesht, mbeti në Lindje, dhe qe aq pak e tronditur, sa avicenishtët i takojmë edhe sot. Veprat e mëdha të shkollës së Isfahanit, dëftojnë se kjo nuk ka të bëjë me "filozofinë e kompromisit", aq më pak me "punimet e epitomistëve." Ka të bëjë pikërisht me "filozofinë profetike", të cilën e kemi skicuar këtu në fillim dhe hovi i ri i së cilës na ndihmon t'i kuptojmë, duke pasur parasysh rezultatin e kritikës së Gazaliut, arsyet, për shkak së të cilave fati i vërtetë i filozofisë burimore islame, mund të krijohet vetëm në Islam.

Në realitet, vepra e Gazaliut që ka pasur më shumë ndikim, nuk është *Tehafut*, por kjo para së gjithash, është vepra "Mbi përtëritjen (ose ringjalljen) e diturive fetare" (*Ihja ulumid-din*), e cila ka përplot analiza jashtëzakonisht të thella inteligjente, siç janë, për shembull, faqet e përkushtuara të të dëgjuarit muzikë.

Nuk do të ketë më dilemë: të jesh filozof apo sufi. Nuk mundet të jetë krejtësisht njëri, e të mos jetë tjetri. Kurse, nga kjo lind tipi i spiritualistit, të cilit filozofia i shtron atë kërkesë që ndoshta askund tjetër nuk e ka shtruar.

Xhamitë e Elbasanit

Dihet historikisht se xhamitë në unitet me hamamet publike, me medresetë, me pazaret etj., përbënin gjatë shekujve të kaluar bërthamën urbanistike të qyteteve tona mesjetare. Qyteti i Elbasanit është një nga qytetet më me rëndësi gjatë sundimit osman. Ai është ndërtuar mbi themelet e vjetra të qytetit antik Skampa, me urdhër të sulltan Mehmetit të II, gjatë fushatës së këtij të fundit në Shqipëri. Qyteti u krijua mu në mes të Shqipërisë, aty ku ndërlidheshin rrugët e ndryshme tregtare, me qëllim mbajtjen nën kontroll të një pike të rëndësishme strategjike. Me këtë fakt lidhet edhe emri që i vunë turqit osmanllinj qytetit të ri që krijuan. Emri osman

i qytetit që Ilbasan që do të thotë "ai që shtyp vendin." Në turqishten moderne, fjala "il" nënkupton një qytet të vogël, por në të kaluarën, në gjuhën somane "il" quheshin ndarjet e mëdha administrative. Prandaj qyteti i ri u krijua me qëllim që të kontrollonte një hapësirë të gjerë administrative. Krijimi i qytetit tregonte edhe për shqetësimet që po i sillte pushtetit qendror lëvizja e Skënderbeut në Shqipëri. Krijimi i një qyteti të fortifikuar mjaft mirë, ndonëse në fushatën që ndërmori vetë sulltani nëpër Shqipëri, tregonte se kryengritja e Skënderbeut nuk konsiderohej një lëvizje e thjeshtë, ndaj të cilave akademia ushtarake osmane përdorte me efikasitet derbendet. Vetëm një lëvizje e fuqishme, që detyronte vetë sulltanin të vinte në krye të ushtrisë osmane nëpër këto zona, do ta detyronte po atë të ndërtonte një qytet si Elbasanin. Përpjekjet e Skënderbeut për ta marrë kështjellën me rrethim dhe sulme të papritura, nuk dhanë rezultat.

XHAMIA HYNQARIT (MBRET)

Kjo është xhamia më e madhe dhe më e vjetër e qytetit dhe ndodhet brenda kalasë, në pjesën qendrore të saj, në të djathtë të rrugës që të fut nga porta në kala dhe është në gjendje relativisht të mirë. Atë e njohim nga përshkrimi i Evlija Çelebiut, i cili e quan xhamia e Gazi Sinan Pashës dhe si një ndërtesë të madhe, por të vjetër dhe të ulët. Çelebiu na tregon se të katër faqet e mureve të brendshme të sallës së lutjeve janë mbushur me vjersha të shkruara bukur prej udhëtarëve nga Turqia, Arabia dhe Persia. Edhe ai vetë la një shënim të tillë gjatë udhëtimit të





tij të dytë, në vitin 1670. Xhamia sot është e tjetërsuar nga dëmtimet e bëra gjatë vitit 1967, kohë kur edhe iu ndërrua destinacioni dhe iu rrënuar minarja e saj shumë e vlefshme, si dhe ambientet e brendshme. Për vendosjen në kohë të xhamisë, si një ndërtim i bërë rreth vitit 1492, jemi nisur nga cilësimi i saj "Mbret" dhe nga dhëna e Çelebiut se është ndërtuar në kohën e sulltan Bajazitit II (1481-1512). Prandaj kjo xhami, si dhe shumë të tjera që mbajnë cilësimin "Mbret", ose janë ndërtuar nga sulltan Bajaziti apo dhuruar, ose janë porositur nga Sulltani apo dinjitarë të lartë të tij. Por jo vetëm kjo, sepse edhe teknika e ndërtimit dhe format arkitekturore i takojnë shek. XV. Ndërsa lidhur me ndërtimin dhe dhuruesin, Majkëll Kiel mendon se kemi të bëjmë me Sinan Pashë Boroviniq, që njihet për vakëfin e tij në Elbasan, në kapërcyellin e shek. XIV-XV. Xhamia përbëhet nga salla e lutjeve, portiku dhe minarja dhe është e llojit me sallë të mbuluar me çati druri. Salla e lutjeve është drejtkëndëshe në plan, me përmasa 11,52 x 12,35m dhe mbulohet me çati druri. Në sallë hyhet nga porta në murin verior, e trajtuar në formën e një portali, që e lidh me portikun. Mbas saj është mafili mbi struktura druri. Përballë hyrjes është mihrabi, në të djathtë të tij

është minder mbi struktura druri, i ngritur mbi një dyshe me pak më të lartë. Salla ndriçohet nga 10 dritare, të vendosura në dy radhë në të tri faqet. Kështu, në secilën faqe kemi nga katër dritare. Dritaret e poshtme janë drejtkëndëshe dhe mbulohen me arkitra druri, duke pasur mbi to një hark shkarkues, të ndërtuar me tulla dhe me profil fundlundre, të futur pak më brenda murit. Një shirit tullash qarkon harkun. Nikeja që formohet nën hark, është e suvatuar dhe e zbukuruar me motive gjeometrike, karakteristike për artin islam. Dritaret e sipërme janë më të vogla dhe mbulohen me hark të mprehtë prej tullash. Muratura është ndërtuar me teknikën e kluasonazhit, me dy tulla vertikale e dy tulla horizontale. Pjesa ndërmjet tullave është suvatuar me një patinaturë të hollë, që fsheh ndërtimin e pjesës së murit që është prej disa gurësh. Me interes për arkitekturën e xhamisë është minarja. Në të hyhet nga një portë e vogël në këndin veriperëndimor të sallës së lutjeve. Sot prej saj ruhet bazamenti paralelopipedik, i ndërtuar me teknikën e kluasonazhit, por i ndryshëm nga ai i mureve. Bazamenti përfundon me një kornizë të hollë prej gurësh të profiluar, mbi të cilin ishte pjesa kalimtare. Mbi të ngrihej trupi dymbëdhjetëfaqësh i minares, ndërtuar me gurë të punuar e të suvatuar. Kazani i minares ishte i ndërtuar me tulla trekëndëshe në pjesën e poshtme, të nxjerra pak ndaj njëra-tjetrës dhe të punuara në formë të rregullt, në formë stalaktitesh. Xhamia Mbret e Elbasanit, paraqet interes të veçantë për studiuesit, sepse ruan format e dikurshme më shumë se xhamitë e tjera të kohëve të para pushtimit turk.

XHAMIA E BALLIJES

Xhamia e Ballijes ose, e cilësuar si "xhamia Blu e Elbasanit", është ndërtuar pas xhamisë së Nazireshës. Studiuesit mendojnë se ajo është ndërtuar në fillim të shekullit XVII, në kohën kur në Perandori kishte shkëlqyer si kryearkitekt Sedefqar Mehmet Aga Biçakçiu. Xhamia e Ballijes



është vizituar nga Evlija Çelebiu. Sipas Çelebiut, xhamia e Ballijes është ndërtuar ndërmjet vitit 1608 dhe 1609. Elementë përbërës të saj, si salla e faljes, portiku, minareja etj., plotësohen me siluetën e një kupole gjysmësferike me një tambur poligonal tetëkëndor. Elementi më tërheqës i xhamisë së Ballies ka qenë minareja, e cila për nga lartësia, modelimi dhe ballkoni ka qenë e vetme e këtij lloji në Shqipëri. Xhamia e Ballijes ndodhej pranë vendit ku sot është Teatri Skampa. Komuniteti mysliman i Elbasanit ka pasur shumë kontestime për mospërfshirjen e objektit në planin urbanistik për qendrën e re të qytetit. Në truallin e xhamisë është vendosur me anë të planit urbanistik, që të jetë një hapësirë e gjelbëruar.

XHAMIA E AGAIT

Plani rregullues i qytetit të Elbasanit e përjashtoi atë nga monumentet e kulturës, ndonëse kishte vlera të veçanta arkitekturore, pasi ekzistenca e saj kishte lidhje me emrat e arkitektëve të mëdhenj shqiptarë të kohës. Xhamia mendohet se ka qenë e projektuar nga Sedefqar Mehmet Aga Biçakciu dhe u ndërtua disa vite më vonë. Sipas Çelebiut, xhamia është me e re se ajo e Ballijes dhe se kishte një minare shumë

të bukur. Ka mendime se kjo xhami është ndërtuar në vitin 1640. Xhamia e Agait ka ekzistuar pranë vendit ku sot ndodhet Albtelekom dhe dy ndërtesa banimi.

XHAMIA E GAZIT TË SINANIT

Njihej ndryshe edhe si “xhamia e poetëve”, për shkak se në të gjitha muret e saj ishin shkruar vjersha, lëvdata e fjalë profetike nga poetët dhe udhëtarët që vinin nga të katër anët e Perandorisë. Sipas Çelebiut, në muret e saj kishte aq shumë mbishkrime, sa mund të formohej një vëllim me 1500 faqe. Mendohet se ka lidhje me Sinan Pashë Biçakçiun, i cili jetoi në vitet 1506-1596. Sinan Pasha ishte ushtarak dhe pushtetar i lartë. Ka qenë oficer pallati në kohën e Sulltan Sulejmanit, guvernator në Gaza e Tripoli, kryevezir, më 1582 dhe guvernator i Damaskut, më 1568. Mendohet se ka financuar ndërtimin e xhamisë që njihet me emrin xhamia e Gazit. Pas kësaj periudhe, përmenden edhe xhamia e Lepurit, xhamia e Sinan Beut, xhamia e Tabakëve, xhamia e Beqarëve dhe 20 medrese. Sipas kronikanëve, xhamitë zotëronin një cilësi të tillë, ku të gjitha minaret ishin në harmoni mes tyre në të njëjtën lartësi. Xhamitë kanë qenë ndërtuar në qendër të qytetit.



Zejneb binti Ali (r.a.) simboli i fisnikërisë Profetike

Zejneb binti Ali është mbesa e Profetit (a.s.), vajza e Hz. Fatmës (r.a.), erdhi në jetë afërsisht 5 vite para vdekjes së gjyshit të saj, Krenarisë së njerëzimit, personalitetit shembullor, Muhamedit (a.s.).

Ishte një zonjë e edukuar, e zgjuar, e pampostur nga sfidat e asaj kohe, një nënë e devotshme, një grua besnike dhe një motër plot dhembshuri e mëshirë. Ka transmetuar shumë hadithe nga nëna e saj e nderuar, duke u cilësuar kështu si një nga hallkat e përcjelljes së mesazheve Profetike.


Vitet kalonin shumë shpejt, ashtu siç shkëputen fletët, pa u ndier fare, ditë për ditë nga kalendari. Pas vdekjes së Hz. Fatmes, Hz. Aliu u përpoq gjithnjë që Zejnebi të mos e ndjente mungesën e nënës së saj, burim mëshire dhe

dashurie.

U martua me Abdullah b. Xhafer (r.a.), me të cilin kaloi një jetë të lumtur, ku dhe Allahu i gëzoi me 5 fëmijë.

Mori pjesë në Qerbela, pranë vëllait Hz. Husejnit. Duke vuajtur thellë në shpirt vdekjen e njerëzve më të dashur të zemrës, ngriti duart lart, si të njoftonte Profetin (s.a.s), duke thënë: **“O Muahmed! Selamet e Allahut dhe të gjithë melekëve qofshin mbi ty. Ja..., Hyseni i mbuluar në gjak, i shtrirë në mes të sheshit. Era po mbulon trupat e tyre me rërë. Qofshin të shpëtuar pranë teje”.**

Ndër robërit e luftës, të cilët u paraqitën para Ibni Zijadit, ishte edhe Zejnebi. Në she një talljeje Ibni Zijad iu drejtua Hz. Zejnebit, duke i thënë: “Falënderoj Zotin që ju poshtëroi e që po ju mbyt një e nga një...”



Ndërsa Hz. Zejnebi iu përgjigj, duke i thënë:
“Falënderoj Allahun që na nderoi me Muhamedin dhe na pastroi shpirtërisht. Ne kurrë nuk jemi ashtu siç na cilëson ti...”

Ibni Zijadi vazhdon: “Si t’u duk ajo që bëri Allahu mbi familjen tënde?”

Hz. Zejnebi i përgjigjet: “Allahu ua kishte caktuar atyre vdekjen dhe ata erdhën në vendin, ku do t’i dhuronin shpirtin Atij që ngjall dhe vdes”.

Ibni Zijadi, i acaruar vazhdon: “Tashmë ndihem i qetë. U zhvesha nga urrejtja dhe mëria, që kisha për vëllain dhe pjesëtarët e tjerë të pabindur të familjes tënde”.

Hz. Zejnebi, e mbytur në lot, i përgjigjet: “Bethem, se më zhduke rrënjët e familjes sime dhe e shkatërrove atë, je shkaktar i britmave të këtyre fëmijëve jetimë tashmë e, nëse kjo të jep qetësi, qoshf i qetë gjithnjë!!!”

Kjo ishte biseda rrëqethëse dhe shumë e goditur e Hz. Zejnebit, simbol i sacrificës, i fisnikërisë dhe i vetëmohimit që mbushi faqet e historisë gjithandej.

Vdiq në Egjipt rreth vitit 65 Hixhri. Allahu e mëshiroftë dhe e nderoftë me xhenet...

AMIN!



Thyerja e dhëmbëve



Të rriturit veçanërisht janë shumë të brishtë kur bëhet fjalë për dhëmbët dhe shpesh ato u çahen, u krisen, apo dhe u thyhen. Zmalti bëhet shumë i hollë dhe thuajse i tejdukshëm. Por në fakt ky lloj erozioni nuk është pasojë e zakonshme e plakjes, sepse mund të ndodhë në çdo moshë. Kjo shkaktohet zakonisht nga acidet që vijnë prej stomakut, kryesisht gjatë natës, të cilat i shkatërrojnë dhëmbët. Shkërmoqja e dhëmbëve mund të shoqërohet edhe me simptoma të tjera, si tharja e gojës, apo dhimbjet e zemrës.

Kanceri i gojës

Ka shumë njerëz që i kafshojnë pjesët e gojës së tyre dhe ky shpesh konsiderohet si një veprim nervoz. Nga këto kafshime shkaktohen plagë të vogla brenda gojës. Por kur një plagë e vogël nuk arrin që të mbyllet brenda një apo dy javësh, që është edhe koha normale e shërimit të saj, atëherë duhet shkuar te dentisti apo te mjeku. Zakonisht problematike është situata nëse plaga bëhet e kuqe, madje kur merr ngjyrë rozë. Shpesh është shenjë e kancerit të gojës. Të shumtë janë ata persona që gjatë një viti diagnostikohen me kancerin e gojës. Pjesa më e madhe e këtyre të

sëmurëve janë mbi 60 vjeç. Kanceri i gojës ka një përqindje mbijetese në 35%, por është i rrezikshëm kur ai identifikohet me vonesë. Ata që pinë duhan kanë shanse më shumë se të tjerët për të pasur kancer goje, ndërkohë duhani nuk është kusht, sepse edhe ata që nuk pinë duhan e kanë këtë sëmundje. Zakonisht plagët e gojës nuk duhen lënë pas dore. Ato duhen ndjekur me shumë kujdes dhe nuk duhet harruar se mund të jenë vdekjeprurëse nëse janë të ndonjë natyre të dyshimtë.

Tharja e gojës

Tharja e gojës mund të shkaktohet nga një sërë shkaqesh, duke filluar nga dehidratimi, alergjitë, duhan pirja dhe ilaçet. Në fakt, për sa u përket ilaçeve, ato kanë një efekt shumë të madh të mënyra se si e ndiejmë gojën. Shpesh tharja e gojës është efekt anësor i përdorimit të ilaçeve. Por mungesa e pështymës në gojë është gjith-

ashtu edhe shenjë e sëmundjeve të brendshme të organizmit si për shembull me diabetin. Sipas statistikave, tharja e gojës, vihet re më shumë te meshkujt se sa te femrat dhe te njerëzit në një moshë kryesisht mbi të 50-at.



Aparati fotografik udhërrëfyes



Pentax, me prodhimet e reja garanton rezistencë dhe udhërrëfim. Në këto aparate fotografike do të gjeni më shumë se ç'prisni prej një aparati të zakonshëm.

Firma Pentax sjell në treg dy modele të rinj aparate

tesh fotografikë, "Optio WG1 dhe Optio WG1-GPS", të cilët janë të përshtatshëm për çdo lloj vendi dhe rezistentë ndaj ujit. Këto aparate do të jenë miqtë tuaj më besnikë në aventurat më të vështira.

Me Optio WG1-GPS, tashmë është shumë më e lehtë të gjesh rrugën. Në sajë të GPS, atyre që u pëlqen të shëtisin, u jep mundësinë të bëjnë "geotagging" (të etiketojnë vendin ku ndodhen) në fotografitë e tyre. Gjatë shkrepjes së fotove, aparati llogarit automatikisht vendin ku ndodheni dhe e ruan atë bashkë me datën. Kështu që kur të ktheheni në shtëpi, do të keni mundësinë t'i piketoni fotot tuaja mbi ndonjë hartë (GoogleEarth, Flickr, Picasa...etj.).

Dyshoni se ju është vjedhur adresa elektronike

Nëse dyshoni se e-maili juaj është vjedhur, tashmë keni mundësinë ta kontrolloni dhe të vendosni se ka ardhur apo jo koha për ta ndërruar shifrën.

Kohët e fundit, sulmet e piratëve të internetit janë shtuar jashtë mase dhe si rezultat, janë vjedhur me miliona adresa elektronike. Për shkak të këtij problemi serioz të sigurisë, shumë prej përdoruesve janë detyruar të ndërrojnë shifrën e e-mailit të tyre.

Po adresa juaj a mund të jetë vjedhur vallë? Këtë përgjigje do t'ju japë www.shouldichangemypassword.com, një uebfaqe e cila mbledh në depon e të dhënave të internetit e-maillet që publikohen çdo ditë nga piratët e internetit.

Në këtë uebfaqe janë depozituar vetëm të dhënat e e-maileve të cilat janë publikuar për të gjithë nga ana e piratëve të internetit. Sipas deklaramit të vetë faqes, në këtë moment, në depon e të dhënave të tyre ndodhen mbi 800.000 adresa elektronike, të cilat janë vjedhur nga piratët.

Kjo uebfaqe bën vetëm kontrollin nëse ndodhet në depon e të dhënave të saj adresa që ju dëshironi të kontrolloni. Nëse adresa juaj bën pjesë në adresat e vjedhura, ajo ju këshillon ta ndërtoni shifrën sa më parë. Por edhe nëse nuk gjendet në depon e saj, ajo përsëri ju këshillon të ndërtoni shifrat e adresave tuaja më të rëndësishme.

Laptop me energji diellore

Për ata që duan ta mbrojnë ambientin, tani e kanë mundësinë të blejnë një laptop i cili mbështetet në energjinë diellore. Së shpejti kompania Samsung do të nxjerrë në treg modelin e saj të ri të laptopit, Samsung NC215S Solar Powered, i cili fillimisht do të shitet në SHBA dhe Rusi.

Laptopi, i cili kursen energjinë dhe furnizohet me energji diellore, do të jetë në shitje më 3 korrik në tregun amerikan. Samsung NC215S duhet t'i ekspozohet diellit për më shumë se dy orë, për të fituar një

orë energji për punë, ndërsa kur laptopi mbushet në maksimum, atëherë puna e pavarur mund të shkojë deri në 14 orë.

Samsung NC215S ka ekranin me 10.1 inç me rezolucion 1024 x 600 piksel, 1GB RAM, procesorin 1.66 GHz Intel Atom N570 dual-core. Çmimi i tij pritet të jetë rreth 400 dollarë.



Kosova bllokon mallrat e Serbisë

Me një vendim të qeverisë, bëhen zyrtare masat e reciprocitetit me Serbinë dhe Bosnjën, siç kishte paralajmëruar ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusar Lila, në një vendim të Qeverisë së Kosovës. Me këtë vendim nuk do të njihen vultat doganore dhe të administratës tatimore të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Po ashtu, ndalohen

të gjitha produktet serbe dhe importimi i mallrave që kanë këto vula. Ndërsa me Bosnjën, sipas këtij vendimi, do të aplikohet taksa doganore prej 10 %, ashtu si e aplikon ky shtet për mallrat e Kosovës. Doganat e Kosovës obligohen që menjëherë të nisin zbatimin e këtij vendimi.

OSBE-ja fton palët në Shqipëri, të nisin dialogun politik

Kryesuesi i OSBE-së dhe ministër i Punëve të Jashtme të Lituanisë, Audronius Azhbalis, u bëri thirrje qeverisë shqiptare dhe opozitës që të rinisin dialogun politik dhe të ecin përpara me reformat.

“Polemika e vazhduar rreth procesit të ankimit pas zgjedhjeve vendore të 8 majit, ka theksuar nevojën për reforma të mëtejshme zgjedhore, por ajo ka treguar mbi të gjitha, nevojën urgjente që dy partitë më të mëdha politike të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme. U bëj thirrje qeverisë dhe partive opozitare që ta kapërcejnë polarizimin dhe mosbesimin e thellë e t’i japin fund ngërçit politik në vend”, tha Azhbalis.

“Ne jemi në pritje të vlerësimit përfundimtar nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), e cila mund të mbështesë këtë proces, por nuk mund të ketë asnjë vonesë në vendosjen e dialogut politik. Ky hap i parë, është i domosdoshëm për funksionimin e institucioneve demokratike të Shqipërisë dhe, më në mënyrë të veçantë, Parlamentit”, shtoi Azhbalis.

Duke përfunduar se OSBE-ja, përfshirë edhe Prezencën e saj në Shqipëri dhe ODIHR-i, mbeten të gatshme që të mbështesin qeverinë dhe partitë politike që të bien dakord në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe në mënyrë transparente, për një agjendë më të gjerë të reformave, përfshirë edhe reformat zgjedhore.

Shqipëri: Paga minimale 20 mijë lekë në muaj

Vetëm pak ditë pas vendimit të Këshillit Kombëtar të Punës, qeveria zyrtarizon pagën minimale në Shqipëri. Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për rritjen e pagës minimale në masën 5.2 për qind, krahasuar me pagën minimale aktuale. Në bazë të këtij vendimi, paga minimale në shkallë vendi, e detyrueshme për t’u zbatuar nga çdo person fizik dhe juridik, vendas ose i huaj, do të jetë 20.000 lekë në muaj (200\$).

Gjithashtu, për një mbrojtje më të mirë të punonjësve që punojnë me kohë të pjesshme ose jashtë kohës normale të punës, është parashikuar edhe paga orare në masën 115 lekë. Sipas siste-

mit të pagave të punonjësve mbështetës, mbi pagën bazë jepen shtesa për vështirësi, dëmtim shëndeti, natyrë të veçantë pune, vjetërsi në punë etj., të cilat shkojnë mesatarisht në 50 për qind mbi pagën bazë.

Kështu, duke llogaritur këto shtesa, paga për punonjësit që punojnë në punët më të thjeshta në sektorin shtetëror, shkojnë mesatarisht në rreth 30.000 lekë në muaj. Sikundër citohet në njoftimin zyrtar në faqen online të qeverisë, vendimi parashikon që kjo pagë minimale të fillojë efektivisht nga data 1 korrik 2011.